# Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.


**Intervistë**

## Dr. Ahmet Alliu, mjeku i parë i Dibrës

Historiku i shërbimit shëndetësor në optikën e mjekut të parë dibran

Nga **prof.as.dr.Nazmi KOÇI**


16

**Art**

## Bajram Mata zgjodhi të jetojë me fjalën e veprat e realizuara

Nga **Selami NAZIFI**


12

**Profil**

## Pajtim Beça, një histori suksesi në breg të Drinit

Nga **Osman XHILI**


9

# Rruga e Arbrit: Qeveria firmos kontratën, "Gjoka Konstruksion" gati të nisë punën


Lexoni në faqen 2

**NË BRENDËSI:**


- Jemi skeptike për aq kohë sa nuk ka transparencë për fondet dhe projektin
- Rruga e Arbrit i bashkon shqiptarët
- Dhjetë arsye përse duhet vizituar Dibra
- Rafting lumenjve të Dibrës që s'bëzajnë
- "FERRA E PASHËS"
- Jashar Bunguri, gjeneral i bujqësisë shqiptare
- Kastrioti, fshati pa Kastriotë
- Asllan Keta: Më shumë se Partinë, dua Shqipërinë
- Tenori Gerald Murrja: Ëndrra ime është të këndoj në skenat e operave në botë
- Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë, tempull i dijes dhe edukimit
- Mustafa Shehu, një zemër që skaliti me zjarr emrin e tij në histori
- Fadil Shulku, portieri modern i kohës
- Shqiponja dibrane
- Njerëz që hynë dhe mbetën në kujtesën e dibranëve
- Islamil Hida, njeri i edukuar, fjalëpak e punëshumë


REPORTAZH

## Cerjani, një fshat i braktisur dhe i rrënuar nga migrimi



*Nga* **BESNIK LAMI**

Cerjani është një nga katër fshatrat e zonës së Bellovës që shtrihet në verilindje të qytetit të Peshkopisë, rreth 7 km larg tij. Ai është fshati më i largët i zonës nga qyteti, fshat kufitar. Ai ndodhet në lartësinë 1240 m mbi nivelin e detit dhe shtrihet në një pllajë trekëndëshe në mes dy përrenjve, në rreze të vargmaleve të Korabit.

*(Lexoni në faqen 4)*

SPORT: Alia dhe Halili, dy dibranët e Kombëtares U-19

## Drini Halili:Objektivi është Kombëtarja!.

### Marko Alia: Mes Italisë dhe Shqipërisë zgjodha vendin tim!


Alia

Lexoni në faqen 21


Halili



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: **Rruga e Arbërit** ose ndiq linkun: **https://tinyurl.com/lcc3e2f**

**Njoftohen lexuesit tanë në Durrës, se gazetën tonë mund ta gjejnë pranë rrjetit të librarive DYRRAH**

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (143). Mars 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit prill

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

**GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.**

**JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
NAZMI KOÇI
Selami NAZIFI
Halil TEODORI
Besnik LAMI
Azis KETA
Fitim BUNGURI
Sevo TARIFA
Destan RAMA
Hilmi CANI
Mehmet DUME

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

# Rruga e Arbrit: Qeveria firmos kontratën, “Gjoka Konstruksion” gati të nisë punën



*Tuneli i Murrizit. 3246 m.*

Qeveria shqiptarë, në mbledhjen e saj të datës 28 mars 2018, miratoi kontratën e koncesionit/ppp, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe shoqërisë “Gjoka Konstruksion”, sh.a., për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, qeveria miratoi kontratën e nënshkruar në fillim të shkurtit 2018, duke i dhënë autoritet të plotë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim vjen gati dy muaj pas firmosjes së kontratës nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë z.Gentian Keri dhe Presidentit të kompanisë “Gjoka Konstruksion” z.Rrok Gjoka. Gjatë asaj ceremonie Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z.Damian Gjiknuri deklaroi se kontrata u përmbyll pas një procedure të gjatë konkurimi dhe negocimi investiv.

“Jemi shumë të bindur që shoqëria, nga diskutimet dhe ato çka na prezantoi gjatë negociatave të kontratës i ka marrë të gjitha masat që brenda afateve të përcaktuara në kontratë, pra brenda këtij viti do të realizohet pjesa e financimit dhe fillimi i punimeve të rrugës. Është një nga veprat e rëndësishme, një lajm shumë i mirë për qytetarët shqiptarë por mbi të gjitha për qytetarët dibranë të cilët prej shumë vitesh e kanë pritur këtë rrugë”, u shpreh në fillim të shkurtit ministri Gjiknuri.

Sipas Ministrit, kemi të bëjmë me një vepër të vështirë, një vepër të rëndësishme por që do të jetë nga pikëpamja inxhinierike, një nga veprat më të realizuara në Shqipëri.

“Është një vepër që do të kushtojë 240 milion euro dhe në këtë kontratë ne kemi parashikuar që shteti do të marrë përsipër të likuidojë kontraktorin brenda një periudhe 13 vjeçare. Kontraktori do të marrë përsipër të ndërtojë rrugën në fillim me shpenzimet e tij dhe mirëmbajtjen e kësaj rruge gjatë gjithë periudhës së koncesionit”, theksoi Gjiknuri.

### TË DHËNA MBI PROJEKTIN

Sipas autoritetit kontraktor, Rruga e Arbrit është e përfunduar plotësisht në 20.12 km, 15.175 km janë përfunduar pjesërisht si dhe ka një projekt ekzistues edhe për 26.372 km. Në total janë 61.667 km të projektuar për gjurmën kryesore me standardin C3, nga të cilët 26.372 km nuk janë prekur me punime ndërtimi. Sipas Studimit te fizibilitetit te hartuar rreth vitit 2005 e gjithë gjurma Tiranë-Bllatë sipas këtij varianti pritet të jetë afërsisht rreth 73.5 km e gjatë, çka do të thotë që afërsisht ne total 11.8 km rrugë janë ende të pa projektuar ( gjatësi ne skajin e lidhjen me Tiranën dhe gjatësi në skajin e lidhjes me Blladën - pika kufitare).

Në këto kushte Projekt Ideja për “Përmirësim, Ndërtim, Operim, dhe Mirëmbajte e Rrugës se Arbrit” për kompletimin e të gjithë gjurmës së Rrugës së Arbërit qe përfshin: projektet e segmenteve të pa projektuar( skajet lidhëse) , përmirësimin e projekteve të segmenteve ku punimet janë ende të papërfunduar me synimin e përmirësimit të tyre nga standardi C3 te standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015, përmirësimin e projekteve të zbatimit për segmentet ku ka projekt zbatim por qe nuk është ndërtuar duke përmirësuar standardin C3 te rrugës sipas standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015 dhe mirëmbajtjen e segmenteve te ndërtuara.

Ne projekt ide, të nxitur nga rëndësia që ka segmenti Zall Bastar-Dalja e Urës së Vashës, që është sa 1/3 e të tërë Rrugës së Arbrit është studiuar dhe projektuar sipas standardit C2 te vitit 2015 ku është projektuar edhe lidhja e Rrugës së Arbrit me Klosin. Ne projekt ide është marr ne konsideratë distance kohore më e shkurtër, siguria e kërkuar në tunele, pasi parashikon edhe një tub emergjence, krahas atij kryesor dhe aksesi me i shpejt i rrugës nga banoret e Matit përmes lidhjes me Klosin. Kështu, në Projekt Ide, Rruga e Arbrit nga Tirana deri në Bllatë skematikisht në mënyrë të njëpasnjëshme është e ndarë në 8 segmente si më poshtë:

Segmenti 1, fillon në dalje të Tiranës, aty ku mbaron rruge ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, aty ku kane filluar punimet për ndërtimin e rrugës. Gjatësia e tij është 1.153 km.

Segmenti 2 : Ura e Brarit - Zall Bastar, me L = 5.46 km.

Segmenti 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, sipas projekt idesë eshte me gjatësi L = 23.188 km.

Segmenti 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi L = 9.715 km.

Segmenti 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me L = 20.12 km, i përfunduar në v. 2009 dhe 2011.Nuk është pjese e Projekt Idesë.

Segmenti 6: sipas studim-projektim qe lidh Urën e Çerenecit me rrugën Maqellarë-Pika kufitare Bllatë. Gjatësia e tij është L = 9.111 km.

Segmenti D (7): Për të plotësuar nevojat e trafikut të ardhshëm, rruga ekzistuese Maqellarë-Pika kufitare Bllatë duhet të rikonstruktohet në standardin e një rruge urbane për shpërndarjen e të tërë trafikut të Rrugës së Arbrit në Drejtim të Peshkopisë (Maqellarë) dhe Maqedonisë (Pika kufitare Bllatë).

Segmenti K (8) është degëzimi Dalje Ura e Vashës - Klos (Segmenti K) me L = 3.092 km.

Projektet e segmenteve 1 deri 6 (pervec segmentit 5-qe nuk është pjese e Projekt Idesë) janë hartuar sipas Standardin C2 të Manualit për Projektimin e Rrugëve Shqiptare – MPRrSh 2 – Projektimi Gjeometrik (viti 2015). Ky standard kënaq kërkesat që burojnë nga Studimi i Fizibilitetit për Rrugën e Arbëri. Ky standard, kërkesat evropiane të sigurisë për rrugët automobilistike dhe elementëve përbërës të tyre.

Segmenti D është projektuar për të plotësuar nevojat e kalimtarëve, trafikut urban dhe ato në interes të Rrugës së Arbrit. I vetmi Segment i projektuar në standardin C3 është ai i degëzimit për në Klos (Seg. K), kjo në përputhje me volumit e trafikut në atë rrugë.

***Korr. Rr.A.***

Bëj pajtimin tënd me PayPal
përmes emailit
**<rrugaearberit@gmail.com>**

Një pajtim vjetor kushton:
**Në Shqipëri: 600 lekë.**
**Në Europë: 10 Euro.**
**Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.**

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

*Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...*

peticioni

# Jemi skeptike për aq kohë sa nuk ka transparencë për fondet dhe projektin

**DEKLARATA:** Disa pyetje për Qeverinë me rastin e 5-vjetorit të peticionit për Rrugën e Arbërit. 16,000 përkrahës kërkojnë që peticioni të pranohet formalisht nga Kryeministri Rama

**GËZIM ALPION & GRUPI I LOBIMIT**

Sot, pesë vite më parë, filloi peticioni online i intelektualëve dibranë për Rrugën e Arbërit. Nisma nisi para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 me shpresë se do të rezultonte në një dialog konstruktiv me qeverinë e re për këtë vepër, të zvarritur që nga viti 2005. Ne theksuam që në fillim se peticionin do ta mbajmë të hapur deri në përfundimin e kësaj vepre me standarde ndërkombëtare dhe se nuk do të ndikohem nga asnjë forcë politike.

Premtimet i kemi mbajtur, por Kryeministri Edi Rama refuzoi ta pranonte atë formalisht gjatë mandatit të parë. Kohët e fundit, disa anëtarë të Grupit të Lobimit nuk kanë refuzuar ftesat e z. Rama për tu takuar me të në veprimtari të ndryshme. Ne shpresojmë se, në një kohë të përshtatshme për z. Rama, angazhimin personal të të cilit për ndërtimin e kësaj vepre e vlerësojmë, do të na krijojë mundësinë të ndajmë me të mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet tona, disa nga të cilat do t'i përmendim me poshtë.

Në vendet demokratike, kur një peticion ka një numër të caktuar nënshkrimesh, shqyrtohet zyrtarisht nga institucionet shtetërore. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, një vend me popullsi 65.5 milionë banorë, një peticion me 10,000 nënshkrime, merr përgjigje nga qeveria, ndërsa kur numri arrin në 100,000 debatohet në Parlament.

Përse në Shqipëri, me një popullsi më me pak se 3 milionë, një peticion me 16,000 përkrahës (13,000 online dhe 3,000 në formularë) jo vetëm që nuk përfillet, por edhe përçmohet kaq gjatë nga qeveria? Çfarë mesazhi i përcjell ky qëndrim nënshkruesve, numri i të cilëve sa vjen e shtohet? Po dibranëve, të cilët, që nga copëtimi i kësaj zone në 1913-tën, kanë njohur vetëm injorim nga qeveritë në të dyja anët e kufirit dhe vazhdojnë të jenë viktima të një kolonializmi intra-nacional, që shfrytëzon çdo pasuri pa bërë asnjë investim të dukshëm? Po bashkëatdhetarëve, në zona të tjera të 'largëta' dhe po aq të lëna pas dore? Po intelektualëve, që nëpërmjet një nisme të tillë civile, po dëshmojnë, edhe pse në mënyre modeste, se nuk janë të shkëputur nga problemet e vendit? Po elitën në diasporë, të hilen udhëheqësi i radhës e fton në Tiranë, gjoja për të kontribuar në zhvillimin e vendit, por askush nuk ka nge të përkrahë e zbatojë propozimet konkrete që ata paraqesin? Dhe mbi të gjitha, po brezit të ri, që për fat të keq, edhe pas afro tre dekadash amullie, synon të largohet nga vendi pasi nocionet 'demokraci' dhe 'shtet i së drejtës' u janë zvetënuar?

Dikush mund të pyes se përse edhe pas pesë vitesh, ne jemi të hapur për të filluar dialogun me qeverinë? Sepse, si intelektualë, jemi të bindur se dialogu është mënyra e vetme e komunikimit. Sepse nuk besojme se gjërat bëhen me protesta, megjithëse, për fat të keq, kjo gjenerate politikanësh veprojnë veçanërisht kur u rrezikohet pushteti.

Ja disa nga çështjet që do të ngremë në ne takimin me Kryeministrin, po qe se na jepet mundësia.

Ne duam sqarime se kush mban përgjegjësi për veprimet e mëparshme arbitrare në lidhje me Rrugën e Arbërit? Përse vazhdoi sharada me kinezet kur ne kishim paralajmëruar që në fillim se, edhe pas hartimit të një ligji të posaçëm nga Parlamenti, dhe nënshkrimin të një kontrate me kinezët, gjithçka do të dështonte?

Siç thamë në fillim, ne i përshëndesim përpjekjet e Kryeministrit dhe të Qeverisë për të siguruar fondet në mënyrë që punimet për ndërtimin e kësaj vepre, që është bërë prej kohësh një tregues i frikshëm dhe i turpshëm i shkallës së ulët të efikasitetit të shtetit, më në fund, të fillojnë. Megjithatë, nuk jemi aq naivë të besojmë se kjo çështje 'u kry' sepse pamë një prezantim virtual.



Nga punimet në Rrugën e Arbrit. Foto e vitit 2008.

> Ne i përshëndesim përpjekjet e Kryeministrit dhe të Qeverisë për të siguruar fondet... Megjithatë, nuk jemi aq naivë të besojmë se kjo çështje 'u kry' sepse pamë një prezantim virtual.

> Dibranëve u është uruar edhe më parë kjo vepër iluzive. Prandaj, kemi të drejtë të jenë skeptike për aq kohë sa nuk ka transparencë për fondet, projektin, kur fillojnë, sa do të zgjasin dhe kur do të përfundojnë punimet, për kompetencën teknike të kompanive që do të angazhohen në realizimin e kësaj vepre, për penalitetet me të cilat Qeveria dhe sipërmarrësit do të përballen po qe se ka devijime në projekt, dhe nëse dibranët do të 'diskriminohen' përsëri duke ju kërkuar të paguajnë për 'privilegjin' për të parë Tiranën.

> Po qe se qeveria nuk është në gjendje të sqarojë publikun për çështjet e mësipërme, nuk ka asnjë garanci se ajo që ndodhi me rrugën e Kukësit dhe të Elbasanit, ku kostot u shumëfishuan gjatë kohës së ndërtimit dhe punimet u bënë me cilësi të dobët, të mos përsëriten edhe në Rrugën e Arbërit.

Dibranëve u është uruar edhe më parë kjo vepër iluzive. Prandaj, kemi të drejtë të jenë skeptike për aq kohë sa nuk ka transparencë për fondet, projektin, kur fillojnë, sa do të zgjasin dhe kur do të përfundojnë punimet, për kompetencën teknike të kompanive që do të angazhohen në realizimin e kësaj vepre, për penalitetet me të cilat Qeveria dhe sipërmarrësit do të përballen po qe se ka devijime në projekt, dhe nëse dibranët do të 'diskriminohen' përsëri duke ju kërkuar të paguajnë për 'privilegjin' për të parë Tiranën.

Po qe se qeveria nuk është në gjendje të sqarojë publikun për çështjet e mësipërme, nuk ka asnjë garanci se ajo që ndodhi me rrugën e Kukësit dhe të Elbasanit, ku kostot u shumëfishuan gjatë kohës së ndërtimit dhe punimet u bënë me cilësi të dobët, të mos përsëriten edhe në Rrugën e Arbërit.

Në videoprezantimin e rrugës nga Ministria e Transportit, segmenti aktual, 'Bulqizë-Ura e Çerenecit', konsiderohet i ndërtuar. Në konstatojmë se ky segment nuk i përmbush standardet e rrugëve europiane. Prandaj, kërkojmë që Qeveria ta rishikojë këtë segment. Po qe se ky segment është kuti me të cilin do të matet cilësia e punimeve, kjo do të thotë se edhe segmente e tjera që do të ndërtohen do të jenë me cilësi të dobët.

Po qe se Rruga e Arbërit do të ndërtohet shkel e shko, kjo do të jetë një përbuzja e madhe që do t'ju bëhet 200,000 dibranëve dhe të gjithë taksapaguesve shqiptarë.

Ne shpresojmë që kjo nuk do të ndodhë dhe Rruga e Arbërit do të jetë, siç e ka cilësuar Kryeministri, një 'rruga e parë me standarde europiane.

OPINION

# RRUGA E ARBËRIT I BASHKON SHQIPTARËT

*Nga* **MEHMET DUME**

Sa herë që marr e lexoj gazetën "Rruga e Arbërit", më kujtohet gjithë zona e Dibrës. Aq e bukur e mbresëlënëse, aq historike sa dhe e mbushur me këngët më të bukura të zonave që përmbledh rreth e qark saj. Më ka mbetur në memorien time që nga viti 1986, atëherë kur shkova për herë të parë në një stërvitje ushtarake...

Ndaj në këtë moshë kujtoj masivin e malit të Korabit, më i larti i vendit tonë. Kjo me gjithë atë pllajën e bukur që janë vendosur me mijëra vjet përpara.

Që nga Kalaja e Dodës që duket vërtet si kala. Pastaj vijnë poshtë faqes së tij deri në lumin Drini i Zi, por shumë i bukur dhe lumi që na sjell dritë dhe gëzim për gjithë Shqipërinë. Nuk mund të le pa përmendur fshatrat: Kastriot, Sllovë, Shumbat, Sllatinë, Venisht, Dypjakë, Limjan, Deshat, Borovjan, Rabdisht, Zimur, Cerian, Ilnicë, Grevë, Melan, Grezhdan e Maqellarë.

Përballë Korabit, masivi i maleve të Lurës turistike, Zalldardhave e folklorit aq të pasur. Lura përmbledh shtatë liqenet në të gjitha krahët e saj.

Unë me gazetën "Rruga e Arbërit" jam lidhur që në vitet e para kur sapo doli në tregun mediatik dhe kështu u bëra një lexues i rregullt i saj. Misioni i gazetës nuk ishte vetëm Rruga e Arbërit si objekt, si infrastrukturë, jo nëpërmjet saj po promovoheshin përherë e më shpesh vlerat etnokulturore, atdhetare, historike e sociale të të gjithë trevës së madhe të Dibrës. Domosdo që edhe rruga ishte mision i kësaj gazete e cila u bë një gazetë mjaft e njohur e shumë e kërkuar jo vetëm nga dibranët por edhe nga zona të tjera të Shqipërisë.

Unë vetë kam dëshirë të madhe ashtu si për Skraparin tim atje larg rrëzë Tomorrit edhe për Dibrën dhe dibranët fisnik të përfundojë sa më parë kjo rrugë e njohur qysh në mesjetë dhe të ndërtohet një rrugë me standarde e jo shkel e shko.

Në Skrapar ka lëvizje qoftë rruga e gazit që i bie Skraparit mes për mes për tu lidhur me Korçën e drejt Kapshticës për në Greqi, por edhe lidhja e dy lumenjëve, Osumit me Vjosën që të çon në Tre Urat e Leskovikut apo Këlcyrë - Dëshnicë - Tepelenë- Gjirokastër.

Rrugët sjellin zhvillimin ekonomik të zonave, zhvillim tregtar, turistik e shumë e shumë të tjera.

Ndaj shikoja që në gazetën "Rruga e Arbërit", shqetësimi për rrugën si objekt ishte i madh nga të gjithë qytetarët që kalonte ky segment rruge brenda për brenda Shqipërisë por dhe jashtë kufijve ku do të kalojë e bashkojë portin e madh të Durrësit me vende si Shkupi, Kosova e Sofja.

Kur unë shqetësohesha dhe u bëra pjesë e peticionit duke firmosur, një miku im pa u menduar shumë më thotë me zë pak si të fortë: "Ç'ne edhe ti me këtë rrugën e Arbërit? Çfarë të lidh ty me të? Ti je nga Skrapari e nuk të bashkon asgjë me Dibrën apo Matin". Unë po flisja i entuazismuar për realizimin e këtij projekti jetik për këto zona me histori të mëdha kombëtare. Të them të drejtën më erdhi shumë keq për atë cektësi mendimi të atij që foli me të tillë gjuhë ku për mua ishte edhe fyese për atë popull vital si Bulqiza, Klosi, Dibra, Mati dhe Kruja por edhe lidhja me shtetet fqinje. Dhe ky debat mes miqsh, më uli të shkruaj për Dibrën.

Në këtë rrugë duke u nisur nga Çidhna e Dibrës erdhi Skënderbeu në Krujë. Kjo rrugë e përsërit dhe e sjell në memorien tonë historinë e luftërave kur Skënderbeu, heroi ynë legjendar me treqind kalorës dibranë vjen në kalanë e Krujës...

Kjo rrugë ishte dhe mbeti drejtimi më i shkurtër që bashkonte vendet dhe kalatë e Skënderbeut që nga Stelushi e në Gurë të Bardhë për të dalë pastaj në Krujë e Petrelë.

Tani që është projektuar dhe do të ndërtohet rrugë e re me parametra e standarde europiane, Dibra bashkohet nëpërmjet kësaj rruge për një orë me makinë, duke u kthyer kështu në një lagje të metropolit shqiptar.

Dibra është e madhe, ka një shtrirje gjeografike që kufizohet me Kukësin e Mirditën, Matin e Maqedoninë, për të dalë pastaj në Librazhd. Ka fshatra të bukur që do të bashkojë projekti i rrugës së Arbrit si: Zerqani e Sofraçani, Strikçani e Sopoti, dy Gjoricat e Çereneci, fshatrat e Gollobordës sidomos Trebishti, Klenja, Stebleva, Ostreni i Madh dhe Ostreni i Vogël, Borova e Zabzuni dhe Fushë Studna ku rreth e qark si një kurorë e bukur i qëndrojnë malet; Kaptina e Martaneshit, mali i Krastës, mali i Zylit, mali Car, mali Kallkan, Raduçi, varri Maricës, e në vazhdim mali i Qarrishtës.

Këto e mjaft fshatra të tjerë e duan Rrugën e Arbërit pasi ka qenë një ëndërr e kahershme e të gjithë dibranëve, matjanëve e bulqizakëve. Dhe kjo ëndërr tashmë mori fund, pritet nga dita në ditë të fillojnë punimet.

Ajo zonë është plot me miniera kromi që mundet të sensibilizohen e të shfrytëzohen nga shteti ynë. Ndaj dhe duhet të shpresojmë vetëm për mirë në drejtimin e ngritjes së nivelit ekonomik të vendit...

Dibra nuk është vetëm, na ka edhe ne. Pse të mos jetë kështu? Të gjithë të bashkuar e të ndihmojmë njeri-tjetrin, të ecim krah për krah si dy krahët e shqiponjës se jemi pak për tu ndarë. Bëhemi shumë po të bashkohemi.

Rruga e Arbërit nr. 141



# CERJANI, një fshat i braktisur dhe i rrënuar nga migrimi

**Para 30 vjetësh Cerjani ishte një fshat i bukur me rreth 120 shtëpi e 820 banorë, me shtëpi të reja bukura...**

**Në Cerjan tani është urgjente që Bashkia e njësia administrative të investojnë në rregullimin e rrugës që të shpie në fshat, në rregullimin e kabinës elektrike të fshatit dhe në drejtime të tjera sociale.**

*Nga* **Besnik LAMI**

Cerjani është një nga katër fshatrat e zonës së Bellovës që shtrihet në verilindje të qytetit të Peshkopisë, rreth 7 km larg tij. Ai është fshati më i largët i zonës nga qyteti, fshat kufitar. Ai ndodhet në lartësinë 1240 m mbi nivelin e detit dhe shtrihet në një pllajë trekëndëshe në mes dy përrenjve, në rreze të vargmaleve të Korabit. Sipër fshatit shtrihet brezi i pyjeve me dru ahu e pishe dhe sipër këtij brezi shtrihen kullotat alpine në një terren të thyer malor deri në maje të maleve në lartësi 2100 mbi nivelin e detit dhe grykën e Skërtecit ku lind çdo mëngjes dielli rrezeart.

Të katër fshatrat e zonës: Bellova, Cerjani, Rabdishti e Zagradi e kanë origjinën e themelimit të tyre që para mesjetës, kohës së Skënderbeut, gjë që argumentohet nga gjetjet arkeologjike të zbuluara nga arkeologët në zonën e Bellovës si enë qeramike dhe vegla e shtiza prej hekuri. Këtë e dëshmojnë dhe defterët e regjistrimit të popullsisë dhe ai i mbledhjes së taksave në kohën e pushtimit osman. Kështu në defterët e pushtuesve turq të vitit 1467 rezulton që Cerjani të ketë 19 shtëpi, Biloja (Bellova) 6 shtëpi, Zagradi 4 shtëpi dhe Radibodishti (Rabdishti) 9 shtëpi. Cerjani figuron si fshati më i madh i zonës në këtë kohë. Po sipas defterëve osmane të kësaj periudhe rezulton që popullsia e katër fshatrave të zonës sonë, por dhe i gjithë fshatrave të Dibrës të ishte i besimit katolik, sepse taksa mbledhësit turq shënonin në defterët e tyre dhe emrat e fshatareve nga të cilët mblidhnin taksat e tyre në të holla dhe në drithëra buke dhe në tërshërë e elb, emra katolik.

Vetëm pas vdekjes se Skënderbeut, nga mesi i shek. XVI, kur sundimi turk u konsolidua në Arbëri dhe turqit ngritën teqe e xhamia, mejtepe për të mësuar turqishten u përhap myslimanizmi. Banorët e fshatrave e të qyteteve tona të ndodhur nën trysninë dhe shtypjen e shfrytëzimin e egër të turqve osmanë u detyruan të ndërrojnë fenë, të kthehen në myslimanë. Për shekujt e sundimit turk ka pak ose fare të dhëna për banorët e fshatrave tona. Vetëm në vitin 1903, sipas prof. Kristo Frashëri, kemi një të dhënë të regjistrimit të shtëpive në zonën tonë i bërë nga Instituti Gjeografik i Sofjes. Sipas këtij regjistrimi të këtij viti fshati Bellovë ekziston me 50 shtëpi, Cerjani me 75 shtëpi, Rabdishti me 80 shtëpi dhe Zagradi me 35 shtëpi. Fshati Rabdisht e Cerjan janë me popullsi më të madhe në zonë. (K. Frashëri, "Historia e Dibrës") Po sipas regjistrimit të vitit 1927, në kohën e mbretit Zog, Bellova na del si fshati me popullsi më të madhe në zonë. Në këtë fshat banonin 325 banorë, në Cerjan 231 banorë, në Rabdisht 233 banorë dhe në Zagrad 106 banorë.

Në këtë shkrim duhet të shënojmë dhe masakrat e shovinistëve serbe në fshatrat e krahinës sonë fill pas shpalljes së Pavarësisë. Kështu në vjeshtën e vitit 1913 serbët plaçkitën shtëpitë e fshatrave tona, grabitën bagëtinë, dogjën shtëpi e vranë njerëz të pafajshëm. Dogjën e plaçkiten më 1913 Cerjanin, plaçkitën Zagradin, kurse në Rabdisht dogjën shumë shtëpi e vranë rreth 70 vetë: burra, gra, pleq e plaka e fëmijë të pafajshëm. Në vjeshtën e parë të 1918 serbët kapën, lidhën e pushkatuan 19 djem e burra të rinj cerjanas në vendin e quajtur Greke ku ekziston edhe sot një lapidar në kujtim të këtyre martirëve të vrarë. Lufta kundër serbëve vazhdoi në Dibër deri në fund të vitit 1920. Serbët hynin e dilnin në kufijtë tanë të 1913 dhe sa herë që hynin ata plaçkitnin, grabisnin bagëti, digjnin shtëpi e vrisnin njerëz.

Dihet se vendi ynë më 1938 kishte rreth 800 000 banorë. Ishte vendi me i varfër dhe me i shkatërruar nga Lufta e II Botërore në Europë. Skamja, mjerimi i fshatarëve ishin në kulm. Anafalbetizmi kapte mbi 90% të popullsisë. Shumë fshatarë të zonës e sidomos nga fshati Cerjan morën që në kohën e Zogut rrugët e kurbetit (si sot), shkonin për të punuar e për të mbajtur gjallë me bukën e gojës familjet e tyre. Shkonin për punë në Greqi, Bullgari, por punonin si qiraxhinj dhe në Prizren e Tetovë, në Tirane e Gostivar.

Megjithëse të varfër e analfabete, banorët e zonës sonë e përkrahën fuqimisht LNCl. Si patriotë të vërtetë rreth 40 të rinj nga fshatrat e zonës sonë rrokën armët për lirinë e vendit. Ata u regjistruan në formacione të ndryshme të ushtrisë NCl dhe luftuan deri ne çlirimin e plotë të vendit. Vetëm nga fshati Cerjan dolën 12 partizanë (djem të rinj) dhe tre prej tyre derdhën gjakun në altarin e lirisë duke u shpallur dëshmorë të atdheut: si Nesim Kaza, Shemsi Haka dhe Zenel Paci. Pas çlirimit në të gjithë vendin rilindi jeta. Populli me besim e optimizëm te pushteti i ri popullor ju përvesh punës për zhdukjen e pasojave të Luftës si dhe për rindërtimin e vendit. Puna ziente kudo, në fshat e qytet. Shumë të rinj nga fshatrat e zonës sonë ju përgjigjen thirrjes së Partisë e të pushtetit popullor për ndërtimin e veprave të reja siç ishin: ndërtimi i hekurudhave të para, hapja e rrugës automobilistike Kukës-Peshkopi, ndërtimi i hidrocentraleve të para, i kombinatit të tekstileve në Tiranë e të shumë veprave të tjera industrial e bonifikuese dhe të rrugëve.

Krahas punës për rindërtimin e ndërtimin e vendit dhe sistemimin e mbjelljen e tokës, një punë të madhe bëri pushteti popullor që në vitet e para të çlirimit në luftën kundër analfabetizmit që ishte një plagë e rëndë e shoqërisë shqiptare të kohës. Duhesh më shumë punë dhe më shumë dije e kulturë. Që më 1945 në të gjithë fshatrat u hapën kurse kundër analfabetizmit. Që më 1945 u rihap në Bellovë shkolla fillore, kurse në shtator të 1947 u hapën shkolla të CU në fshatrat Cerjan, Rabdisht e Zagrad. Si mësues shërbyen shumë mësues atdhetarë të ardhur nga Elbasani, Korça, Gjirokastra etj. Zymtësia e jetës filloi të terrej nga sytë e popullit. Fshatarët filluan të mbjellin e të shfrytëzojnë më mirë tokën, të rrisin numrin e blegtorisë, të shkollohen, të ndërtojnë shtëpi të reja e të punojnë sipas mundësive dhe në ndërmarrje të ndryshme shtetërore duke përfituar të ardhura dhe zanate e mjeshtëri. Krahas përmirësimit të jetës në sajë të punësimit të njerëzve dhe shërbimeve më të mira shëndetësore, arsimore e kulturore filloi të rritej popullsia e fshatrave tona, të krijoheshin familje të reja e të ndërtoheshin shtëpi të reja. Kështu në vitet 1950 Cerjani kishte rreth 56 shtëpi me rreth 350 banorë.

Rritje e zhvillim ekonomik, social e kulturor patën fshatrat e Bellovës pas vitit 1967 kur u krijua koop. bujqësore dhe fshatarët e vuajtur në shekuj bashkuan tokat, mjetet e forcat e punës për ndërtimin e jetës së re. Ky zhvillim e përparim u rrit më shumë pas elektrifikimit të fshatrave në shtator të 1970. Autori i këtij shkrimi është rreth 70 vjeç dhe këto ndryshime sociale, ekonomike, kulturore e historike i ka parë me sy dhe i ka ndjerë e përjetuar vetë. Jeta kish marrë zhvillim e përparim në shumë dimensione. Përveç dritës elektrike në fshat erdhi dhe radio e televizioni që përhapnin në shtëpitë tona arsim e kulturë. Që në vitet e para të çlirimit apo më saktë në vitet '50 nga fshatrat tona filluan të dalin kuadrot e para si mjekë, mësues, oficerë, ekonomistë e inxhinierë që i shërbyen popullit e atdheut atje ku kish më tepër nevojë. Në fshatra u ngritën kopshte e çerdhe, infermieri, furra buke, vatra kulture që përmirësonin e ngazëllenin jetën e punën e fshatarëve. Që më 1963 në qendrën e zonës, Bellovë, u hap shkolla 8-vjeçare "Shemsi Haka" e cila u bë detyrueshme për çdo fëmijë nga qeveria. Krahas punës në prodhim e ndërtim, shumë fshatarë e familje të reja, konform rregullave të urbanistikës dhe me ndihmën e koop. bujqësore, filluan të ndërtojnë shtëpi të reja. Numri i lindjeve rritej nga dita në ditë dhe kështu rritej dhe numri i familjeve dhe i popullsisë për çdo fshat. Kështu në vitin 1979 fshati Bellove kishte 105 familje me 629 banorë, fshati Cerjan kishte 94 familje me 654 banorë, Rabdishti kishte70 familje me 499 banorë dhe Zagradi kishte 41 familje me 262 banorë. Si zonë gjithsej Bellova kishte 310 familje me 2044 banorë. Numrin më të madh të banorëve e kishte fshati Cerjan. Më1984 ky fshat kishte 116 familje me 820 frymë. Kishte shkollë të ciklit të ulët me 4 fuqi mësimore, me 84 nxënës, kurse sot (me 2017) Cerjani ka vetëm 15 familje me 112 banorë, një shkollë në shtëpi private me një fuqi mësimore me 7-8 nxënës nga kl. I në kl. e V-të. Ritmet e rritjes në ekonomi e popullsi rriteshin nga viti në vit se atëherë lëvizjet e popullsisë ishin të kontrolluara e s'mund të ikje kund pa leje. 60% e popullsisë jetonin në fshat.

Pas përmbysjes të sistemit socialist më 1991 ndryshoi komplet punë dhe jeta në fshat. Me prishjen e koop. bujqësore dhe hapjen e rrugëve për lëvizje të lira në vend e jashtë tij shumë familje e banorë të fshatit Cerjan, por dhe të fshatrave të tjerë filluan të lëviznin, të migronin nëpër qytete si në Peshkopi apo Tiranë, si dhe të rinjtë të lëviznin për të gjetur punë jashtë vendit si në Greqi, Itali apo Angli. Gjatë këtyre 27 vjetëve pluralizëm 80% e familjeve cerjanase kanë lëvizur për një jetë më të mirë pranë qendrave urbane. Rreth 50 familje braktisën shtëpitë e tyre në fshat dhe erdhën e u nguliten në lagjen Llixha të Peshkopisë. Thënia e vjetër: "Rëntë Cerjani te banjat" u bë realitet tani në ditët e sotme, ku kanë ngritur strehet e tyre të reja e të bukura 50 familje cerjanase. 30 familje banojnë në lagjet e tjera të Peshkopisë dhe disa familje të tjera banojnë në qytetin e Tiranës, në rrethin e Durrësit apo të Lushnjës. Nga migrimi i njerëzve dhe ulja e numrit të lindjeve, Cerjani nga fshati me i madh i zonës ka mbetur fshati më i vogël nga numri i popullsisë. Sot fshati më i madh mbetet fshati Rabdisht. Ai sot ka 530 banorë dhe Bellova 324 banorë. Edhe nga këto fshatra janë larguar shumë familje e njerëz, por jo si në Cerjan ku largimet kanë qenë masive. Rabdishti është shpallur këtë vit fshat turistik ndër 100 fshatra te Shqipërisë dhe së shpejti do t'i vijë e mira tek dera si asfalti, turisti i huaj, paraja, teknologjia e re, etj. Të vjen keq e trishtohesh në shpirt, kur sheh sot vendlindjen tënde të braktisur e të shkatërruar totalisht në shumë aspekte.

Dikur para 30 vjetësh Cerjani ishte një fshat i bukur me rreth 120 shtëpi e 820 banorë, me shtëpi të reja e të bukura plot dritë, të ndërtuara pranë njëra tjetrës, me rrugë të pastra e të shtruara me kalldrëm, me shpirt bujar e mikpritës, me objekte social-kulturale e shkolle te mirë e mbi te gjitha me një rini punëtore, të kulturuar e dinamike. Sot ai duket i braktisur, i heshtur e i sfilitur se ka pak banorë. Të shohësh Cerjanin sot nga Bregu apo nga qielli te duket se këtu ka rënë bomba atomike e Kim Jongut, sepse shumë shtëpi të braktisura në vite nga njerëzit janë shkatërruar e rrënuar se shtëpitë i mban gjallë në këmbë fryma e kujdesi i njeriut. Ata janë shkatërruar vetvetiu nder vite nga agjentet atmosferike si shiu, bora, era, etj. Mallëngjehesh, trishtohesh e përlotesh nga kjo katandisje e vendlindjes. Pas vitit 1990 brenda 2-3 vitesh u shkatërruan dhe objektet social-kulturore, shkolla e fshatit dhe stallat e blegtorisë në Smile. Fshati s'ka më ambulancë si dikur. Kabina elektrike e fshatit e ngritur që më 1970 është gati në të shembur se nuk është vënë dorë fare mbi të që 58 vjet as nga Elektriku e as nga komuna. Edhe rrugët e fshatit e të blloqeve të arave janë ngushtuar e degraduar se s'punon mirë pleqësia e fshatit. Mungon fryma kolektive e punës, fryma e aksionit dhe humanizmi për të ndrequr diçka. Njerëzit kanë firuar, blegtoria është pakësuar.

*(vijon në faqen 5)*



*Shtëpia e Zabit Pacit, e shkatërruar. Mars 2018*

reportazh

**Emigracioni dhe imigracioni kanë bërë edhe këtu punën vet, shumë nga fshati janë shpërgulur në vende të tjera, kryesisht në Tiranë edhe në Durrës, por edhe në Sarandë, ndërsa të rinjtë kanë kaluar në Greqi, Itali, Gjermani, Angli, madje edhe në Amerikë.**

# KASTRIOTI, fshati pa Kastriotë



*Nga* **Alban TUFA**

Kur përmendet emri Kastriot, dashje pa dashje mendja shkon tek heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, sidomos shto këtu edhe shpalljen e këtij viti si Viti i Skënderbeut. Emri i këtij fshati është intrigues për këdo që e ndesh, dhe sidomos për studiuesit e historisë të cilët ende sot nuk janë të njëmendje për prejardhjen e Kastriotëve. Por i vetmi emër pa ndryshuar lakime dhe tjetërsime është ky fshat. Në Shqipëri ka disa fshatra me emrat Kastriot (Peshkopi), Kastri (Mirditë), Kastra (Shkodër dhe Tropojë), dhe Kastrat në Has. Gjithsesi ne nuk do merremi me historinë por do njihemi sadopak me këtë fshat që mban një emër me peshë të rëndë.

Kastrioti është fshat dhe ish-komunë, sot Njësi Administrative në Qarkun e Dibrës, në verilindje të Shqipërisë. Në reformën territoriale të qeverisjes lokale të vitit 2015 u bë nënndarje e komunës Dibër. Popullsia në këtë njësi bazuar në regjistrimin e vitit 2011 ishte 6,200 banorë. Kastrioti gjendet 7-8 km, larg qytetit të Peshkopisë në drejtim të Kukësit. Rruga me makinë nga Peshkopia bëhet për 10-12 minuta.

Është muaji mars dhe bën ftohtë. Ka rënë dëborë prej disa ditësh. Vendi është i mbuluar në të bardhë. Kështu është e gjithë Dibra, krejt çka rrok syri, malet rrotull edhe fshati Kastriot mu në mesi e gropës së Dibrës. Rruga për në Kukës e ndan fshatin përmes si një mollë, duke në dy mëhalla: e poshtme dhe ajo e epërme. Fshati në perëndim kufizohet me Kuket, në jug me Brestin, ndërsa në lindje me Sohodollin, të gjitha këto fshatra janë pjesë e Njësisë Administrative Kastriot.

Unë eci buzë rrugës, është qetësi, gati drekë. Pragjet e dyerve janë me borë, pullazet e dritareve po ashtu, ndërsa oxhaqet tymosin si pleqtë e vjetër me llulla buzë tyre. Të rrallë janë të tillë pleq tashmë këtu. Shpesh ia beh ndonjë makinë aty pranë dhe mjaft sa të trazon me zhurmën e saj, që herë i jep jetë dhe herë i merr dertet këtij fshati. Para se të arrish fshatin gjenden varrezat, duket sikur i kanë pozicionuar aty vetëm për të na kujtuar të gjithëve kur kalojmë se edhe ne jemi të vdekshëm.

Kaloj varrezat dhe afrohem me shtëpitë e para që shihja së largu. Mandej zhytem në mesin e fshatit i cili nuk i ka më shumë se 50 shtëpi, përfshi këtu edhe shtëpitë e braktisura. Emigracioni dhe imigracioni kanë bërë edhe këtu punën vet, shumë nga fshati janë shpërgulur në vende të tjera, kryesisht në Tiranë edhe në Durrës, por edhe në Sarandë, ndërsa të rinjtë kanë kaluar në Greqi, Itali, Gjermani, Angli, madje edhe në Amerikë. E njoh prej kohësh këtë vend, por edhe kur nuk e njeh, mjafton të njohësh një fshat verior të Shqipërisë sepse nuk përbën ndryshim. Dimri këtej i zymton fshatrat, rrugët e zbrazëta, mungesa e zhurmave dhe mungesa e diellit shkojnë sinkron me shpirtrat e nënave që presin djemtë.

**Kulla e Leshe, qëndron akoma, duke i mbijetuar kohës gati 100 vjeçare. Ajo është një kullë trekatëshe dhe e ndërtuar me tulla dhe llaç gëlqereje. Shtëpitë e boshatisura mbartin në shpatulla vite, kujtime të pafundme dhe zhurma të pandara fëmijësh.**

Papritmas dëgjoj një Ezan që vjen nga një minare që qet krye pas një qendre spitalore, e cila nuk ka punuar kurrë. E di është e premte dhe duhet falur e xhumaja. Marr abdes dhe futem brenda. Xhamia është e re, e kanë ndërtuar ka ca vite dhe e kanë restauruar tashti vonë, këtë vjeshtë që shkoi. Brenda gjenden tre burra, dy të rinj dhe një fëmijë. Është shumë ftohtë sërish, brenda nuk asnjë llojë mënyre për tu ngrohur. Pasi mbarojnë shpërndahen të gjithë.

Edhe fshati ka si bazë ekonomike emigracionin, sërish ka familje që mbahen me bujqësi dhe blegtori. Rrugicave ndesh me ndonjë grua me ndonjë ballë apo barrë jonxhe e kashte. Kryesisht ato merren me bagëtitë përgjatë dimrit, ndërsa burrat rrinë. Kafeneja e fshatit edhe pse është mesditë, qëndron e mbushur përplot me burra dhe disa prej tyre luajnë domino, disa luajnë me letra, ndërsa të tjerë bilardo.

Shtëpitë në Kastriot janë kryesisht të reja, të cilat kanë zëvendësuar ato të vjetrat, ndërsa ato që janë të vjetra, janë vetën ato të braktisurat, përveç Kullës së Leshe, e cila qëndron akoma, duke i mbijetuar kohës gati 100 vjeçare. Ajo është një kullë trekatëshe dhe e ndërtuar me tulla dhe llaç gëlqereje. Shtëpitë e boshatisura mbartin në shpatulla vite, kujtime të pafundme dhe zhurma të pandara fëmijësh.

Kastrioti është pika ndarëse me Malsisë së Dibrës dhe Topalltisë. Pra, Sohodolli i përket Topalltisë, ndërsa Kastrioti i një ose dy kilometrave më poshtë i përket Malsisë, ose më saktë Krahinës së Çidhnës. Ndryshimet janë në zakone dhe kryesisht në gjuhë, sepse në Kastriot janë norma të tjera nëndialektore: këtë fare lehtë mund t'iu referohemi disa fjalëve ku në Sohodoll i thuhet "lugë", ndërsa në Kastriot i thuhet "lugjë"; në Sohodoll i thuhet "gisht", ndërsa në Kastriot i thuhet "xhisht" etj.

Teksa eci, përmes fshatit nëpër rrugica ndjehet lehtë mungesa e të rinjve. Shoh në pragun e një porte hekuri një plakë, e cila mban përdore një vajzë të një moshe thuajse 6-vjeç. Ajo mban në duar kokoshka dhe të sheh me ca sy të jeshiltë. Ja pra, nëpër rrugë sheh dy breza, por mungon i treti, babai ndoshta i kësaj vajze, i cili ka marrë dhenë nëpër Europë.

Me të kaluar tutje, ndeshem me një plakë, e cila mbi kurriz mban një deng kashte misri. Duke që mban në shpinë që prej larg, sepse në ballin e saj ka ca bulëza djerse. Rruga tek po ecën është dishezë, dhe tek ecën i rrëshqet këmba, ndërsa ajo ia del të mbahet dhe vazhdon rrugën për në shtëpinë e saj.

Kështu Kastrioti qëndron në mes të Dibrës. Ia del të mbijetojë në kohë. Sërish të nxjerrë breza, të tillë djem me dije, bijë prindërish me vuajtje.

# **Cerjani,** një fshat **i braktisur dhe** i rrënuar nga **migrimi**

*(vijon nga faqja 4)*

Rruga automobilistike e fshatit është në gjendje të mjeruar. Ajo është tërë gurë e gropa, e paasfaltuar dhe s'ka punëtor mirëmbajtës. Edhe ata pak njerëz që jetojnë në fshat jetojnë në kushte të vështira, sepse mungojnë kushtet social-kulturore, shëndetësore, mungon rruga, fugoni, ambulance, dyqani i tregtisë, shkolla, fryma e solidaritetit vëllazëror, etj. Përpiqen bashkëfshatarët e mi të gjorë të punojnë tokën, të prodhojnë sa më shumë patate, grurë, etj, por mungon rruga, mungon shpesh mekanika bujqësore, janë shtrenjtësuar shumë farërat e plehrat kimike e mbi të gjitha mungon tregu i shitjes së patates se shteti ynë i handakosur s'e ka mendjen te fermeri i gjorë e prodhimet e tij si administrues i jetës shoqërore, ekonomike e politike të vendit. Fshati Cerjan ka pasur poste kufitare që nga viti 1948 e deri më 1991 kur u prish sistemi. Në Cerjan janë bërë kërkime gjeologjike që nga 1965 e deri në fund të viteve 1970, për 15 vjet rresht me radhë ku janë zbuluar rezerva bakri e mangani.

Dikur ne kohen e kooperativës si në Cerjan e në mbare kooperativën prodhoheshin qindra e mijëra kv patate, te cilat shteti i tërhiqte me kamiona e i transportonte anë e mbanë vendit si ato për tregti, edhe ato për farë që dërgoheshin për t'u mbjelle në Myzeqe që në janar. Disa fshatarë që banojnë në qytet kanë mbuluar shtëpitë e tyre me llamarinë që të mos i kapë pika e të rrënohen. Disa prej tyre në pranverë e verë venë çdo ditë nga qyteti në fshat për të punuar tokat që ata të mos ngelin djerrë, por me vështirësi të panumërta, sepse mungon rruga, asfalti, mungon mekanika bujqësore, mungojnë subvencionet e shtetit në farëra e plehra kimike. Në një vend ku ndihet dora e shtetit jeta ndryshon, prandaj shteti duhet ta shohë më mirë fshatin me shpirt e mendje, me zemër e fonde se dhe atje jetojnë njerëz qe prodhojnë bukën e perimet e popullit, mishin e qumështin.



*Shtëpia e Halil Pacit, e rrënuar. Mars 2018*

Në Cerjan tani është urgjente që Bashkia e njësia administrative të investojnë në rregullimin e rrugës që të shpie në fshat, në rregullimin e kabinës elektrike të fshatit dhe në drejtime të tjera sociale. Shpresa thonë se vdes e fundit. Le të shpresojmë se jeta në fshatin tim do të rilindë e do të gjallërohet dhe fshati do të rritet e rinohet. *7.03.2018*

Dini i Zi dhe degët e tij një hapësirë
e madhe e panjohur raftingu

# Rafting lumenjve të Dibrës që s'bëzajnë

*Nga* **ABDURAHIM ASHIKU**



I kam jetuar lumenjtë e Dibrës, të vegjëlit duke udhëtuar anash tyre, duke i kaluar në ura teli apo në trungje pishe me gozhda mbi pardia, thupra apo furde.

Në Murrë jam futur hurdhave të thella e zhytas kam provuar të kap ndonjë troftë rrëshqitëse sa edhe ngjalës ia kalon.

Me Drinin jam lidhur që fëmijë kur zhytesha hapa këmbësh mbi qafën e dajë Ganiut e më vonë lidhur pas mesit me hinka, "kunguj ujës" siç i quanim dhe i mbillnim në kopsht. Më pas kam ndjerë në gjoks tallazet kur provoja të notoja kundër rrymës apo kur zhytesha thellë "Hurdhës së Mone"...

I kam njohur degët e Drinit pranverës kur shfrynin me dallgë të shkumëzuara e verës kur rridhnin aq sa nuk mbulonin gurët e zallit.

E kam jetuar Zallin e Okshtunit në burim e Zallin tek Ura e Qytetit që mbledh në shtrungë ujërat e Fushë-Bulqizës...

Kam mbush grushtet me ujë të pastër qelibar në Shtrungë e kam parë troftat të hidheshin nga 3-4 metra lartësi në ujëvarën që binte mbi Kacni e bashkohesh tek Ura e Selishtës për të marrë emrin e Katër Grykëve, Murra...

Kam pi ujë me kallam në burimet e Bjeshkës së Shehut, ato të Preshit e të Shpellasit për të mos futë këtu burimin e Bjeshkës së Ponairit ku kam një fotografi përjetësuar në kopertinën e librit "Njerëz që i dua". E kam shoqëruar Veleshicën deri në deltën që hapet para se të derdhet në Drinin e Zi.

Mollën e kam parë dhe fotografuar në rrjedhën e saj mes përmes Borie Lurës e Fushë-Lurës, në shkumëzimin e saj në teposhtën e Zabelit të Nikës, e kam kapërcyer në një urë me trungje pishe në Arrëmollë për ta takuar në Gjurë Reç e në rënien në Dri.

E kam jetuar Setën ndryshe nga degët e tjera që mjelin malet për ta përcjellë shkumën e vluar mbi Drinin Zi.

E kam jetuar në shkulmin që buron nga gjiri i malit e në rrjedhën që zbret nga liqenet. E kam fotografuar dhe jam fotografuar përballë ujit që përplaset gurëve të latuar të shkëmbit. E kam me vete negativin bardhë e zi...

E kam jetuar në "tamë të vijës", atje ku merr rrugë një kanal që i foli kohës me një "piketë me plumb pushke", me trimërinë më të pastër e më heroike të dibranëve, me rrjedhën e ujit në gjashtë kilometra mbi e mes shkëmbinjve të paarritshëm deri atëherë, me tetëqind metro tunel nëpër Gjalicat asokohe të pakalueshme...

Në korrik të vitit 1967 uji i Setës vaditi për herë të parë tokat e Çidhnës për të vijuar në vitet më tej drejt Dardhës e Reçit nga njëra anë, me sifon drejt Sinës e po me sifon drejt Fushës së Çidhnës dhe Kastriotit deri në Vakuf në dhjetor 1969...

Edhe sot, po të kalosh anës kanalit të Setës, Gjalicave, rrugicës si fije peri që varet pas shkëmbinjve, pyet i habitur "Çfarë njerëzish kanë qenë ata që u varën në këto hone të thella, që çanë malin dhe krijuan këtë vepër ujore, këtë vepër arti me përmasa mbarëkombëtare?"

Në gazetën "Bashkimi" të 30 gushtit 1967 ikona e gazetarisë shqiptare Hamit Boriçi shkruante: "...Më 1 mars filloi puna. Uji në bazë të planit duhej ti jepej fshatarëve në vitin 1969, kurse ai filloi të rrjedhë 6 muaj pas fillimit të punimeve, pra dy vjet para afatit...Ishte planifikuar të punohej gjatë tre vjetëve, të hapeshin tre tunele, të punohej në 6 fronte pune. U punua 6 muaj, u hapën 13 tunele, u punua në 26 fronte pune njeri më i vështirë se tjetri..."

Nuk ka degë të Drinit të Zi ku të jetë shkruar kaq pastër trimëria dhe begatia, heroizmi i vjetër dhe heroizmi i ri i një populli që e ka në gjak punën, shpatën dhe barotin por jo penën...

E kam jetuar Drinin e Zi dhe degët e tij duke ecë e kundruar bukuritë anash. Nuk i kam jetuar duke u përplasur dallgëve të tyre...

Asokohe nuk kishte mjete për tu zhytur dallgëve e duke u përplasur shkëmbinjvetë ngushtë vende-vende sa i takon me krah hapur.

Tash mosha nuk ma lejon, ndonëse shpirti ma do...

Me shpirt po i ftoj të rinjtë të udhëtojnë Drinit e degëve të tij, mbi kajakë apo gomone, veshur me rroba raftingu, për të tërhequr turistë në një trevë gjeografike nga më të bukurat që mund të përshkruhet...

Për kërshëri të tyre, duke shfrytëzuar një vjetar statistikor të vitit 1966 të ekonomistit të shquar dibran Shemsi Hoxha por përcjell hapësirën që krijon Dibra për spote cilësore të Raftingut...

Dibra me një pellg të gjerë ujor, me Drinin e Zi shtyllë kurrizore e të paktën gjashtë degëve të tij që rrjedhin ujë të pastër burimesh tërë vitin, është më pak e eksploruara në sportin e raftingut dhe lundrimit me kanoe.

Malet e sajë s'bëzajnë...

Hapësira e mundshme për rafting në hapësirën gjeografike prej 1569 kilometra katrore përshkohet nga Drini i Zi dhe degët e tij në një gjatësi të përgjithshme prej 179 kilometrash, hapësirë lineare më e gjata në Shqipëri.

Drini i Zi nga hyrja në Gjoricë e deri në liqenin e Fierzës, 57 kilometra gjatësi, në saj të ujit të bollshëm si dimrit edhe verës, mundëson zhvillimin e shumë sporteve ujore, individuale e kolektive, kanotazh me kanoe njëshe e me gomone të mesme e të mëdha.

I bukur udhëtimi nëpër Drinin e Zi është nga Ura e Topojanit në dalje tek delta e Katundit të Ri, në ngushticën e Muhurrit ku takohet me Murrën, në deltën e Fushë Çidhnës ku takohet me Setën e Përroin e Gramës dhe në ndrydhjen e tij nga takimi me ujërat e Veleshicës deri në Skavicë...

Në këtë rrjedhë Drini lag themelet e lashta që lidhen me Kalanë e Grazhdanit, Kullën historike të Murre nëHotesh, kullat e Dine Hoxhës në Muhurr, Sinën si vend origjina e Kastriotëve, Fushën e Kastriotit dhe atë të Fushë-Çidhnës ku flitet për Betejën e Torviollit, e para ndër 19 beteja fitimtare të Gjergjit të Gjon Dibranit kundër pushtuesve osmanë, për të vijuar rrjedhën në themele të Zallë-Dardhës djep i këngës popullore dibrane, për tu ngushtuar aq shumë midis maleve të Reçit e të Kalisit sa kur e sheh nga larg të duket sikur do ta kalosh me një kërcim një hapësh.

Harqet e këputura të një ure të lashtë në Zall-Reç të bëjnë të mendohesh e të kërkosh të dish...

Seta me një burim spektakolar në Gurë-Lurë, në tërë gjatësinë e saj prej13 kilometrash deri në takim me Drinin në Arras, është lumi ku mund të maten guximtarët në raffting nëpër kalimin mbase më të ngushtin e një kanioni ku majat e maleve duket sikur takohen. Një vendas thotë se kanionin e Setës, në rrjedhë uji, deri sot nuk njihet ta ketë kaluar askush. Rëniet e ujit në shkallë natyrore pjerrësie, ujëvarat, vorbullat dhe ato që vendasit i quajnë "gropat e zeza" janë të frikshme e ta ndalin hapin.

Seta është lumi që s'bëzan...

E ndërsa rrjedhës së ujit flitet që nuk ka kaluar askush, shpatit të thepisur të malit vendasit, mjeshtrit e mëdhenj dibranë të ndërtimit të kanaleve ujitëse, kanë shkruar një heroizëm që do të befasonte çdo turist me tregime njerëzish që e kanë jetuar.

Seta, gjykoj që është sfida më e madhe për guximtarët e raftingut, sfidë që të fton për të guxuar veçanërisht në pranverë kur ende uji i saj është në rrjedhjen e vet më të madhe natyrore, ende pa u futur në kanalet ujitëse...

Veleshica (15 kilometra) që merr e mbush rrjedhën nga burimet e Korabit është kombinimi më i bukur i turizmit malor me raftingun kanioneve të saj që mblidhen e hapen derisa qetësohen përpara se të bashkohen në Zall-Kalis me ujërat e Drinit të Zi.

Murra (19 kilometra) me burime nga malet e Katër Grykëve të Murrës, veçanërisht nga burimet e Shtrungës ku hasen një grup liqenesh, për mendimin tim më të bukur se ato të Lurës, shumë pak të vizituar e të fotografuar, ka një rrjedhë që veçanërisht nga Lunara krijon mundësi të sporteve lumore përmes një peizazhi mahnitës.

Zalli i Zerqanit (29 kilometra) dhe ai i Okshtunit (34 kilometra) i pari me burim në Vajkal të Bulqizës dhe i dyti me burime në Prodan të Gollobërdës janë një ndër udhët turistike ujore që flasin për histori qëndrese e kulturë popullore (në deltën e tyre Hajredin Pasha, në Gjoricë ku bashkohen me Drinin, siç thotë kënga, la: "Jo ma pak por dymbëdhjetë mijë")

Molla (18 kilometra) merr ujërat e Kunorës së Lurës, liqeneve emri i të cilëve i ka kaluar kohët dhe vendet për ti zbritur në një peizazh mahnitës në pasqyrë të fshatrave të Krej-Lurës, Arrmollës, Gjurë Reçit për ti bashkuar me Drinin e Zi...

Nuk kam dëgjuar që në Dibër të ketë ndonjë shoqatë apo grupim sportiv që të udhëtojë e të promovojë bukuritë e Dibrës nëpërmjet sportit burrëror të raftingut.

Nuk kam dëgjuar as që Albania Rafting Grup ta ketë shtrirë hapin e saj drejt rrjedhave ujore të Dibrës. Në faqen e saj zyrtare shoh vetëm veprimtari rafftingu në kanionet e Osumit...

Shqipëria nga Valbona në Bistricë duhet të tërheqë guximtarë të këtij sporti të bukur nga e gjithë bota duke i dhënë një hapësirë të gjerë turizmit në të gjithë hapësirën shqiptare.

Lumi Drini i Zi dhe degët që e ushqejnë atë verë e dimër janë një rrugë e madhe sportive e turistike që duhet përshkuar e përshkruar...

Ata duhet të zgjohen nga gjumi dhe të bëzajnë fort, fort, fort... si vikamat e kushtrimeve në kohë betejash...

turizëm

**Dibra ka një milion arsye përse duhet vizituar. Ajo është një zonë e bekuar nga Zoti, por e lënë pas dorë nga investimet qeveritare. Investimet e munguara, kryesisht rruga që e lidh me kryeqytetin, janë shkaku që ky rajon është i prapambetur në aspektin e zhvillimit ekonomik.**

# Dhjetë **arsye** përse duhet vizituar **Dibra**

*Nga* **Samet ZAGRADI**




*Bulevardi i blineve. Foto © FB/Ketumblidhendibranet*

**Bulevardi i Blinave. I ndërtuar në vitin 1967, njihet sot si simbol i Peshkopisë. Blinet janë veçantia më e bukur e këtij qyteti dhe njihet nga njerëzit si "shëtitorja e blineve".**

Dibra ndodhet lindje të Shqipërisë, në një terren pothuajse malor. Ajo shtrihet në dy anët e Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje me malin e Korabit, mali me i madh në Shqipërisë dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Është një zonë ku Zoti është treguar shumë bujarë me bukuritë dhe pasuritë natyrore. Banorët e kësaj zone kanë fatin e mirë të jetojnë në një vend të bekuar nga Zoti, por fatin e keq që në këtë krahinë politika është bërë pengesë e zhvillimit total të kësaj zone. Pavarësisht këtij fakti, Dibra duhet vizituar për të parë dhe shijuar nga çdo aspekt që e bën kaq tërheqëse. Më poshtë, po rendimsim 10 arsye (sipas nesh) se pse duhet vizituar Dibra:

***Mikpritja dibrane.*** Dibranët prej brezash mbeten unikë për respektin dhe mënyrën se si pritet një mik. Në Dibër, miku, pavarësisht rëndësisë apo situatës ekonomike, pritet akoma me nderime dhe respekt të veçantë. "Shtëpia është e mikut, më pas e zotit të shtëpisë". Miku mbetet kryesori, madje sipas disa historive të vjetra, një zonjë sakrifikoi fëmijën e vogël, duke i dhënë ushqimin mikut si shenjë vlerësimi për atë që shkeli pragun e derës. Përveç miqve familjarë, njerëzit që nuk janë nga Dibra ndihen si në shtëpi, pasi dibranët njihen si njerëz bujarë dhe të besës. "Bukë, kripë e zemër të bardhë" është shprehja që tregon se Dibra di si ta respektojë mikun.

***Ushqimet tradicionale.*** Të parezistueshme, mjaftë të veçanta dhe çfarë është me e rëndësishmet ushqimet tradicionale të Dibrës janë plotësisht bio. Ndoshta disa nga ju vetëm keni dëgjuar dhe nuk keni pasur rastin të provoni të famshmet "jufka me pulë" apo "flinë me renda", dy nga ushqimet më tradicionale të zonës. Disa ushqime tjera që ju këshillojmë të kërkoni, sa herë rruga ju çon në Dibër, janë brijani, sheqerparja, paça etj. Dibra gjithmonë ka një kuzhinë të veçantë. Amvisat dibrane nuk harrojnë traditën, duke e trashëguar nga një brez në tjetrin. Byrekët, zahiretet e dimrit, sallatat, pastramaja e shumë ushqime të veçanta, në Dibër kanë një shije krejt të veçantë.

***Prodhimet bio.*** Janë karakteristike të zonës. Natyra është treguar bujare me terrenin ku kjo zonë shtrihet. "Mollët e Dibrës" janë mjaftë të njohura në të gjithë Shqipërinë. Kanë një shije të rrallë. Rritur larg pesticideve, produkte të zonës si patatja, gështenja, arra, lajthia perimet e shumë të tjera mbajnë një aromë dhe shije mjaftë të mirë. Produktet e bulmetit zotërojnë cilësinë e parë dhe janë mjaft të kërkuara kudo. Djathi, gjiza, qumështi dhe nënprodukte të tjera të qumështit si dhe ato të mishit kanë origjinën tërësisht natyrale që kohët e fundit sa vijën e bëhen më të rralla. Mjalti është i kërkuar edhe jashtë territorit dhe është vlerësuar në cilësinë më të mirë nga ekspertët e fushës. Fabrika e lëngut të mollës bio në Tomin dhe suksesi në tregun vendas është dëshmia e suksesit dhe e cilësisë së produkteve dibrane.

***Turizmi malor.*** Dibra njihet si një zonë me një reliev të thyer që të jep mundësinë që të zhvillohet turizmi malor. Lura dhe mali i Korabit janë dy nga vendet kryesore që patjetër duhen vizituar. Lura me shtatë liqenet e saj ka bërë që ai vend të jetë një nga vendet kryesore që duhet vizituar nga turistët. Mali me i lartë në Shqipëri, mali i Korabit kohët e fundit është bërë një destinacion i mirë turistik nga shumë turistë të huaj. Pamja përrallore që të shfaqet kur ti ngjitesh më majën më të lartë është me të vërtetë mahnitëse. Destinacion të tjera turistike interesante janë Selishta, Bulaçi, bjeshkët e Gramës, të Ilnicës etj. Në territorin e Dibrës kalon dhe lumi më i gjatë në Shqipëri që mund të përdoret për turizëm dhe për ushtrimin e sporteve si rafting. Çiklizmi malor është një tjetër sport që po lulëzon kohët e fundit, ndërsa alpinizmi që ka qenë traditë.



*Foto © G.Uka*

***Kultura:*** Aspektet kulturore në zonën e Dibrës janë mjaftë të pasura dhe unike nga të gjithë zonat e tjera. Traditat, zakonet, veshjet, vallet, muzika, leksiku e shumë aspekte të tjera e bëjnë Dibrën shumë të veçantë. Origjinale mbetet odat dibrane. Diskutimet dhe debatet e odave duan një mprehtësi dhe inteligjencë që ti kuptosh, madje shumë herë mjaft të vështira për tu kuptuar nga masa. Festivali i përvitshëm "Oda Dibrane", që mbahet në vjeshtë, është kthyer në një traditë të përvitshme të këngës, valles humoristike dhe alegorisë. Ky festival mbledh rapsodë dhe valltarë nga të gjitha trojet shqiptare.

***Natyra.*** Zoti është treguar bujar më natyrën. Mund të gjesh çfarëdo që të kërkosh: malin, fushën, lumin, ujin dhe mijëra llojë speciesh të faunës dhe florës. Parqet kombëtare, bjeshkët e pafund, bimësia dhe aspekte të tjera natyrore e bëjnë këtë vend të veçantë. Ujërat termal të Llixhave janë një tjetër burim që tërheq mijëra vizitorë në vit. "Ato kanë ujin më të nxehtë dhe më kurativ në Ballkan", thonë specialistët. Bimët mjekësore që gjinden në bjeshkë, përveç vlerave të padiskutueshme që kanë, shërbejnë edhe si një mënyrë jetese për banorët e zonave malore. Ajri dhe uji janë dy pasuritë e tjera që nuk shpjegohen me fjalë.

***Arkitektura:*** Mjaftë e veçantë është edhe mënyra se si mjeshtrit e ndërtimit në Dibër kanë ndërtuar banesat e tyre. Një nga fshatrat që ka ruajtur traditën e ndërtimit më gur është Rabdishti, ku çdo cep i fshatit është i shtruar me kalldrëm dhe shtëpitë e forta me gur. Kullat e larta si ajo Zunës në Sohodoll, e Dine Hoxhës në Muhurr, e Markut në Zogje, e Hupit në Bulqizë, janë dëshmi e gjallë e arkitekturës së mjeshtrave të ndërtimtarisë në Dibër.

***Historia***. Dibra ka qenë qendër e përpjekjeve të shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Ushtritë e osmane e serbe, duke u bazuar në pozicionin gjeografik, e kanë përdorur Dibrën si rrugë për dalje në det. Heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu e ka vendlindjen në Dibër dhe 26 betejat e tij kundër perandorisë osmane i ka zhvilluar në Dibër. Elez Isufi mbahet mend si udhëheqësi që organizoi luftën kundër pushtuesve serb, ndërsa Dom Nikollë Kacorri ishte edhe firmëtar i pavarësisë si dhe nënkryetari i parë i qeverisë së Ismail Qemalit. Po ashtu, Haxhi Vehbi Dibra ishte kryetari i parë i parlamentit në shtetin e ri. Të shumtë janë emrat, ngjarjet, datat dhe veprat që Dibra dhe dibranët kanë bërë në histori.

***Bulevardi i Blinave.*** I ndërtuar në vitin 1967, njihet sot si simbol i Peshkopisë. Blinet janë veçantia më e bukur e këtij qyteti dhe njihet nga njerëzit si "shëtitorja e blineve". Ajo është rreth 600 metër dhe në dy anët e këtij bulevardi janë vendosur institucione kryesore, bare dhe restorante, hotele e pjesë të tjerë të shërbimeve. Gjatë verës së vitit 2016 nisën punimet për ndërtimin dhe kthimin e bulevardit në pedonale.

***Llixhat e Peshkopisë.*** Llixhat e Peshkopisë ndodhen rreth 1.5 km larg qendrës së qytetit. Ato burojnë nga formacionet e gipseve. Janë dy burime sulfurore me një temperature 35-43. 5 gradë celcius dhe me një prurje prej 14 litrash për sekond. Ato kanë përmbajtje kaliumi dhe sulfatesh. Efektet e tyre lidhen me sëmundjet e rrugës së frymëmarrjes si astma bronkiale, bronshite, reomatizmi, diabeti, sëmundjet e lëkurës dhe problemet gjinekologjike. Sipas specialistëve ujërat e llixhave të qytetit Peshkopi janë më të nxehta dhe si rrjedhojë janë më efektivë në shpejtësinë e shërimit të sëmundjeve.

* * *

Dibra ka një milion arsye përse duhet vizituar. Ajo është një zonë e bekuar nga Zoti, por e lënë pas dorë nga investimet qeveritare. Investimet e munguara, kryesisht rruga që e lidh me kryeqytetin, janë shkaku që ky rajon është i prapambetur në aspektin e zhvillimit ekonomik.

# "FERRA E PASHËS"



Nga **SHAQIR SKARRA**

Plaku Zenel Dika, kishte ardhë enkas nga Luznia në Sinë, për të marrë pjesë në përurimin e "Muzeut të Kastriotëve". Edhe pse i kishte tetëdhjetë vjet kokërr në kokërr, mbahej ende i fortë. Trupi i tij i rreshkur, pak i imët, dukej si dru thane që nuk thyhet kollai. Koka e bardhë nën qeleshe, ishte plot mend dhe të paplakura. Ishte një dibran tipik nga karakteri, burrëria dhe muhabeti. Zenel Dikën, e kishte sjellë këtu krenaria dibrane: Ky muze vërtetonte edhe një herë se Skënderbeu, ishte dibranë. Ja vlente rruga e gjatë që bëri, për të dëgjuar me veshët e tij historianët që e vërtetonin këtë.

Këtu takoi mikun e tij, mësuesin e historisë, Tomorr Lika. U lidh me të dhe nuk u ndanë. Bashkë shkuan në sallën e konferencave për të dëgjuar kumtesat që do të mbaheshin me këtë rast. Mësuesi i historisë, ishte i interesuar, se i kishte vënë barrë vetes të hulumtojë etnografin dibrane. Këto kumtesa i vlenë shumë atij. Për herë të parë mësoi rëndësinë e madhe që paskan toponimet, pas të cilave fshihet një pjesë e historisë. Tomorr Lika, u habit se ishin toponimet që ruhen edhe sot që vërtetonin se Gjon Kastrioti, kishte banuar në Sinë...

Tek po dilnin nga salla, plaku e zuri për krahu mësuesin dhe në vazhdim të kumtesave i tha:

-Dibrës i kanë munguar përherë kalemxhijt për të shkruar historinë e saj. Në mungesë të tyre, dibranët e mbushën këtë boshllëk, me emërtime nga më të ndryshmmet që të mos harrojnë ngjarjet, zakonet e tyre. Pas këtyre toponimeve, si e quani ju, ruhen ngjarje historike që kanë mbetur si murane që nga kohë të hershme. Në Dibër, Tomorr, i gjen me bollëk këto emërtime. Ato janë si sinoret e arave...

Mësuesi i historisë i mori si vrejtje në adresë të tij këto fjalë të plakut. Atë e habiste ky plak i pashkollë që e njihte historinë e Dibrës më mirë se ai. Zenel Dika, me njohuritë e tij, ju çfaq si një kronist që silltë një kujtesë për një epokë pothuajse të "harruar".

Kur erdhi koha për t'u ndarë, plaku i tha:

-Mos u ngut. Nëse nuk e ke bezdi e bëjmë rrugën bashkë. Në katundin ku ti je mësues, kam një vajzë të martuar. Me që jam në mes të rrugës, po vij ta shoh si i ka hallet.

Tomorr Likës i qeshi nuri. Shok më të mirë për këtërrugë të gjatë, zor se mund të gjeje.

Dolën nga Sina dhe zbritën në Dri. Ura mbi lumin Drin, ishte një lloj pasarele që kur ecje mbi të, lëkundej si kolovajzë. Tomorri e kishte tmerr këtë urë. Plaku tek e pa që dridhej, i dha dorën dhe kaluan përtej.

Lanë pas lumin dhe hynë në një korije shelgjishtesh që me freskinë dhe bukurinë e saj të mahniste. Shtegu i ngushtë tek kalonin, nuk të jepte arallëk për muhabet. Kur dolën nga koria, para tyre u çfaq fusha e gjerë, katundet e rralla që kishin zënë vend brij kodrave të bukura e të veshura që rrethonin këtë hapsirë dhe ngjasonin si shkallët e një amfiteatri gjigand. Zeneli e theu heshtjen:

-Tani po shkelim në Çidhën. Nëse malet e Dibrës, kanë seicili meritën e vet, Çidhna, ka një pëllëmbë më tepër...por që në fakt çidhnakët duan edhe më shumë se kaq.

Mësuesi nuk e kapi menjëherë këtë metaforë edhe pse nuk qe dakort me mendimin e plakut. Deshi ti përgjigjet, por ai bëri përpara. Ecte si një djalë i ri. Terreni ku po shkelnin, ishte një djerrinë, që jeshilonte nga bimët e fierit që të arrinin deri në brez. Zenel Dika u ndal bri një shkëmbi që ngrihej i vetëm si një piramidë e tejdukshme nga larg.

-Ulemi e pijmë nga një cigare - sugjeroi plaku.

Tek po çlodheshin, Zenel Dika, i cili jo pa qëllim e kishte ulë në këtë vend, hyri në muhabet:

-Tamam këtu, ku jemi ulur, dikur kanë

> -Dibra, biri im, ka parë shumë e ka hequr shumë. E kanë vrarë, e kanë prerë, e kanë djegur, por kurrë nuk arritën t'a nënshtrojnë... Pashallarët osmanë që erdhën në Dibër gjithmonë kanë ikur të mundur prej këtej. Këtë fat pati edhe Hysni Pasha...

ndejtur burrat më në zë të maleve të Dibrës. Këtu ka qenë logu i Kuvendit të Dibrës.

Mësuesi, kureshtar edhe pse në fakt dinte shumë pë historinë e Dibrës përsëri e pyeti si kureshtar:

- Si i thonë këtij vendi?

- "Ferra e Pashës" - u gjegj plaku. -Po më habisni, foli përsëri plaku- Mendoj se nuk ka dibranë që nuk e din ku bije ky emër!

Mësuesi e gëlltiti këtë kunj pa ditur si të justifikohej. Kishte dëgjuar për këtë toponim, po se ku bie nuk e kishte paturfare idenë. U vu ta sodisi këtë emër të çuditshëm që në fakt i erdhën në kujtesë mjaft ngjarje e histori por që nxënësve të tij nuk ua kishte thënë kurrë më parë. Një lëmë vend hapej para shkëmbit që dikur do të kishte qenë një lëndinë. Pak më tej një fierishte që e mbyllte një kodër e veshur nga drujt e gështenjave. Në krah të majt të këtij "lëmi" jeshilonte bari nga një shtonë uji që rridhte i pakët, i përgjumur, si një fije kashte. Brij shkëmbit, harlisej një ferrë e madhe që nxinte nga manaferrat.

Plaku po tymoste kokëulur e i heshtur. Mësuesi, me "injorancën" e tij, ja kishte prishur disi humorin. Deshi të pajtohej më në fund me të. Ndaj edhe e pyeti:

-Jam kureshtar t'a dij, si ka mbetur ky emër? Ju me siguri duhet t'a dini. Nëse nuk e keni bezdi, flisni...ju lutem më tregoni gjithë sa dini. Unë sot jam si një nxënës i dobët përballë një mësuesi të kualifikuar e me mjaft përvojë të gjatë.

Plaku, i përkiste atij brezi të hershëm që ishte përfshirë në luftërat e gjata kundër osmanëve dhe serbëve për të mbrojtur lirinë e vatanin. Zenel Dika, ishte një nga ata. Në një këngë të hershme, përmendet edhe babai i tij që ra në përpjekje me turqit. Ndoshta ishin të gjitha këto që ai ruante një nostalgji për të kaluarën e Dibrës. U bind më së fundi që të flasë.

Mësuesi po e sodiste me vëmendje plakun. I bështetur pas shkëmbit, ngjasonte me të. Fytyra e tij e rrudhosur, e hequr, thatine, me mustaqet pak të varura, dukej si një bust i gdhendur në gur. Shikimi i tij dukej pak i mjegulluar sikur po ëndërronte. Zëri i tij i butë, i shtruar, vinte si jehonë që dilte nga shkëmbi:

-Dibra, biri im, ka parë shumë e ka hequr shumë. E kanë vrarë, e kanë prerë, e kanë djegur, por kurrë nuk arritën t'a nënshtrojnë... Pashallarët osmanë që erdhën në Dibër gjithmonë kanë ikur të mundur prej këtej. Këtë fat pati edhe Hysni Pasha...

Ai erdhi në krye të një ushtrie të madhe për të nënshtruar Dibrën. Kudo që vuri këmbën, la pas gjurmë gjaku dhe e bëri vendin shkrumb e hi. Katil i madh kishte qenë. Në këtë vend ku ne po rrimë sot, , ai ngriti shatorret dhe shtabin e tij. Këtu nxinte vendi nga çadrat e ushtrisë së tij. E shikon atë shtonën e ujit që sot rrjedh si fije peri, dikur ka qenë një krua që nxirrte një krah ujë. E zgjodhi këtë vend buzë lumit Drin që pasi të lante hesapet me Çidhnën, ti përveshej malësisë...

Çidhna e pësoi më keq nga ekspedita e tij. Pas luftimeve të përgjakshme, çidhnakët u tërhoqën, kaluan Drinin me gra e fëmijë dhe u hodhën matanë e u strehuan në malësi. Para këtij rreziku, malet e Dibrës u mblodhën në Kuvend dhe lidhën besën për t`i bërë ballë këtij pashai të egër. Beteja të ashpra janë bërë luginës së Drinit, ku ishte përqendruar edhe ushtria e tij. Dibranët në këtë luftë përdorën taktikën e goditjeve të befasishme, nga krahët duke mos u lënë kohë t`a mbledhnin veten. Këto luftime në një front të gjerë, e lodhën dhe e raskapitën ushtrinë turke, duke ja ngushtuar çdo ditë vallen.

Erdhi sahati për t`i dhënë goditjen e fundit, për t'a sulmuar m'u këtu, në zemër ku pashai kishte shtabin e tij. Për gjithë natën grupe malësorësh, zbritën nga malet, kaluan Drinin me not dhe erdhën e u ngjeshën në Shelgjishtet që mbulonte zallishten e lumit. Grupe të tjera e rrethuan nga krahët për ti prerë rrugën e tërhqjes. Një orë para se të zbardhte sabahu, dibranët bënë hoxhum me thirrjet e tyre "a besa-besë"! Sulmi i dibranëve ngjante me një shtrëngatë që s'kishte zot që i dilte përpara. Dukej se u përmbys bota. Në më pak se pesë sahat, turqit u thyen dhe dibranët shkelën shtabin e pashait. Flamurët e bardhë stolisnin çadrat e ushtrisë osmane...

Kur dibranët futën në dorë shtabin, u sulën drejt çadrës së pashait. Ai nuk ishte aty. As oficerët e kapur rob nuk dinin gjë për zhdukjen e tij. U derdhën për t'a kërkuar midis çadrave dhe robërve. Dikush e pikasi bash këtu, i strukur në ferrë tek dridhej si një lepur...

Një shakaxhi e pagëzoi këtë shkurrre "Ferra e Pashës"!

Krerët e maleve, u mblodhën këtu në kuvend për të vendosur për robërit dhe për të ndarë plaçkën e luftës që ishte me bollëk... Kuvendi vendosi që ky vend do të ishte këtej e tutje edhe logu i kuvendit të maleve të Dibrës. Ishte edhe një nder që i bëhej Çidhnës, e cila hoqi më shumë në këtë luftë...

Mësues! E kam arritur edhe unë atë kohë, kur këtu vazhdonte të mblidhej kuvendi i burrave të Dibrës.

Tomorr Lika, mbeti i befasuar nga ky rrëfim. Plaku, Zenel Dika, ulur këmbëkryq, mbështetur pas shkëmbit, ngjasonte me tregimtarët e lashtë që u bënin jehonë luftrave epike. Kështu pati treguar edhe Homeri për Luftën e Trojës.

Edhe për shumë kohë, i mbeti në mendje mësuesit të historisë, Tomorr Likës, "Ferra e Pashës", ky toponim me këtë emër grotesk, që ruante të fshehtat e një lufte heroike bashkë me sarkazmën dhe ironinë e dibranit.

Mësuesin e shqetësonte "harresa" "indiferenca" dhe "pakujdesia" e brezave që erdhën me sfidën e tyre ndaj kësaj epoke zulmëmadhe. E keqja e kësaj harrese vazhdon. Në vend të një memoriali që do të përjetsonte këtë trashëgimi, është natyra që sfidon historinë, e ka ruajtur të paprekur atë shkëmb dhe shkurrën e ferrës, ashtu siç ishte njëqind vjet më parë...

Ani! Ky toponim do të mbetet edhe pas këtej si një copë legjende. Por, medet! A do të ketë më një plak që do t'u tregojë brezave që do të vijnë, si mbeti emri "Ferra e Pashës".

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

profil

**Do të vijë dita, kur njerëzit ta quajnë fat, të prenotojnë disa ditë pushimi në resortin e tij turistik. Jo vetëm Pajtimi do të jetë i fituar, por dhe Maqëllara e Dibra. Ndërtimi i rrugës së Arbërit do ta shpejtojë këtë ditë.**

# PAJTIM BEÇA, një histori suksesi në breg të Drinit

*Nga* **Osman XHILI**

Njëzetë vite më parë, Pajtim Beça nga Vojnika e Maqëllarës, po hapte një rrugë me fadromë, nga ura e Topojanit, përgjatë bregut të lumit Drin. Nga gjyshi kishte trashëguar një copë toke dhe mendja i shkonte të bëjë diçka në atë vend. Tre muajt e verës do të bënte hamburgera, apo ndonjë ushqim tjetër të shpejtë për fëmijët që do të vinin për tu larë në lumë. Dikush tha se djali paska lajthitur, pasi aty vetëm ferra kishte dhe pak bar për të kullotur dhentë. Babai i tij, Allamani i bërtiti, se po i hidhte në lumë ata pak lekë që kishin kursyer, me shumë mund e sakrifica. Me shumë vota kundër, por me dëshirën dhe pasionin pro, Pajtimi filloi të hedhë hapat e para. Baraka që kishte ngritur në fillim, filloi të marrë formë të re e të zbukurohej. Jo vetëm fëmijë, por dhe të rritur filluan të vinin, madje jo vetëm nga zona, por dhe nga larg. Pajtimi, bashkë me të shoqen, vinin çdo ditë nga fshati, diku tre kilometër larg dhe sërish në darkë shkonin të lodhur. Dukej më e udhës që banesa e tyre, të ishte pranë lokalit, pasi ashtu do të ishte më e kollajtë për të menaxhuar punët e shumta që kishin përpara.



**Pajtimi shpreson një prodhim të mirë mjalti, pasi shenjat duken premtuese. Por veç këtij produkti, nga bleta merr dhe qumështin e saj, apo të tjera gjëra me vlerë si propolisi dhe poleni. Që të katër këto produkte të bletës, luftojnë një seri sëmundjesh dhe rrisin mjaft imunitetin e organizmit, ndaj rreziqeve të ndryshme.**

### RESORTI TURISTIK

Pajtimi e kishte të qartë, se njerëzit nuk donin vetëm detin për të pushuar, por dhe lumin, pyllin, ajrin e pastër, cicërimat e zogjve. Donte të bëjë shumë gjëra njëherësh, por duheshin shumë para. Shteti kurrë nuk e ndihmoi me ndonjë kredi të butë, apo financime të ndonjë lloji tjetër. As për rrugën, as për ndriçimin, as për lokalin. Ashtu, duke bërë hapa të vegjël, por të sigurt, biznesi i tyre familjar rritej e rritej, duke zgjuar ide e dëshira të reja. Sot, pas njëzetë vitesh, ai kthen kokën pas dhe as vetë nuk e beson se si rrodhën gjërat. Ai ka një lokal të bukur, por një tjetër më i madh, më komod e më modern, po ngrihet pranë të parit. Nga tre muaj që e pat menduar, Pajtimi punon, pothuaj se gjithë vitin. Gjithë familja është e punësuar aty. Ai, bashkë me të shoqen, Fidanen, kurse fëmijët, vajza që po mbaron shkollën e mesme dhe dy djemtë më të vegjël, i ndihmojnë pas mësimeve. Disa djem të rinj, punojnë si kamarierë në pikun e sezonit të verës.

Gatimet e Pajtimit janë tejet të veçanta. Ai që i ka provuar njëherë, nuk mund të qëndrojë pa ardhur sërish, por tashmë jo vetëm. Do të ketë marrë dhe miq e shokë të tjerë. Para dy javësh erdhën për të drekuar tetë italianë që kanë lidhje pune me një firmë vendase. Morën në telefon dhe prenotuan mish të gatuar e të zier në qumësht. Mishi i qingjit, i bashkuar me qumështin dhe erza të ndryshme, qëndrojnë në furrë për katër pesë orë. Cili stomak në botë do ti rezistonte një oferte të tillë e nuk do të tejngopej? Në fund ata u shprehën se nuk kishin konsumuar kurrë mish më të shijshëm. Këtë metodë Pajtimi e ka mësuar nga gjyshi, që shpesh u thoshte në shtëpi të bënin një gatim të tillë. Të shumtën e kohës, Pajtimi mban deri në pesëdhjetë qingja e keca, dhe njerëzit mund ta zgjedhin vetë po të duan. Ka dhe pula e gjela në fermën e tij, bile ka në projekt, të ndërtojë një stallë me kapacitet prej 50 viçash. Pothuajse gjitha ushqimet te restoranti i tij janë bio. Kecat e qingjat, që i zgjedh vetë te fermerët, speci me gjizë, që e përgatitën e shoqja, sallatat e ndryshme, turshitë me domate, karrotë e kastravecë. Ullinjtë i merr vetë dhe i përgatit në disa mënyra, saqë habiten dhe njerëzit që vijnë nga jugu. Vajin e ullirit e merr prej vitesh në Ndroq, ku shpesh pëlqen ata të egrit.



Nuk janë të pakta rastet kur në lokal vijnë turistë të huaj, francezë, zviceranë, italianë, gjermanë e austriakë. Parvjet pati 22 veta, njëherësh, Nuk kishin pretendime për të fjetur, hapnin çadrat dhe flinin në ajër të pastër. Ja, kështu shtohen njohjet e reja, takimet, shkëmbehen kartëvizita, shkëmbehen përvojat, gjuhë dhe kultura të ndryshme nga e gjithë bota.



### PARKU I BLETËVE

Gati njëkohësisht me lokalin, Pajtimi bleu dhjetë koshere blete, sa për nevojat e familjes dhe për të qerasur ndonjë mik të rëndësishëm. Shumë shpejt u bënë tridhjetë, më pas akoma 120 koshere dhe tani shifra ka shkuar në katërqind, si një ortek masiv, që i shumëfishon përmasat shumë shpejt. Dikush mund ta dijë të lehtë punën me bletën, por ndoshta gabohet. Kosheret e blera, pitet që duhen vënë, të ushqyerit në pranverë e vjeshtë, kurimi i sëmundjeve, janë probleme me shumë ndikim në prodhimin e mjaltit, në sasi e cilësi. Një specialist amerikan, duke folur për rrezikun e Varroatozës, thotë se ajo po pëson rritje të ndjeshme në numër e për pasojë rrezikshmëri të lartë. Nga dy përqind, në vitin 2002, po shkon në 20 përqind në vitin 2020, duke paraqitur kështu një rrezik serioz.

Ashtu si për restorantin, Pajtimi dëshiron termin bio dhe te puna me bletën. Kurimet në parkun e tij të bletëve, i bën me bimë mjekësore shumë efektive. Hithrën e përdor për të luftuar Vartozën, kurse nenexhikun për të luftuar diarenë dhe problemet e barkut. Por koncepti bio për bletarin tashmë të fuqishëm, shtrihet akoma më tej. Jo vetëm që nuk bëhet fjalë për hile që mund ti bëhen mjaltit, por dhe punimi i piteve bëhet në një mënyrë mjaft korrekte. Ka vite që ka blerë një makineri të thjeshtë për të bërë pitet me dyllin e tij. Pitet e prodhuara në këtë mënyrë, janë njëqind përqind me dyllë dhe i kushtojnë më lirë, kurse te blerat kanë vetëm 30 përqind dyll dhe 70 përqind miell misri e parafinë. Për pasojë, bleta e ka shumë të vështirë për të ndërtuar hojet, në rastin e dytë, pasi ka shumë pak material të pastër në dispozicion. Prodhimi i piteve me atë makineri të thjeshtë i merr familjes shumë kohë dhe energji. Atyre u duhen rreth gjashtë mijë pite në vit, kur ato nuk mund të prodhojnë më shumë se 40 fletë të tilla në ditë, pra mbi katër muaj. Por gjithë ky stërmundim mund të kapërcehet lehtë, nëse pajisja e thjeshtë do të zëvendësohej me një makineri më të madhe. Ajo gjendet fare lehtë në Tuqi, apo diku tjetër, mjafton të paguash një shumë prej 43 mijë eurosh. Bile, jo vetëm Pajtimi do të shpëtonte, por të gjithë bletarët e zonës, pasi do ti punonin pitet e tyre me të njëjtën makineri. Kur bleta ka hyrë në listën e kuqe, si specie në zhdukje, a nuk do të duhej dora e shtetit, për të ndihmuar këta bletarë të talentuar, duke u blerë një makineri të tillë, apo duke shtuar pak më tepër subvencionet?

Këtë vit Pajtimi shpreson një prodhim të mirë mjalti, pasi shenjat duken premtuese. Por veç këtij produkti, nga bleta merr dhe qumështin e saj, apo të tjera gjëra me vlerë si propolisi dhe poleni. Që të katër këto produkte të bletës, luftojnë një seri sëmundjesh dhe rrisin mjaft imunitetin e organizmit, ndaj rreziqeve të ndryshme.

Shumë punë të mëdha e presin Pajtimin dhe familjen e tij kësaj vere. Restoranti i ri që po hedh shtat, magazina e re për pajisjet e bletës, rrethimi i parkut dhe gjithë territorit me rrjetë teli, ndërtimi i disa shtëpizave prej druri për turistët e huaj, do të jenë prioritetet. Ai hedh shikimin afër dhe larg, në të njëjtën kohë. Shumë shpejt do të vijë dita, kur njerëzit ta quajnë fat, të prenotojnë disa ditë pushimi në resortin e tij turistik. Jo vetëm Pajtimi do të jetë i fituar, por dhe Maqëllara e Dibra. Me siguri, që ndërtimi i rrugës së Arbërit do ta shpejtojë këtë ditë.

Rruga e Arbërit nr. 143

**I rritur me korrektesën në orar, me rigorozitet në regjimin ditor, këto formësuan tek Asllani vlerësimin për kohën në funksion të detyrave kryesore dhe atyre ndihmëse, nxitën aftësinë për të punuar në grup dhe për të marrë përgjegjësi lideri.**

portret

# **Asllan Keta**: Më shumë se Partinë, dua Shqipërinë

*Nga* **Azis KETA**

**JETESHKRIMI I ASLLAN KETES**

Asllan Keta, sipas dokumentacionit zyrtar dhe arkivor ka lindur më **6 Maj 1928** dhe, këtë vit, ka ***90 vjetorin e lindjes***. Respektohet kjo datë sepse ajo shoqëron jetëshkrimin e tij në arkiva dhe në libra historikë. "*Ishte i biri Bajramit dhe Tushes - shkruhej në "Certificatë- Lindje" lëshuar në shtator të vitit 1938, kur Asllan KETA, sipas dëshmisë që përpilonte mësuesi i shkollës fillore Asllan Zeneli. Kishte përfunduar tremujorin e parë të vitit të tretë të shkollës së detyrueshme fillore në Bulqizë".* ***(AQSH, Nëprefektura e Artës (Zerqanit), f 284, v. 1938, d. 284, fq 2-3).***

- **Me vendim të Ministrisë Arsimit Nr 37 dt. 23.VII. 1938**, u vendos kuotë pranimesh në "Internatin Dibra" të Kastriotit për vitin mësimor 1938- 1939 gjithsej 25 veta. ***(AQSH, f.295, v. 1938, d. 152)*** Nga këto, 10 bursa i planifikoheshin Nënprefekturës Zerqanit. ***(Po aty, Nr 187/VI Res, Peshkopi më 12.09. 1938, fleta 141).***

**- Me vendimin Nr 91. 27. 08. 1938 të Këshillit Adminitrativ të Nëprefekturës Artës (Zerqanit**), në nuërin rendor 4 ishte emri i Asllan Bajram KETA nga Koçaj Bulqizë.

- Ministria e Arsimit më datë 29. 07. 1938 miraton këtë listë me shkresën Nr. 317/II Res, Tiranë, dt. 27. 09.1938.

- Në listën e nxënësve që raportonte "Internati Kastriot" për vitin mësimor 1938- 1939, nga 98 nxënës gjithsej, Asllan Bajram KETA ishte i regjistruar në klasën e tretë me 24 nxënës dhe mbante numrin 16 në listën e kësaj klase. ***(AQSH, f. 295, v.1938, fq 357)***. Po në këtë klasë, nga Bulqiza ishin: Hysen Ali Alliu, Qamil Mustafa Gjini dhe Muharrem Dullë Gjini.

- Në listën e nxënësve të klasës katërt në "Internatin Dibra"për vitin mësimor 1939- 1940, Asllan KETA mbante nr rendor 47 ndërsa në vitin e pestë 1940- 1941 nr rendor 42.

- Në shtator 1941- prill 1943 Asllan KETA ishte në Institutin Bujqësor të Kavajës dhe mbylli edhe semestrin e parë të vitit të tretë, nga katër vjet që ishte programi studentor i Institutit.

- Në prill- qershor 1943, Asllan KETEN e gjejmë të përfshirë në lëvizjen studentore dhe në maj 1943 kishte kaluar në ilegalitet sepse ndiqej.

- Në qershor 1943, Asllani ishte në listën e 17 studentëve që ju bashkuan Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Ja lista: Njazi Islami, Emin Agolli, Rexhep Doda, Asllan KETA, Sali Hoxha, Prokop Murra, Muntaz Kodra, Veli Cani, Vehbi Skënderi, etj. (Lufta Nacionalçlirimtare e Populli Dibranë, 23 gusht 1969, komisioni redaktues, fq 47).

- Asllan KETA në qershor 1943 mbante numrin 11 në çetën partizane të "Grykës Madhe" nga 56 veta gjithsej. Po në këtë çetë, në numrin rendor 46 ishte Sadik KETA ***(Po aty, Historiku Br18S, fq 331)***

- Aksionin e parë luftarak në Dibër, Asllan KETA e bëri më 22 qershor 1943 tek "Hani Trebishtit" të zonës Gollobordës. Këtu u zhvillua "luftim në pritë" kundër një autokolone italiane që lëvizte nga Struga në Dibër. Në këtë aksion, çeta vrau 3 karabinierë italianë, zunë 5 robër, ndër ta 1 oficer.

- Asllan KETA pas disa luftimeve në Dibër delegohet në batalionin e Çermenikës ku komandonte Gafurr Mehmeti. Në batalionin e Çermenikës kombinohej magjishëm përvoja e një komandanti në moshë të pjekur dhe i rreshkur në llogore me një student që vinte nga radhët e demonstruesve antifashistë.

Në batalionin e Cermanikës Asllan KETA sillte, veç inteligjencës së një studenti të shkollës amerikane edhe përvojën luftarake të çetës/batalionit të Dibrës me në krye mikun e shtëpisë së tij, Haxhi Lleshi.

- Në Çermenikë Asllan KETA përballojë situata tepër të vështira, sidomos në "Operacionin e Dimrit". Në këtë periudhë, Asllan KETA mori plevit të rëndë, por asnjëherë nuk e braktisi Luftën.

**NË BRIGADËN E XVIII SULMUESE**

Qysh në krijimin e Brigadës XVIII Sulmuese, Asllan KETA emërohet Komisar në kompaninë e parë të batalionit të katërt dhe Ibe Palikuqi zevendeskomisare. Të dy vinin nga bota studentore. Të dy ishin ushtarë lirie. Të dy ishin "truri" i "Gazetës Xhepit" që nxirrte batalioni i katërt, ku i bëhej jehonë luftës dhe heroizmit partizan. Të dy ishin efektiv të batalionit të katërt që kishte një komandant trim, Gafurr Mehmetin, me përvojë të gjatë luftarake.

Batalioni i katërt me efektiv 453 veta ishte më i kompletuari në raport me batalionin të parë që kishte 428 veta. I dyti 366 veta dhe i treti 403 veta. Duke qenë në funksione drejtimi, aq më tepër komisarë, Asllani dhe Ibja mund të mos ishin gjithnjë në vijë të parë por në vendkomandë të kompanisë, që ishte më në thellësi, e maskuar dhe relativisht e mbrojtur. Për rrjedhojë, edhe më pak të rrezikuar për jetën.

Por Asllani dhe Ibja do ishin në vijën e parë. Se ndryshe – thoshte Asllan KETA- nuk mund të ishe komisar i besueshëm para njerëzve që komandoje dhe edukoje. Sipas Asllanit, komisari nuk kishte detyrë t'u imponohej partizanëve me fuqinë e funksionit si "Osman Gazepi", por të udhëhiqte nëpërmjet shembullit që fliste më shumë se fjala.

Sipas Asllanit, detyra e komisarit nuk ishte të shihte si luftonin të tjerët dhe në fund t'ju "vinte notat" por të luftonte vetë i pari dhe, pas sulmit, secili partizan të vinte notën vetes në raport me komisarin.

Ibe Palikuqi dha shembullin e vajzës idealiste, që edhe se vetëm 17 vjeç, solli modelin e brezit të vet, që vinte si vazhdimësi e traditës luftarake dhe atdhetare e vajzave shqiptare që nga e "Bukura e Lalës" e betejave të Vajkalit deri tek Shote Galica e dy luftrave ballkanike.

Titulli "Heroinë e Popullit" dhënë Ibe Palikuqit për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, një arsye më shumë për vlerësimin e gjithë kompanisë ku komisar ishte 19- 20 vjeçari Asllan KETA.

**ASLLAN KETA DHE GAZETA E XHEPIT**

Edhe në kohë lufte ka funksionuar shtypi. Nevoja për informim, motivim, pasqyrimi i dinamikës së veprimeve luftarake sa më afër veprimeve luftarake, përgjithësimi i shembullit pozitiv në to, e bënin shtypin më shumë se të domosdoshëm.

Gazeta e Xhepit, duke qenë afër njerëzve, secili kishte mundësinë të gjente veten në të. Ndaj dhe interesi për këtë lloj informacioni, që ishte real dhe në kohë, pati efekte pozitive dhe gjithnjë në ngritje. Shtypi ndihmonte për njohjen e gjendjes, përgjithësimin e përvojës dhe rritjen e mobilizimit.

Asllan KETA, qysh kur ishte në kompani, bashkë me Iben, ishin pjesë e stafit të "Gazetës Xhepit" që nxirrte batalioni i katërt, një rast i rrallë për ushtrinë e asaj kohe, që batalioni të kishte gazetë.

Qënja në krye të kompanisë në moshë kaq të re, thjeshtësia e tyre, që edhe se ishin në detyra drejtimi, silleshin si të barabartë mes të barabartëve, ju dhanë atyre qysh në fillim autoritet të merituar.

Asllan KETES dhe Ibe Palikuqit, edhe se Asllani ende pa kaluar brisk në faqe dhe Ibja vetëm 17 vjeç, partizanët ju ngriheshin në këmbë në shenjë respekti dhe dashurie. Asllani, prej kësaj sjellje kaq dashamirëse ndaj tij e shihte të tepruar dhe ndjehej keq. Mënyra për ta kthyer këtë respekt ndaj njerëzve që e rrethonin, ishte:

Shembull personal në veprime luftarake, qëndrimi sa më pranë partizanëve në nevojë dhe reflektimin e inteligjencës jo me fjalë por me vepra.

"Gazeta e xhepit" ishte mundësia e parë për Asllanin dhe Iben ku ata patën mundësinë të shfaqeshin jo vetëm në inteligjencë. Nëpërmjet gjuhës së thjeshtë, mendimit të ngjeshur, fjalisë së shkurtër, pasqyrimit të ngjarjeve flakë për flakë, gazeta u kthye në "ditar lufte" dhe e pranueshme për të gjitha nivelet.

Po të vëzhgohet me kujdes problematika e "Gazetës Xhepit" dhe roli që ajo luajti edhe si burim arkivi, kupton inteligjencën e atyre të rinjve që e drejtuan atë me kaq pasion. Kjo mbetet objekt i një studimi të veçantë.

**KU E GJENTE "PAPREKSHMERINE" ASLLAN KETA?**

***"Nëse ndjehesh komisarë- thoshte Asllan KETA- duhet të luftosh në vijë të parë! Nëse komisari është në ballë duke luftuar, njëkohësisht ka komanduar."***

Ja pse Asllan KETA ishte aq i besueshëm. I pranuar nga të gjithë. Aq i guximshëm dhe i drejtpërdrejtë në mendimet e veta. Aq i kthjelltë në mbrojtjen e parimeve. Aq këmbëngulës në mendimin kundër, aty ku ai gjykonte se kishte të drejtë. Që kishte guximin të merrte"zjarr mbi vete" aty ku mendonte se po bënte më të mirën për atdheun e vet.

Ku e gjente këtë guxim?

Ishte niveli intelektual dhe shpirti i revoltës ndaj çdo padrejtësie, që tek Asllan KETA ishin kalitur qysh student.

Rritja në jetë konviktore qysh 12 vjeç, mes kolektivit të gjithë niveleve dhe krahinave, regjimi ditor me disiplinë kolegji në "Internatin Dibra dhe, veçanërisht në "Institutin Bujqësor të Kavajës", kishin kultivuar tek Asllani elemente të "disiplinës spartane", ku zgjimi dhe pushimi bëhej si në ushtri, me bori.

Asllan KETA, i mësuar me regjimin e zgjimit qysh nga gjyshja "që dielli nuk duhej të zerë në krevat" dhe në Institut ku konviktorët zgjoheshin në orën 05.30 të mëngjesit, sepse, veç regjimit studentor, përballonin dhe ekonominë didaktike bujqësore dhe blegtorale që kishte Instituti. Shkolla dhe puna e formuan Asllanin qysh kërthi me instiktin e disiplinës si në ushtri sikur të ishte "Skënderbegas".

I rritur me korrektesën në orar, me rigorozitet në regjimin ditor, formësuan tek Asllani vlerësimin për kohën në funksion të detyrave kryesore dhe atyre ndihmës, nxitën aftësinë për të punuar në grup dhe marrë përgjegjësi lideri. Ishin këta faktorë që e bënin Asllan KETEN rast të veçantë dhe pati funksione aq befasuese dhe aq të vlerësuara në një moshë aq të re. Madje, vështirë ta qortoje. Aq më tepër ta ndëshkoje. Sepse ai ishte i "blinduar" në karakter. Kishte formimin e duhur intelektual dhe nuk të jepte shkak, ç'ka nuk e kishin të gjithë, aq më tepër, në moshë të tij.

Pyetja shtrohet: Për atë moshë që kishte Asllan KETA, në ato kushte që ishte rritur Asllan KETA, çfarë shkolle më të mirë pati Shqipëria e kohës së tij dhe ai nuk e bëri?

Ç'la pa bërë Asllan KETA në aq pak jetë sa i fali Zoti? Dhe, nëse në qindra kërkesa, Asllan KETA, fitonte me konkurs edhe Internatin Dibra edhe Institutin Amerikan të Kavajës; nëse nga lista e shumtë studentëve antifashistë, Asllan KETA, do ishte në listën 17 studentëve të parë elitarë që ju bashkuan luftës dhe u dërguan në përforcim të saj, a nuk kemi të bëjnë me një individualitet të spikatur qysh në rini?

Nëse në listën prej 17 studentësh që dilnin nga demonstratë antifashiste dhe ju bashkuan luftës, Asllan KETA, ishte i katërti në këtë listë, dhe nëse katër prej kësaj liste do i kishim ministra pas lufte ( Rrahman Hanku, Prokop Murra, etj), ku mund ta kishim Asllan KETEN nëse do e kishim gjallë?

**ÇFARË THONIN BASHKËKOHËSIT?**

"Tek Asllan KETA vështirë të gjeje një grimë mangësie, mendjemadhësie, arrogance, shtirje në karakter. Ai ishte shëmbëlltyrë e rinisë idealiste që ëndërronin një Shqipëri ndryshe, të çliruar nga fashizmi dhe nazizmi. Pas lufte, Asllani, synonte t'i kthehej shkollës"..[1]

Po ata:

"Asllan KETEN e kishte falë Zoti si një syth pranveror për nga hijeshia dhe zgjuarsia. Ai bënte diferencën mes nesh, sepse kishte shkollë dhe formim më shumës e ne. Ndaj dhe pati funksione më të larta se ne. Sepse Asllan KETA, sa ishte në shkollë, kudo ku mësoi dhe studioi, dallojë. Edhe kur ju bashkua luftës, kudo ku ai i luftoj dhe edukoj, mes gjithë nesh bënte diferencën. Sepse forca e Asllanit nuk vinte nga imponimi: zbato urdhrin se jemi në ushtri, por tek ndërgjegjësimi i njerëzve me bindje, kulturë dhe butësi. Mbi të gjitha, duke i gjykuar të gjithë me drejtësi. Dhe kurrë nuk ngriti zë por foli ulët. Se tek e Asllani ishte kjo mendësi:

"Edhe ai që firmoste me gisht, por kishte dalë në luftë për liri, e deshte Atdheun njëlloj si ai".[2]

Ishte ky formim i Asllan KETES që i jepte atij aq shumë fuqi, aq sa askush nuk bënte çudi:

Kush prekte Asllan KETEN, që ishte simboli i trimërisë, inteligjencës, arsyes, sinqeritetit dhe entuziazmit të rinisë, kishte prekur shpirtrat e 453 luftëtarëve të lirisë!

Ndaj Asllan KETA pati funksion madhor qysh 19- 20 vjeç, që njësohet dhe sot me gradën madhore major.

**PSE FUNKSION MADHOR?**

Sepse gjithë Brigada e XVIII Sulmuese kishte vetëm 4 batalione dhe në krye të njerit prej tyre do ishte Asllan KETA.

Sepse ndër 17 studentët që ju bashkuan luftës në një ditë me Asllan KETEN, askush nuk e pati funksion kaq të lartë sa Asllan KETA, kur batalionet numëroheshin me gishtat e dorës.

Ishin këto arsyet që Asllan KETA ishte dinjitoz në detyrën që ju besua. Kishte guximin të ngrinte probleme aq delikate, që sot vështirë t'i besosh nëse nuk do ju referohesh burimeve historike dhe arkivore.

**KU E GJENTE FORCËN?**

Ndoshta tek tradita luftarake e krahinës , që fillonte me tre beteja të mëdha të Skënderbeut në Bulqizë; lufta me Haredin Pashën; dy luftërat ballkanike dhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ku Asllani, bashkë me Feritin[3], do ishin pjesë.

Ndoshta, burim force shkrimi në pllakë guri të kullës së katragjyshëve të Asllan KETES "Atdheu mbi të gjitha".

Ndoshta burim force shpirti i revoltës i fshatit të tij që sillte qeverinë në Koçe kur ishte fjala për shkollë, vlerësim kushtesh dhe pamundësinë e pagimit të taksave.

Ndaj Asllan KETA, veç kësaj tradite, kishte dhe formim e vet si qytetar dhe atdhetar aq sa, kur bëhej fjalë për çlirimin kombëtarë, ai, "nuk pranoj kompromis as me vdekjen".

**MUND TË KISHTE DHE NJË FAKTOR TË FUNDIT:**

Asllan KETA, me shembullin e vet, ndoshta, i kishte dhënë vetes detyrën të shfaqte në batalion dhe jo vetëm, modelin e njeriut të së ardhmes që kishte nevojë Shqipëria e nesërme. Që, aq sa e kishte "shpirtin det", po aq, kthehej në "dallgë deti" kur shihte: intrigë, pabesi, tradhëti. Kjo i dha tek vetja më shumë guxim, trimëri,respekt, autoritet dhe dashuri. Aq sa:

Kush prekte Asllan KETEN, kishte prekur zemrat e 465 partizanëve që kishte batalioni i tij. Kush prekte Asllan KETEN, kishte prekur dhe komandantin veteran të batalionit të katërt, Gafurr Mehmetin. Se ata ishin të lidhur si zemra me damarët e gjakut me gjithë partizanët me të cilët bashkëluftëtonin pas as më të voglin dallim me atë të vijës së pare të zjarrit. Kjo i bënte ata :

Komandë unike në shpirt, karakter,ideal. Edhe komandanti me Kosarin se ishin me diferencë moshe midis tyre, ata plotësonin njeri tjetrin mrekullueshëm:

Komandanti, me përvojën e luftës dhe me maturi. Komisari, me energjinë e moshës dhe dituri.

***Gafurr Mehmeti thoshte:***

***"Asllanin Komisar, nga pikëpamja ushtarake, e kam rritur me këta duar, që kur ishte ushtar në luftime të përgjakshme nga Okshtuni në Opar. Por ai do bëhet më i mirë se unë sepse, veç trimërisë, ka "magjinë" të bëj gjithë batalionin për vete.***

***Prandaj kur flet Asllan KETA, nuk pipëtin as miza. Se ato që thotë Asllani, i thonë dhe 453 partizanë të batalionit. E kam thënë dhe unë. Prandaj ato që vendos komanda jonë, s'e luan as "topi i karadakut". Ku dallonte Asllani? Nuk të imponohej me hu' por me tru. Prandaj, kush prekte Asllanin, kishte prekur batalionin".***

të rinj të talentuar

**Dibra është vendlindja jonë dhe çdokush ka detyrë të kontribuojë dhe ta dojë ashtu siç është.**

# Tenori **Gerald Murrja:** Ëndrra ime është **të këndoj** në skenat e operave **në botë**

*Nga* **Samet ZAGRADI**



**Gerald Murrja është një nga artistët premtues dhe i talentuar në tregun muzikor në vendin tonë. Me babain nga Luznia dhe nënën nga Topojani i Dibrës ai lindi në qytetin e minierës, në Bulqizë. Është vetëm 23 vjeç dhe sipas maestro Zhani Cikos mbetet i vetmi tenor dibran në aq kohë sa ai ka drejtuar operan.**

Gerald Murrja është një nga artistët premtues dhe i talentuar në tregun muzikor në vendin tonë. Me babain nga Luznia dhe nënën nga Topojani i Dibrës ai lindi në qytetin e minierës, në Bulqizë.

Në moshën 5 vjeçare bashkë me familjen e tij udhëtuan drejt Tiranës për një jetë më të mirë. Është vetëm 23 vjeç dhe sipas maestro Zhani Cikos mbetet i vetmi tenor dibran në aq kohë sa ai ka drejtuar operan. Ai është pjesë e një grupi muzikor të quajtur "Classic Boys" të krijuar në spektaklin e muzikës "X Factor" në televizionin Klan. Ishte pjesëmarrës në këtë spektakël ku nga 8 mijë konkurrentë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i zi arriti të shkojë në 4 më të mirët në X Factor sezoni i dyte. Vazhdimisht merr pjesë në spektakle elitare të muzikës në vendin tonë si Kënga Magjike, Festivalin e këngës në Radio Televizonin Shqiptar, në këndimin e hymnit kombëtar në ndeshjet përfaqësues përkrah të madhit Kastriot Tusha.

*- Gerald, ti je një i ri premtues në botën e muzikës dhe ne jemi me fat që je nga Dibra. Na fol pak më shumë rreth vetes tuaj për një publik më të gjerë.*

- Faleminderit për fjalët e mira dhe unë jam krenar që vij nga kjo zonë kaq e nderuar dhe kaq bujare. Unë vij nga një familje e thjeshtë dibrane me babain nga Luznia dhe nënën nga Topojani, por vetë kam lindur në qytetin e Bulqizës. Në moshën 5 vjeçare bashkë me familjen u zhvendosëm për në qytetin e Tiranës për të pasur më shumë mundësi të mira jetese. Unë jam 23 vjeç dhe që nga klasa e parë jetoj në kryeqytet. Tani jam student i Universitetit të Arteve.

*- Si e zbulove talentin tënd në këndim dhe kush kanë qenë disa nga projektet e tua?*

Unë kam filluar të merrem me muzikë që në shkollën 9-vjeçare ku merrja gjithmonë pjesë në koncertet që organizoheshin në shkollë. Më pas mora pjesë në një talent show në Vizion Plus të quajtur "Elefant Show" dhe vitin e parë nisa në liceun artistik për kanto. Aty fillova mësimin me pedagogen Zina Zdrava, ku mora mësimet e para në muzikën klasike, ndërkohë në lice paralelisht kam marrë pjesë në disa kompeticione ku jam vlerësuar me çmime të ndryshme. Më pas mora pjesë në në "X Factor" ku në fillim isha solist dhe më pas u bëmë grup ku atë e quajtëm "Classic Boys" nga vetë rryma e muzikës që këndonim. Nga 8 mijë konkurrentë që kishin marrë pjesë nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia ne arritëm të shkonim në 4 më të mirët në edicionin e parë të "X Factor".

Më pas na u hapën shume dyer, ku konkurruam për herë të parë në këngën magjike ku arritëm të shkonim më finale dhe të fitonim çmimin "Best Grup" me këngën "Poltroni jot bosh".

*- E mendoje ndonjëherë që do punoje dhe konkurroje në spektaklet më të njohura në Shqipëri?*

Mendoj që në qoftë se punon çdo gjë bëhet. Unë kam fatin e madh të punoj dhe këndoj me një nga këngëtarët (tenor) më të famshëm në Shqipëri si Katriot Tusha. Me një emocion të madh kam pasur nderin e madh të këndoj himnin tonë kombëtar në ndeshje shumë të rëndësishme të kombëtares sonë në stadium si ajo kundër Izraelit, Sllovenisë dhe kohët e fundit kundër kundra Italisë. Kam marrë pjesë në emisionin "100 vjet muzikë" sërish në televizionin Klan ku kemi bashkëpunuar me Elia Zaharinë (gruaja e princ Lekës), Renis Gjokën dhe Redon Makashin.

*- Përveç muzikës Gerald, ke ndonjë hob apo pasion tejtër?*

- Po. Unë e pëlqej shumë futbollin dhe para ca vitesh kam qenë pjesë e ekipit të Partizanit B. Tani nuk është se kam shumë kohë për ta praktikuar, por sa herë e gjejmë kohën dhe luajmë. Më pëlqen të dëgjoj muzikë dhe një nga këngëtari im i preferuar është një këngëtar grek me emrin Mario Frangoulis. Lexoj dhe libra, madje libri që tani po lexoj është Harku i Triumfit. Po më shijon. Mendoj që koha në ditët e sotme është shumë e kufizuar, por në qoftë se ne e menaxhojmë ashtu siç duhet, ia dalim të bëjmë çdo gjë.

*- Si është një ditë e jotja Gerald?*

- Mua më pëlqen shumë gjumi i mëngjesit dhe ca është e vërteta ngrihem pak vonë. (Qesh). Më pëlqen që kafenë në mëngjes ta pi me familjen ose me shoqërinë.

Më pas në shkollë, studim futboll. Darkat më pëlqen ti kaloj me familjen. Unë kam dhe dy vëllezër më të vegjël të cilët përpiqem të kaloj sa më shumë kohë me ta. Mendoj që kjo është një ditë e zakonshme e imja.

*- Projektet e tua në të ardhmen dhe mendon që mund të provosh të fillosh një karterë solo?*

- Tani shpejt më datën 3 prill me orkestrën dhe korin e universitetit të arteve bëhet "Rekujemi i Tonin Harapit" ku unë do të kem disa numra solo. Ky aktivitet do të xhirohet edhe do të mbetet si dokument. Për sa i përket pyetjes tuaj nëse kam menduar të këndoj solo, përse jo. Do ta mendoj. Kam në plan të bëj disa këngë të reja përse jo edhe një klip. Për sa i përket festivaleve mendoj serish te Kënga Magjike dhe Festivalin në Radio Televizionin Shqiptar. Përveç kësaj kam në plan të vazhdoj studimet për specializim jashtë Shqipërisë. Ëndrra ime është të këndoj në skenat e operave në botë dhe shpresoj që një ditë do të bëhet realitet.

*- Kush është mendimi juaj për rininë shqiptare?*

- Tani, për sa i përket te rinjve sot, ku dhe unë bëj pjesë, kemi harruar të shijojmë shumë gjëra duke u bërë tepër të varur nga teknologjia. Unë do doja t'u thoja që të merreni më shumë me sport, art dhe të lexoni sa më shumë për të pasur një të ardhme më të mirë. Të punojmë sepse për veten tonë e kemi.

*- Ti the që ke ikur i vogël nga Dibra, vjen shpesh ta vizitosh?*

- Unë kam dajat në qytetin e Bulqizës dhe çdo vit shkoj dhe qëndroj. Kënaqem me ajrin e pastër dhe me njerëzit që unë kam atje. Edhe në Peshkopi unë kam miq, të cilët i takoj shpesh dhe ndihem shumë mirë kur flas me ta. Fundja ajo është vendlindja jonë dhe çdokush ka detyrë të kontribuojë dhe ta dojë ashtu siç është, ashtu siç bëni edhe ju.

---

Ky ishte çelësi i suksesit të Asllan KETES që në gjithë jetëshkrimin e tij na ofron modelin e një "kampioni". Mos u çudisni: Para se të vijmë tek tre djemtë e sotëm të "KETA Kampionëve", kulla e KETES ka pas dhe dy të tjerë para tyre.

**KUSH ISHIN ATA?**

Asllan KETA, qysh në Internatin e Kastriotit (12 – 15 vjeç) ishte pjesë e skuadrës së volejbollit të grup moshave. Dhe në Institutin Bujqësor të Kavajës (16-18 vjeç) ishte në skuadrën "kampione" të Institutit.

Në historikun e mundjes të ekipit të Korabit të Peshkopisë (që në ato vite ishte në elitë të mundjes shqiptare), sa ishte Izet KETA në ekip të Korabit nuk doli një i dytë t'i zinte vendin në peshën e tij. Kjo arsye që i ngjitën nofkën: **"Arusha e Malit të Bardhë!"**

Ja pse nuk duhet të çuditeni pse tre herë kampioni i Botës Ismaili dhe pas tij, Gjetani dhe Feriti, janë kaq të suksesshëm. Se as këta nuk kanë dalë në boshllëk por nga një "traditë luftarake" edhe në sport.

**ASLLAN KETA: KURRE NUK KOMANDOVA "PARA PARTIZANE" POR "TE GJITHE PAS MEJE, PARA PARTIZANE!"**

Asllani dhe Ibja, ishin bashkë në luftë kundër gjermanëve. Ishte koha kur gjermanët kishin ndërmarrë në katër drejtime operativo-strategjike operacionin "Fuchsjargd" (Gjahu i Dhelprave) me synimin:

Për të shuar përfundimisht rezistencën shqiptare! Në kuadër të kësaj rezistence, batalioni i katërt i Br. XVIII Sulmuese (gusht 1944) mori detyrë: Si repart autonom, bashkë me njësi të tjera, të marshonte në drejtimin Kërçovë- Gostivarë. Batalioni i katërt i Brigadës XVIII Sulmuese kapi lartësitë mbi Goran dhe Shutovo.

Kompania e parë me komisar Asllan KETA dhe zevendeskomisar Ibe Palikuqi, ishin në rrethina të Kërçovës. Luftohej me gjermanët. Raporti forcave ishte krejt i pabarabartë në favor të gjermanëve, por asnjë nga kompania nuk e braktisi rajonin mbrojtës. Në vijën e parë të zjarrit të kompanisë ishin Asllani dhe Ibja.

Për të qenë të pranishëm në çdo veprim luftarak, para çdo luftimi, Asllani dhe Ibja ndanin togat ku do të ishin për drejtim dhe luftime. Në luftimin e Kërçovës, ***pyet Asllani:***

***-Ibe, tek cila togë dëshiron të shkosh?***

***- Pse unë vendos? Jemi në luftë komisar! Më thuaj ku të shkoj dhe pikë- përgjigjet Ibja.***

***- Jo, edhe sot do zgjedhësh ti. Kemi shumë armiq përballë. Të kemi vajzë. Je më e vogël. I vogli zgjedh.***

***- Mirë.*** Në kompani të parë dhe, pasi e toku "paçim" me majë bajonete automatikun e Asllanit, "fluturoj" në drejtim të sektorit të togës parë. Asllani e thirri të ndaloj pak. E urdhëron të hapë gjerdanin e fishekëve. Pa dhe të tijët. I shtoj Ibes një ballë fishekësh nga të vetët. Ibja kundërshtoj por Asllani, jo me urdhër por me arsye, i thotë me butësi:

***- "Jemi të dy nga Dibra e Epër. Zakonet i kemi njësoj. Detyrat po ashtu. Por ti je dy vjet më e vogël se unë. Je dhe vajzë mes nesh. Prandaj, sa të jetë Asllan KETA komisar, ti, bukë dhe fishekë gjithmonë do marrësh e para dhe gjithmonë do zgjedhësh."***

- Ou? Për sa kohë kjo?

-Sa të kem jetën!

- Domethënë dhe pas lufte? Pushka top! - uroj Ibja dhe "qoku paçim" përsëri tytat me Asllanin dhe fluturojë në drejtim të togës parë. Asllani e përcolli me sy Iben deri sa ajo kalojë kreshtën. Edhe Ibja, para se të futej në një rrëpirë, kthej kokën nga Asllani. U ndje mirë që ai po e ndiqte me sy. Ngriti armën në shenjë përshëndetëse.Të njëjtin gjë bëri dhe Asllani. Ibja, zuri vend në pritë në mes të togës dhe nga koka nuk i largohej fjalia e fundit e komisarit: **"Ti e para sa të kem jetën!"**

Dhe për herë të parë dhe të fundit, Ibja, ëndërroj dhe për jetën e pasluftës, që e mendonte më shumë se të lumtur. Se tek e fundit, pse luftonin?

(vijon numrin e ardhshëm)

1 Dy intervista me ish partizanët e Luftës : Hajri Hoxha, Lufi Hanku, Selim Pira, të tre bashkëkohës të Asllan KETES që ruhen në arkivin personal të AK.

2 Po aty: intervistë me H. Hoxhën. L. Hankun. S. Pirën.

3 Nga Kulla e KETES, që në Prill të vitit 1942, kur Haxhi Lleshi kërkoj mbështetje nga familjet me influence për t'ju bashkuar Luftës, ju premtuan dy partizanë . Ishin Asllani dhe Feriti që ju përgjigjën kësaj thirrje.

**Për artistin Bajram Mata,
në 35-vjetorin e vdekjes**

rekuiem

# Bajram Mata

*"Duket se e ka dritën të pavdekur
në pafundësi
Sa vjen flaka në të mekur
Ndizet një fitil i ri"*

Dritëro Ame

*Nga* **Selami NAZIFI**

Ç'më shtyu që të ndërmarr e të shkruaj për intelektualin e artistin piktor të ndjerin Bajram Mata.

Para 4 vitesh shkrova një libërth të vogël në kujtim të një mikut tim, piktor Tahir Tahiraj, i cili ishte nga Mati, koleg e mik me të ndjerin Bajram Mata. Të dy jo vetëm që ishin shokë e kolegë, por patën të njëjtin fund tragjik; ndërruan jetë papritur nga mbingarkesa e alkoolit. Bajrami në 3 marsin e vitit 1983, me gotën e rakisë përpara dhe kokën të mbështetur në tavolinë, dhe Tahiri, pas viteve '90, pasi kishte dalë nga lokali, ulet për t'u çlodhur në lulishten e Qytetit Studenti, 100 m larg shtëpisë dhe nuk u ngrit më.

Miku im Zaim Elezi, pasi lexoi atëherë kujtimet e mia për Tahirin, më thotë:

-Selami, si pasionant i madh që je pas pikturës, pse nuk shkruajte për Bajram Matën që e kemi dibran? Piktor i talentuar dhe prej të cilit i ke nja 5-6 tablo të tij në sallonin tuaj.

Kjo bisedë e shkurtër këtu u mbyll. Por mua më vuri në mendime. Shkoj shpesh në qytetin tim të lindjes Peshkopi, për gëzime e derte, shto këtu edhe nostalgjinë. Herën e fundit hyra në librarinë e qytetit. Takohem me çiftin e respektuar Besë dhe Hysen Uka. Kërkoj disa libra me autorë dibranë dhe mora 7 a 8-të. Ndër ta çifti Uka përpos respektit të kafesë, më bënë dhuratë librin "100 vjet në 36 shkronja" të zonjës Emrie Skuka. Në libër bëhej fjalë për mësuesit e mi.

E lexova me një frymë. E rilexova me shumë endje. Leximi më dhuroi kënaqësi, nostalgji, ripërtëritje të kujtesës. I lumtë mendja e respekt për mundin që ka bërë autorja. Lexova në të edhe shkrimin për Bajram Matën. Figura e tij si intelektual e si njeri më bëri të sjell në kujtesë vërejtjen e mikut tim Zaim Elezi. Nuk shkoi shumë kohë, u ndodhëm në një tavolinë mes disa piktorëve. Në bisedë e sipër u përmend dhe emri i piktorit Bajram Mata. Ndër të pranishmit më shumë foli Kujtim Buza, që me Bajramin kishin qenë studentë në vitet 1959-1960 në Leningrad.

"Njiheshim shumë mirë, - kujton piktori Buza. Bajrami dallohej nga të gjithë të tjerët për talentin që kishte. Në klasë kishim edhe Fatmir Haxhiun. Mbaj mend se Bajrami



pësonte ndryshime pozitive pothuajse nga dita në ditë, në javë e muaj. Ishte e bëhej më i qeshur, i hapur me shokët, gazmor, që e reflektonte dhe në punën e tij në telajo, ku penelin dhe pastelin i përdorte me një shkathtësi të habitshme, dhe sikur aktronte kur punonte. I vinte nga brenda vetes ajo liri e shkathtësi të punuari. Edhe kur u kthyem pas një viti në Shqipëri ne e ruajtëm shoqërinë. Vinte në shtëpinë tonë. Babai (Abdurahim Buza) e vlerësonte dhe e deshte shumë si student. Mbaj mend në fundjavë, me kërkonte



xhaketën time të re, kur do shkonte në mbrëmjet e rinisë apo tek të afërmit.

Njëherë më mori xhaketën e i them që ma bjer të nesërmen. Ai nuk ma solli dhe unë u zemërova se më duhej dhe mua për dreq atë ditë. Por nuk zgjati shumë zemërimi e u pajtuam. Kur mbaruam studimet në vitin 1964 në Akademinë e Arteve, Bajrami u caktua në Peshkopi si mësues vizatimi".

Teksa ndjek bisedën e tyre, e cila pohon se në Tiranë, pjesa më e mirë e shokëve të tij, dhe jo aq fort të talentuar sa ai, po bënin emër, me siguri e bënin Bajramin të ndjente që dallimet në kësi rastesh nuk i bënin vlerat e artit, por rrethana krejt të tjera, deri edhe politike e biografike. Ky mesa duket është shkaku që dalëngadalë filloi të pinte e të krijonte shenja dëshpërimi.

"Rreth viteve 1979-'80, - vijon Kujtimi, - më dërgon një letër personale në Tiranë. Ndër të tjera më shkruante se do të vras veten. Kjo më bëri që të alarmohem dhe brenda 2-3 ditëve ndodhem në Peshkopi. Takoj një sekretar të parë të rrethit dhe i paraqes shqetësimin që kisha. E lamë që të takoheshim, gjasme si rastësisht të tre. Biseda qe e ngrohtë dhe dashamirëse. Vura re se pas saj Bajrami mori një kurajë e ngrohtësi".

Mendova atë çast se arsye të jashtëzakonshme mund ta detyrojnë një artist dhe piktor të kërkojë të bëjë vetëvrasje. Dhe mbi të gjitha, historia e artit njeh pafund rastet se, këta janë me të vërtetë artistë që, sa më shumë kohë kalon pas jetës së shuar fizike, aq më shumë rriten e lartësohen nga vepra që lënë pas.

Më afër tij, gjatë viteve krijuese, kishte qenë Lavdrim Kaba:

"Kam pasur shoqëri të hershmeve me Bajramin, - rrëfen Lavdrimi, - që kur filloi punën për herë të parën si mësues vizatimi në shkollën pedagogjikë "8 Nëntor" Peshkopi, në vitin 1964.

Ai vazhdoi të punonte si piktor. Dhe nuk hoqi dorë për asnjë ditë. Mund të them se kjo ka qenë periudha më produktive e më cilësore. Banonte në një dhomë në katin e parë të Shkollës Pedagogjike, aty flinte, aty gatuante, aty punonte pikturë.

Në pikturat e tij mbijetonte ngjyra e kuqe. Më kujtohet që gjatë vitit 1967 ku ishte i pamartuar, në aksionin në hekurudhën Rrogozhinë-Fier sektori Çermë-Lushnjë, Bajrami gjithë ditët nuk pushonte së punuari e nuk e hiqte letrën e fletoren nga dora, duke bërë skica, vizatime të studentëve, portrete, peizazhe, ura, hynte në çdo aspekt të jetës. Në këtë vit, shkurt 1967, në fshatin Çermë, në kuadrin e lëvizjes kundër fesë e zakoneve prapanike, u prish një kishë. Kur shkojmë të shohim, vëmë duart në kokë. Afresket të prishura, të goditura me mjete të forta e të hedhura sa andej-këndej. Aty Bajrami ka punuar 10 ditë rresht, duke bërë mbi 100 vizatime e skica me pamje rrëqethëse".

Duke qëmtuar mbi historitë e jetës së tij, mësova se u martua me Dranen në vitin 1967. Deri në këtë kohë Bajrami jetonte tek hoteli "Klubi i sportit". Më vonë, pas shumë kërkesash iu dhanë vetëm një dhomë tek pallati në rrugën "Gjokë Doçi". A mundte që një artist të jetojë dhe krijojë në një dhomë?!... Një familje prej tri vetash.

"Donte të bënte një portret të nënës, - kujton Lavdrimi, - por i thosha lëre se je i dehur? Por njëherë bëri grafikë të portretit të babës. Kryevepër. Ta dija se i bën më të mira kur je i dehur do kisha pranuar t'i bëjë edhe një nënës? E thirrën në Komitetin e Partisë së rrethit për t'i tërhequr vëmendjen se do e degdisnin fshatrave për punën e pijes. Bajrami me gjakftohtësi iu përgjigjet: Kudo ku të më çoni, gishtat do t'i kem me vete për të bërë pikturë".

Pikturat e Bajramit përmbajnë shumë kolorit, të tërheqin. Nuk e kuptoj shumë artin e pikturës dhe vë re se piktura e tij konsiderohej disi disidente e me shumë kolorit. Madje, kontrasti mes punëve te tij dhe të "të tjerëve" që merrnin lavde dhe konsiderata të pamerituara, përbente thelbin e nervit të tij artistik. Në shtëpi kam 3 punë të tij.

I vëllai, Dylber Mata tregon se "pati edhe momente kur për hir të talentit të tij iu hap edhe ndonjë derë pas ndonjë zëri miqësor për ta marrë në Tiranë, por miopia e pushtetit fanatik vendos se "ky kuadro na duhet ne se na bën punë në Dibër" ia mbylli përgjithmonë derën drejt metropolit, kulturës dhe artit të kohës".

Mësoj se ai, si artist ishte antikonformist. Në vlerësimin e punëve të kolegëve mbante qëndrim shumë të drejtpërdrejtë. Nuk iu bënte qejfin. Në vetvete mbante cilësi njerëzore, human, intelektual. Njerëzit e thjeshtë e donin shumë.

Shkrimtari Petro Mjedi kujton: "Një ditë ndodhesha në Peshkopi, në një seminar nga ata që organizonte shpesh kabineti pedagogjik. Po haja darkë te "Turizmi". Më afrohet në tavolinë dhe pa më marrë leje, ulet një burrë, moshën e të cilit nuk mund ta përcaktoje dot, me trup mbi mesatar, i zeshkët, i bëshëm dhe me flokë të shpupurishura. Vetëm më

cyan magenta yellow black

**Arif Lushi: Bajram Mata ishte piktor i veçantë e unikal. Pse them unikal? Punët e tij janë komplet të diferencuara në mënyrën e pikturimit mes autorëve të tjerë që kërkonin medoemos suksesin në punën e tyre. Me plot gojën mund të them se është një meteor. Piktura e tij lëviz me metodën që ai përdorte.**

# zgjodhi të **jetojë** madhërishëm me **fjalën** dhe **veprat e realizuara**



**Bajram Mata e dashuronte me gjithë shpirt profesionin e tij, por si kudo dashuria është vuajtje e dhimbje. Shpirti i tij i dëlirë pranoi të vuante e të arrinte deri në flijim, sesa të bënte kompromis me rregullat e sistemit me të cilat nuk u pajtua asnjëherë. A mund të konsiderohet qëndrimi i tij si disident. Mendoj se në kuptimin politik jo, por ai ishte disident i parë me koshiencë të plotë që iu kundërvu në mënyrën e tij burgosjes së shpirtit të lirë. Kërkonte liri për shpirtin e lirë.**




shikonte me sy të picëruar. Kamerier Ceni, një nga kamerierët më të famshëm dhe me emër, jo vetëm në Dibër, por edhe më tej, më afrohet dhe më thotë ngadalë: "Jepi një dopio, se ikën vetë ai!" Ashtu dhe bëra... Ky ishte piktori Bajram Mata. Më vonë mësova se ishte shumë i muhabetit, sidomos për pikturën, të cilën e njihte mirë dhe teorikisht, por dhe për letërsinë. Mësova se kishte një familje të shkëlqyer, të cilën e ka përshkruar shumë bukur, me të gjitha dritëhijet që mund të ketë një familje artistësh, shkrimtarja Sadie Agolli, në një tregim të gjatë, gati një novelëz, të botuar pas vdekjes së piktorit, në revistën "*Nëntori*".

Në shkrimin që Tahir Tahiri ka bërë për Bajram Matën, thotë: "Nuk duhet të habitet ndonjë lexues kur them se ishte një piktor e talent tek i cili ne prisnim një begati krijuese në hapësirën e pikturës shqiptare. Pas vdekjes iu dha titulli Piktor i Merituar. Ai punoi e krijoi në një ambient tepër të kufizuar e aspak favorizues. Natyrisht, ky tip i çiltër, i sinqertë, gojëmbël, i dashur me të gjithë, nuk u kuptua e nuk u vlerësua. Stimulues e inkurajues. Ambienti që e rrethonte e fundosi talentin e tij, para se ai të jepte maksimumin krijues. Forca e mjedisit e fundosi para kohe. Me mirënjohje për të Tahir Tahiraj, 1998".

Kishte një ndikim nga shkolla ruse, që dinin t'ia dallonin mjaft ustallarë të kohës, por që nuk flisnin me zë të lartë. Rreth viteve '79-të u ndodha dhe unë vetë në një situatë të tillë. U ulëm në një tavolinë në Turizmin e Peshkopisë me të ndjerin Shemshedin Kokona. Më pyet, duke bërë me gisht në një faqe muri ku ishte vendosur një tablo. E dija dhe e njihja mirë autorin e saj, Bajram Mata. I them emrin. Qenka piktor i mirë. Me ndikim rus në pikturë. Ai vetë kishte mbaruar në Rusi. Hapa sytë se mos si zakonisht të shihja Bajramin në ndonjë tavolinë. Por nuk qëlloi të ishte aty.

Duke ndjekur rrënjët e veprës së Bajram Matës, këmbët më çuan kësaj here në Galerinë e Arteve për të bashkëbiseduar me piktorin Arif Lushi, punonjës i GKA Tiranë.

E pyes nëse e ka njohur piktorin Bajram Mata.

- Jo, direkt nuk e kam njohur, por pasi erdha me punë në GKA në Tiranë, më kanë bërë përshtypje tablotë e këtij piktori, por jo vetëm mua. Ja, p.sh., kjo pikturë, titulluar "Vajza tek misri". Është një ndër pikturat më të bukura ose kryevepra të Bajram Matës. Këtë lloj pikture unë e dua shumë. Do them vetëm dy fjalë për këtë autor të jashtëzakonshëm e piktor i veçantë e unikal. Pse them i jashtëzakonshëm? Punët e tij janë komplet të diferencuara në mënyrën e pikturimit mes autorëve të tjerë që kërkonin medoemos suksesin në punën e tyre. Me plot gojën mund të them se është një meteor. Piktura e tij lëviz me metodën që ai përdorte.

- S'po flet pak si shumë, - e pyes, Arifin, - me fjalë superlative?

- Jo s'kam thënë asgjë jashtë mendimeve e opinionit tim. Bile, ja shikoje si godet vepra e tij. Është një ndër autorët më piktoreskë të lindur. Diferencohen aty se ç'bëri koha me të, ku e la me tituj apo pa tituj dhe se ç'është në të vërtetë vepra e piktorit.




- Kur shoqëria do të bëhet aleati i vlerës, atdheu edhe ne si komb do të rritemi të shëndetshëm. Dhe pas këtyre fjalëve të piktorit Arif Lushi, iu ktheva edhe njëherë shkrimit të Emrie Skukës "100 vjet me 36 shkronja". Vlerësime për artistin, të cilat ndjej dhe përjetoj në çdo fjalë të këtij shkrimi që shkruaj dhe mblodha për të.

Bajrami ishte mësuesi, artisti, qytetari që menaxhoi me burrëri, zjarrmimet e brendshme kundër sistemit, saqë flakët u ngritën, e mbështollën dhe e dogjën jetën e tij.

Ai kurrë nuk e krodhi veten në ëmbëlsinë e lavdisë. Bajram Mata zgjodhi të jetojë madhërishëm vetëm në fjalën e tij të folur dhe në veprat e realizuara brenda kornizave... duke derdhur fjalën e tij të lirë. Emri Bajram Mata është nga ata emra që ia shton vlerat kësaj shkolle.

Ndoshta ai jetoi dhe krijoji në një kohë të gabuar. Sot, ish mësuesi i vizatimit të një shkolle të largët në veri të Shqipërisë, do të konkurronte me piktorët më me zë të globit.

Në kujtimin e këtij qyteti si Peshkopia, ai nuk mbeti thjesht një bir i tij, por një realitet. Një realitet i bukur, më shumë se nostalgji, por edhe një dhimbje. Një dhimbje për dramën që mbante në vetvete ato të mosnjohjes e të mosvlerësimit për atë që ishte. A mund të justifikohemi për të duke thënë: Ishte koha?

Ishte koha! – Dhe sa herë nuk reflektohen nga shoqëria, ashtu si duket, ndaj ngjarjeve të kohës me qëndrimin e duhur, në aspektin moral dhe kohë të tilla nuk kanë për të ndryshuar shoqërinë edhe për shumë e shumë dekadash. Intelektualëve si Bajram Mata u duhet dhënë vendi që u takon, jo vetëm si profesionist apo të talentuar, por si frymë morale e dukshme në radhë të parë për brezin e sotëm dhe për brezin e ardhshëm.

Bajram Mata e dashuronte me gjithë shpirt profesionin e tij, por si kudo dashuria është vuajtje e dhimbje. Shpirti i tij i dëlirë pranoi të vuante e të arrinte deri në flijim, sesa të bënte kompromis me rregullat e sistemit me të cilat nuk u pajtua asnjëherë. A mund të konsiderohet qëndrimi i tij si disident. Mendoj se në kuptimin politik jo, por ai ishte disident i parë me koshiencë të plotë që iu kundërvu në mënyrën e tij burgosjes së shpirtit të lirë. Kërkonte liri për shpirtin e lirë.

Sidoqoftë, them sërish se historia artistëve të mëdhenj është tragjike, edhe në ato raste se punimet e tyre zënë të çmohen e të vlerësohen kur autori ka mbyllur sytë. Në të gjallë u duhet të heqin të zitë e ullirit, të shihen me urrejtje e përçmim, të pakuptuar.

Jo, për artistin e vërtetë nuk ka vdekje. Ato jetojnë me veprat e tyre, me shpirtin e tyre. Le të mbetet ky shkrim i imi për piktorin Bajram Mata, në radhën e fitilave të ndezur. Kur flaka vjen në të mekur, siç thonë vargjet e artistit e aktorit dibran, Dritëro Ame, dhe ndizet një fitil i ri, drita e fortë e artit e veprës, e shpirtit.

Çfarë arsyesh e shtynë artistin Bajram Mata të arrijë deri në vetëvrasje? Arsye ekonomike? Politike? Familjare? etj. Jo, jo. Trysnia e një ambienti të gjerë apo të ngushtë që ushqenin xhelozi, smirë e prepotencë e çdo natyre qoftë sjell pasoja shkatërruese, ngaqë përherë kërkojnë nënshtrimin pa kusht të tjetrit. E më në fund ai u lodh e iu nënshtrua fatit e ashtu qetë-qetë, shoqëruar me buzëqeshjen e një të pafajshmi, si të një fëmije, perëndoi.

cyan magenta yellow black 13

# Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë,
# TEMPULL I DIJES DHE EDUKIMIT

*Nga* **Hilmi CANI**

Viti 1948 shënoi suksesin arsimor për popullin e Dibrës dhe zonave verilindore të Shqipërisë, duke u hapur e para shkollë e mesme pedagogjike. Në qendër të qytetit lëshoi shtat shkolla e re tri katëshe si dhe me pjesën e podrumit plotësisht funksional për nevojat e shkollës dhe konviktit. Ndërtesë e bukur, me kubaturën e nevojshme, me sallone të mëdha, me shkallë të gjera dhe me pjerrësinë normale, banjo brenda, me një mensë të shkëlqyer ku ushqeheshin rreth 300 konviktorë njëherësh. Në pjesën e bodrumit ishin vendosur komodinat që konviktorët i përdornin personalisht për mbajtjen e librave, të veshjeve dhe mjeteve tjera për higjienën personale. Shkolla nga jashtë, në pjesën nga bulevardi si dhe nga pjesa lindore zbukurohej me lulishte të këndshme dhe me drunj gjelbërues që i jepnin jetë nxënësve të shkollës e gjithë qytetit. Nga ana e pasme shtrihej oborri i shkollës ku rreshtoheshin nxënësit. Pjesa e oborrit ishte aq e madhe saqë plotësonte nevojat e qëndrimit të nxënësve në kohën e lirë dhe mbante në vetvete dhe terrenin sportiv, me fushë volejbolli, fushë basketbolli, futbolli dhe veglat sportive për përgatitje fizike si hekura, paralele, gropë kërcimi etj. Ndërkohë, në pjesën e parë të viteve '60 u ndërtua dhe palestra mjaft e mirë dhe e përshtatshme për zhvillimin e lëndës së edukatës fizike. Kati i parë dhe i dytë i shkollës përdoreshin për mësim, ndërsa kati i tretë përdorej për fjetjen e nxënësve konviktorë i ndarë në mes me murë që krijonin siguri të plotë dhe Ishte i pamundur komunikimi i njërës pjesë me tjetrën. Dyert e klasave ishin shumë të mëdha, me dy fletë, po kështu dhe dritaret ishin sa dyert dhe sillnin aq shumë dritë saqë studiohej dhe shkruhej në kushte shumë të mira. Në shkollë, përveç klasave kishte zyrë për drejtorin në katin e dytë, për nëndrejtorët, për këshillin pedagogjik, sekretarinë, kujdestarët e konviktit, bibliotekën, magazinën e ushqimeve dhe të veshmbathjes, vendqëndrim për rojën etj. Ishte vërtet fat i madh të ishe nxënës i asaj shkolle.

Shkolla në fillim, me datë 1 shtator 1948, e nisi punën me një klasë me 17 nxënës bursiste që vinin nga Dibra, Kukësi dhe 2 nga Peqini. Në vitin 1951 shkollës i jepet emri: "'Shkolla Pedagogjike 8 Nëntori'', e cila e mban këtë emër deri në vitin 1967 kur ajo mbyllet për herë të parë. Në vitet e para pas çlirimit, shkollën nuk e vazhdonin lehtë. Shpesh bëhej dhe presion, përveç bindjes, për të vazhduar shkollën. Ish drejtori i shkollës, Shefik Osmani, në vitin 1951 i shkruante Komitetit të Partisë Dibër: "Jam i mendimit që nga konviktorët tanë që mbarojnë klasën e shtatë, të mos u jepet asnjërit bursë gjetiu, veçse në shkollën pedagogjike, duke përfshirë këtu dhe dy vajzat". Kështu numri i nxënësve filloi të rritej. Nga një vajzë që vazhdonte shkollën në vitin 1951-1952, në vitin 1954-1955 kishte 249 nxënës, prej tyre 19 vajza. Në vitet 1964-1965 shkolla është me ngarkesën më të madhe të nxënësve. Në këtë periudhë vazhdonin mësimet 380 nxënës, prej tyre 110 vajza. Fillimisht vështirësitë e punës ishin të mëdha dhe për mësuesit, sidomos për ata të ardhur nga rrethet tjera, por përkushtimi për detyrën dhe shpirti i sakrificës, bashkëpunimi me njëri-tjetrin bënë të mundur mposhtjen e vështirësive. Ja si shprehej njëri nga mësuesit e asaj kohe: "Erdhëm këtu porsa kishim mbaruar studimet e larta plot dëshirë për profesionin e mësuesit, plot pasion për të dhënë mësim, plot etje për të punuar. Etje, pasion dhe vullnet kishin dhe nxënësit tanë. Me disa prej tyre moshat nuk na ndanin shumë. U mësuam me klimën e ftohtë të natyrës dhe pritjen e ngrohte të dibraneve". Në shkollë mbizotëronte rregulli e disiplina e ndërgjegjshme, pasi çdo nxënës që kishte hyrë në këtë shkollë, kishte synimin të



bëhej pa tjetër mësues i brezit të ri, detyrë kjo shumë fisnike dhe e nderuar për kohën. Si në ekran ruhen në kujtesë drejtorët e kësaj shkolle, filluar me Rexhep Kadzadejn, Pandi Cici, Shefik Osmani, Zenel Sula, Sami Ferizi, Shemsi Manjani, Myslim Koka e të tjerë më vonë.

Ora e mësimit ishte e shenjtë. Asnjë person, qoftë dhe ministri i arsimit, nuk mund të futej në një orë të çdo lëndë nëqoftëse kishte filluar mësimi. Mësuesit dhe nxënësit vinin shumë të përgatitur në orët e mësimit. Kërkesa e llogarisë për punën mësimore edukative ishte mjaft e madhe. Më kujtohet shumë mirë që zbatohej me korrektesë parimi i madh i Makarenkos: "Sa më shumë kërkesa, aq më shumë respekt për nxënësin". Të tillë parim ndiqnin pedagogët e talentuar të kësaj shkollë, Astrit Hoxha, Shefik Osmani, Zenel Sula, Mois Cami, Kolë Tahiri, Shemsi Manjani, Osman Turja, Ismail Erebara, Lutfi Hanku, Nevrez Manjani, Mois Cami, Durmish Shehu, Riza Manjani, Munir Shehu, Fatmira Zeqo, Kadri Zhulali, Sabri Vraniçi, Xhetan Strazimiri, Lutfi Manjani, Lavdrim Kaba, Myslim Koka, Hamza Spahiu, Hasan Shehu, Mufit Trepça, Fadil Kaca, Bajram Mata, Nazmi Mziu, Fitim Mati, etj, etj, që të gjithë pedagogët shkëlqenin me punën e tyre. Ishin shembull në punën mësimore edukative, model në sjellje dhe paraqitje të jashtme, shumë korrekt në biseda e marrëdhëniet me nxënës.

Qëllimi kryesor ishte përgatitja shkencore dhe metodike e nxënësve për të qenë të aftë të ushtronin profesionin e nderuar të mësuesit. Këtij qëllimi i shërbente kryesisht puna brenda orës së mësimit, por dhe ajo jashtë saj. Metodat që përdoreshin në orët e mësimit ishin kryesisht, shpjegimi, biseda, punët e pavarura praktike e laboratorike, pa lënë pas dore asnjëherë parimin e madh të konkretizimit. Kontrolli i njohurive zhvillohej me shumë korrektesë nga ana e pedagogëve, vlerësimi ishte objektiv dhe lënda e re jepej shumë qartë, koncize dhe e kuptueshme, shoqëruar për çdo temë me mjete konkrete. Në vitin 1952 pranë shkollës hapet dhe sistemi i korrespondencës, me përgjegjës pedagogun Ismail Erebara. Me këtë sistem mbaruan studimet dhe u diplomuan 230 mësues. Nga vitet 1948-1967 nga dyert e kësaj shkolle u përgatitën 772 mësues që dhanë mësim në ciklin e ulët dhe të lartë të shkollës 8-vjeçare për shumë e shumë vite, duke plotësuar nevojat e rrethit me kuadër arsimor, si dhe duke ndihmuar dhe disa rrethe të tjera me mësues të cilët atyre u mungonin. Kudo që punuan pedagogjikasit u shquan për punë cilësore mësimore edukative, shumë prej tyre si drejtues shkollash, drejtues të arsimit në rrethe, drejtues në sektorët e pushtetit dhe ekonomisë, gazetare, ushtarake, deri në post ministër arsimi, drejtues të lartë në KQPPSH, ambasador, profesorë në shkolla të larta dhe shumë prej tyre morën tituj të lartë shkencor.

Aktivitetet jashtë klase dhe shkolle, plotësonin më së miri procesin mësimor të orës së mësimit. Konkurset, aktivitetet letrare, historike e mbrëmjet tematike të vallëzimit, ekskursionet, aktivitetet fizkulturore e sportive ishin të vazhdueshme në shkollën pedagogjike. Në vitin shkollor 1952-1953 shkolla kishte ekipin sportiv të saj të futbollit, me emrin ''Studenti.'' Nga veprimtaritë e shumta që zhvilloheshin, u zbuluan dhe edukuan shumë talente të rinj në shumë drejtime, talente të shkëlqyera në fusha të ndryshme si Lutfi Manjani, Shemsi Manjani, Riza Manjani, Rexhep Bardulla, Xhafer Martini, Islam Rama futbollist, Ilir Ramizi shahist në vitin 1950, Emin Jashari peshëngritës në vitin 1959 rekord kombëtar në peshën 51,5 kg., pedagogu Astrit Hoxha në vitin 1955 skiator ku zuri vend të dytë në kampionatin lokal, plus që ishte dhe basketbollist, Rexhep Bardulla skiator zuri vendin e tretë në kampionatin lokal 1954, Qemal Kurtnjaga në vitin 1959 zë vendin e parë në mundje peshat e rënda, Lutfi Manjani fitues i kampionatit lokal në ping-pong, Murat Koltraka ish-nxënës që zuri vendin e parë në hedhje shtize në vitin 1960 si dhe volejbollist rezultativ, Safet Zhulali trajner i ekipit që zuri vendin e parë në shah 1980, Tonin Lufi sportist basketbollist dhe futbollist, prof. Jorgji Sinjari si dhe Agim Kaba e Shahin Lazri kontribues në kulturën fizike, Haki Duka basketbollist atlet në vitet 1960, Flamur Bardulla basketbollist në vitet 1960, skuadra e vajzave e volejbollit e vitit 1960 e përbërë nga talentet Zinet Spahiu, Natasha Shehu, Hamdie Ramizi, Nexhmie Shehu, Lumturi Rexha, Shpresa Agolli, Fiqiret Xhemalçe, Vjollca Duka, Burbuqe Musaraj që përfaqësonin me dinjitet rrethin. Në verën e vitit 1966, u organizua brigada kulturore e shkollës e cila qëndroi një javë në zonën e Luznisë duke punuar për futjen e mënyrës së jetës së re në fshat, duke luftuar zakonet prapanike dhe mënyrën primitive të jetesës. Për herë të parë në këtë zonë u organizua në shkollën e fshatit Lishan i Poshtëm mbrëmje vallëzimi, me rininë e shkollës dhe të fshatit, ku u përdor dhe xhazi e fizarmonika në orkestër. Ish nxënësit Flamur Bardulla dhe Bashkim Nasufi dhe më vonë dhe Haxhi Çira mësuan t'i binin fizarmonikës në shkollë dhe në të shumtat e rasteve këta shërbenin si orkestrantë në mbrëmjet që organizonin klasat dhe shkolla. Të gjithë këta që përmendëm ishin disa nga kontributet që solli shkolla e famshme pedagogjike e Peshkopisë me nxënësit e talentuar dhe pedagogët e saj të shkëlqyer. Jo pa vend, por me të drejtë, shpeshherë nga populli dhe personalitete të ndryshme, shkolla pedagogjike e Peshkopisë quhej "Universiteti i Dibrës". Në vitin 1951 ngrihet shkolla ushtrimore që mundësonte vënien e teorisë në praktike dhe përgatitjen reale të nxënësve për mësues. Me respekt të thellë kujtojmë mësuesit mjaft të nderuar të kësaj shkolle, Remzi Prapaniku, Jolanda Rada, Hava Hoxha, Sanie Zeneli, Drita Zhulali etj., më vonë.

Në biseda të lira me shokë, duke festuar përvjetorë maturash, kujtonim dhe konviktin e shkëlqyer të shkollës, i cili ishte një "prapavijë" e vërtetë që mbështeste me sukses shkollën në gjithë punën mësimore edukative. Një konvikt shumë i mirë për kohën, me ushqime të mira, gatim cilësor, fjetje normale, higjienë shembullore dhe më e rëndësishmja e personelit ishte dashuria prindërore ndaj nxënësve. I kujtojmë me shumë respekt e dashuri ne si nxënës, nëndrejtorët Shemsi Zhulali, Adem Shehu, Terzi Dungu dhe Rremzi Prapaniku, kujdestarët Iljaz Kaca, Qemal Kurtaga, Islam Kosova, Tefta Pahumi dhe Fatmira Iljazi, magazinier Refiku, rrobaqepëse Tixhe Agolli, kuzhinierët Shukri Çorja, Ali Hoxha dhe nënë Tixhe Bardulla bashkë me Fatimen e Myrgjezetin, roja i paf-jetur Hyseni që na ruante gjithë natën pa mbyllur fare sytë deri në mëngjes. Të paharruara mbetën kremtimi i festave, sidomos ajo e vitit të ri, ku kishte ushqime me bollëk, gatime me ëmbëlsira të shumë llojeve, recitimet, vallëzimi herë kavalierët në fuqi e herë damat, e më e rëndësishmja ishte Ora Gazmore që përgatitej nga nxënësit. Ora Gazmore ishte një satirë dhe një thumbim dashamirës për nxënësit, mësuesit dhe punonjësit. Nëpërmjet saj gajaseshin se qeshuri, por duke përdorur ironinë e figura tjera letrare rregulloheshin të metat që viheshin re dhe përmiresohej dhe puna në t'ardhmen.

Në vitin 1967 u diplomua matura e fundit dhe shkolla mbyllet, kurse nxënësit që ishin në vitin e tretë, u transferuan dhe e kryen vitin e katërt shumica në pedagogjiken e Shkodrës dhe disa në atë të Korçës.

Shkolla pedagogjike hapet sërish në vitin 1970 dhe vazhdon deri në vitin 1977 ku mbyllet për herë të dytë. Hapet përsëri në vitin 1984 dhe vazhdon deri në vitin 1994. Së fundmi, meqenëse kishte nevojë për shumë mësues, hapet për herë të tretë në vitin 1997 dhe vazhdon me një kontigjent të madh nxënësish të profilit pedagogjik, duke u shtuar dhe dy klasa për gjuhë të huaj dhe nga viti 2003 një klasë e profilit ekonomik. Hapje mbylljet e shpeshta dhe shumë herë pa një strategji zvillimi tashmë të kësaj shkolle, natyrisht ulen nivelin arsimor, humbi përvoja e shkollës së parë pedagogjike por përsëri në kontrollin që u ushtrua nga Ministria e Arsimit në vitin 2004 në të gjitha shkollat pedagogjike të vendit, shkolla jonë që tashmë mbante emrin e heroit të popullit "Nazmi Rushiti", zuri vendin e parë për punën mësimore edukative që bëhej. Në vitin 2008 mbarojnë kontigjentet e fundit të nxënësve pedagogjikas dhe u vazhdua shkolla me profil profesional duke përgatitur teknikë të mesëm për tregun e punës.

Me rastin e 70 vjetorit të hapjes saj, përkulem me nderimin e nostalgjinë më të madhe para kësaj shkolle, para këtij tempulli të shkëlqyer të dijes dhe edukimit dhe i jam mirënjohës asaj dhe pedagogëve tanë të shkëlqyer përjetë për atë ç'ka bënë për mua dhe shumë shokë e shoqe të tjerë, që na nxorrën nga errësira e paditurisë dhe na përgatiti me arsim, kulturë dhe edukatë duke i shërbyer me kënaqësi vetes, familjes dhe Atdheut.

** Ish nxënës dhe drejtor i shkollës pedagogjike.*

histori

**Sheh Mustafa lindi në Zerqan, në vitin1790, në një familje që përmendet si derë klerikësh, mendjendritur dhe bujare, patriotë dhe trima, njerëz të penës, të pushkës dhe të urtësisë.**

# MUSTAFA SHEHU, një zemër që **skaliti** me zjarr **emrin e tij në histori**

Nga **Halil TEODORI**

Kujtesë dhe mirënjohje për Mustafa Shehun e Zerqanit, në 228-vjetorin e lindjes, shembullin e mirë të krenarisë kombëtare.

Kujtesa dhe vlerësimi i figarave si Mustafa Shehu i Zerqanit është një detyrim qytetar dhe patriotik, është një konsideratë që rrit predispozitën e angazhimit dhe instalon në ndërgjegjen e kohës sensorë të ndjeshëm të krenarisë. Ishin ata, të cilët me mish e me shpirt, ndërtuan dhe nderuan, u përkushtuan dhe realizuan, dhanë gjithçka kishin më të mirën nga vetja e tyre, jo vetëm për të vënë emrin në panteonin e nderimeve, por edhe për të shkruar një faqe në histori, për të dëshmuar ekzistencën, për të përmbushur misionin e tyre.

Dibra, si trevë e traditës së urtësisë, trimërisë dhe atdhetarisë, ka patur fatin që ka rritur dalëzotës dhe prijës të arbërit, që nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, për të pasuruar këtë truall gjaku të kulluar me emra dhe vepra si Mustafa Shehu i Zerqanit, Elez Isufi e Isuf Xhelili... Personalitet të këtilla, vizionar dhe dijeshumë, trima dhe zemërluanë, nderojnë Dibrën, krenojnë brezat, skalitin faqe në Historinë e Arbrit.

Në periudha të ndryshme, shumica e tyre u rreshtuan e u vunë në krye të kryengritësve të popullit të Dibrës, në mbrojtje të qenies kombëtare kundër pushtuesve turk, serb, bullgar e të gjithë atyre që kërkuan të na cënojnë integritetin, të na përdhosin varret e të parëve, të na marrin tokë e vatan, të na grabisin historinë, të na shkelin gjakun e heronjve.

Këto burra kanë qenë dhe do të jenë në jetë të jetëve. Shqiptari kurrë nuk ka lakmuar tokën e huaj, sikurse kurrë nuk është nënshtruar atyre që kanë guxuar ta bëjnë këtë, edhe pse i është dashur ta paguajnë me jetë.

Në vitiet 1835-1844, një ndër klerikët që iu kundërvu pushtetit osman qe pikërisht ai, Sheh Mustafa i Zerqanit.

Për Mustafa Shehun është folur shumë pak, siç është bërë edhe me personalitete të tjera, kontributi i të cilëve ka patur një ndikim të fuqishëm në fokusimin e interesave kombëtare si prioritare, si i vetmi obligim, të cilit i detyrojmë origjinën, emrin, nderin, krenarinë, gjakun.

E nesërmërja do të hedhë më shumë dritë, do të korigjojë të shkuarën duke nxjerr si parësore rivlerësimin e figurave, rishqyrtimin e tyre dhe trajtimin me konsideratë dhe respekt për gjithçka ata kanë bërë. Pasi të studjohet me kujdes kjo figurë dhe veprimtaria e tij, pasi të shterrohen të gjithë burimet e informacionet, arkivat osmane dhe ato të vendeve të tjera, të ballafaqohen faktet, do të dalë në dritë se Mustafa Shehu është një personazh i përmasave kombëtare.



**Kujtesa dhe vlerësimi i figarave si Mustafa Shehu i Zerqanit është një detyrim qytetar dhe patriotik, është një konsideratë që rrit predispozitën e angazhimit dhe instalon në ndërgjegjen e kohës sensorë të ndjeshëm të krenarisë. Ishin ata, të cilët me mish e me shpirt, ndërtuan dhe nderuan, u përkushtuan dhe realizuan, dhanë gjithçka kishin më të mirën nga vetja e tyre, jo vetëm për të vënë emrin në panteonin e nderimeve, por edhe për të shkruar një faqe në histori, për të dëshmuar ekzistencën, për të përmbushur misionin e tyre.**

Sepse e tillë ishte veprimtaria e tij, i tillë ishte kontributi që ai dha, e tillë ishte kuraja të cilën ai e vuri përballë si dëshmi e qëndresës, i këtyre përmasave ishte dhe mbeti, Ai Shehu i Zerqanit.

Mustafa Shehu ishte një ndër burrat e pashoq të Dibrës, ndoshta nga ata që do të ngulitet thellë në ndërgjegjen e kohës.

Dëshmitë e ndryshme historike e marrin në konsideratë rolin e këtij personaliteti. Sipas tyre, pas Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ishte ai që u përpoq ti bashkonte Malet e Dibrës. Dhe si atëherë kur biri i derës së Kastriotëve mblodhi arbërit ngado ishin për t'i bërë ballë ordhisë osmane, i mblodhi kundër Hajredin Pashës që deshi të nënshronte me gjak e me hekur Dibrën në nëntor të vitit 1844.

Filozofia e tij ishte diçka magjike, sidomos për sulltanin dhe pashain, i cili dridhmohej nga magjia e filozofisë paqësore, që dilte nga një rajon si Dibra i stërmbushur me urrejtje, luftëra të gjata për liri e pavarësi kombëtare.

Dhe kështu, ngazëlleu zemrat e dibranëve dhe gjithë shqiptarëve, e të sa e sa prijësve , të kombeve të mëdha, që i dolën zot kombit të tij, ashtu sikurse deshi ai. Është kjo magjia e fuqisë së paqes, e fuqisë së besimit, e fuqisë së drejtësisë, të cilën diti ta jetësoi një njeri si Ai.

Sheh Mustafa lindi në Zerqan, në vitin1790, në një familje që përmendet si derë klerikësh, mendjendritur dhe bujare, patriotë dhe trima, njerëz të penës, të pushkës dhe të urtësisë.

Ai u shqua në luftën kundër ekspeditës së Hajredin Pashës, në nëntorin e vitit 1844, në Gjoricë. Turqit e torturuan dhe e internuan në Kojne të Turqisë, ku dhe vdiq atje në vitin 1847.

Më 3 tetor 1839 në një mbledhje në pallatin e tije mbretrore, Salla e Trandafilave, Abdyl Mexhiti firmosi dekretin, me të cilën filloi periudha e Tanzimatit.

Parimet themelore të kësaj reforme ishin: administrative, financiare, juridike, ushtarake, arsimore e shoqërore. Me këtë dekret, salltani rikërkonte të nxirrte Turqinë nga sistemi i vjetër perondorak dhe ti ndihmonte vendit e tijë të ecte përpara në rrugën e modernizimit.

Dekreti i Gjylhanes u prit nga popullsia shqiptare me zemërim të madh. Në Dibër dhe në shumë vise të tjera shqiptare vendimet e portës së lartë, jo vetëm se nuk u zbatuan, por u luftuan deri në fund, derisa në vitin 1875 porta e lartë hoqi dorë përfundimisht nga ideja e Tanzimatit.

Si ndodhi?

Dibranët me të dëgjuar për vendimet e portës së lartë u bënë gati dhe rrëmbyen armët.

Ndërsa Sulltani emroi Hajredin Pashën, në krye të ushtrisë që zgjodhi për të shtypur kryengritjen e armatosur në Dibër e gjithë Shqipërinë. Ky vendim i sulltanatit i detyroi malet e Dibres të mblidheshin në kuvend tek kalaja e Brezhdani. Kuvendi vendosi të kundërshtonte me luftë ekspeditën e Hajredi Pashës. Bashkë me nëntë malet u bashkua dhe krahina e Rekës dhe Golloborda. Kuvendi i maleve vendosi që këtë luftë ta drejtonte Mustafa Shehu një personalitet i sprovuar në beteja të rëndësishme.

Shtabi i Hajredin Pashës ishte i vendosur në Pollog. Marshimin pashai e nisi nga Tetova nëpër Radikë, e drejt e në Dibër. Nga Pollogu u nisën drejt Dibrës një armatë e madha ushtarësh dhe bashkëpunëtorësh të pushtuesit dhe mercenare që numronin rreth 50 taborë. Ushtria e të dërguarit të Sulltanit u ndesh me luftëtarët dibranët tek Çezma e Sulltanit në grykë të Radikës. Më 22 shtatorë 1844 u zhvilluan luftime të përgjakshme. Mbas shume luftimesh, Pashai i theu kryengritësit dhe me 23 shtator u fut në Dibër (Shehër) dhe filloi politikën e luftës përçarse midis bejlerëve të Dibrës.

Në këto kushte ku u gjendën paria e Dibrës, Mustafa Shehu mblodhi kuvendin e qëndresës në Gjoric. Në këtë kuvend morën pjesë të gjithë malet, morën pjesë të gjithë burrat më të zë të krahinës, ata të cilët kishin shkruar me kaq shumë përpjekje atë që do të quhej qëndresë, ndër ta Cen Leka, Sale Marka, Ismail Kaloshi, Nel Hoxha, Abaz Pira e tjerë... Po kështu, Mustafa Shehu i kërkoi ndihmë Kaloshit, një nga krerët e Cidhnës si dhe Mustafa Jakini nga Dardha. Ata u treguan të gatshëm dhe ndima e tyre ishte e pa kursyer. Kjo bëri që fushata e luftimeve të Hajredin Pashës të dështonte.

E gjithë dibra mori pjesë në luftë,Gjorica, Cereneci, Vicishti, Ura e Topojanit,Shupenza, Qafa e Buallit, dhe katër grykët u organizuan dhe zunë pritat. Pleqtë, fëmijët, gratë dhe bagëtit i shvendosën në Fush të Sopotit, Vorre të Vrame, Bllatë e Qaf Muhurr.

Më 23 tetorë 1844, Hajredin Pasha u nis të kaloi Vaun e Gjoricës. Në Gjoricë u zhvilluan përleshje të ashpra, u luftua pëllëmbë për pëllëmbë. Me gjak e vaditën bijt e nanave atë copë tokë. Në luftime morën pjesë dhe gratë përkrah burrave, sepse kjo ishte një betejë për liri a vdekje. Nga rezistenca e popullsisë dibranë, pashai pasi vrau dhe plaçkiti, u detyrua të kthehej andej nga erdhi. Ndersa dibra i ngriti kenge kesaj beteje.

Hajredin Pasha po vjen Radikës
Pejt ku jon malet e Dibrës:
"Vall ku jon malet e Dibrës?"
"Bojn' xhilis në fushë t'Gjuricës,
bojn xhilis e lidhin besën
Hajredin pashën do ta presim"
"Moj Gjuricë, moj kasaba,
Çon Pasha e t'bon rixha.
Po rixhaja s'ju ka digjou
I kthej topat me luftou"
Sheh Zerqani fjalë ka cou:
"Thoj Kaloshit me na ndihmou.
Grikn e Madhe e kanë rrethou.
Përreth Drinit tu luftou
Ximca mbet, ximca pjagou"
Mustaf Jakini mustaqebardhë,
Boni irish e zou në dardhë,
Hiçu pashë, se të kam falë,
kom kuvend me Mirallajnë"
Ditën e martë u zou nizaja
Hajredi pashën e xhet belaja;
E xhet belaja çi e ka xhetë,
Shtatë taborret i janë shkretë;
Nandë mijë vorret kush i boni?
"Të nandë malet e sheh Zerqani"
Rizvan Halla me atë sokore,
S' po pushon tue bomun vore!
"Kush ja prejshi fesin Pashës?"
"Fazli Malja e Pjaku i Krajkës."

Me heroizmin e treguar Dibra mbeti lavdia e shqiptarëve dhe pengesa e osmanllinjve për të zbatuar reformat e tanzimatit.

Udhëheqësi i kësaj lufte popullore ishtë, Mustafa Shehu i Zerqanit. Kjo ishte ajo faqe e rëndësishme e historisë së përpjekjeve të përgjashme dhe vetëmohuese të dibranëve dhe roli vendimtar që pati në këtë fitore të madhe, Mustafa Shehu, ai i cili diti të shndërronte gjithë atë urrejtje, gjithë atë zemëratë dibrane në një fuqi sfiduese ndaj një prej ushtarakëve më të rëndësishëm të portës së lartë dhe ndaj një prej ushtrive më të frikshme që ka njohur ajo kohë.

Kur ke të drejtën në krah, kur ke një zemër të vaditur me gjak lirie, kur krenarinë, tokën e të parëve dhe zotin ke në anën tënde, nuk ka fuqi, ushtri apo hordhi që të mposht.



Referenca:

Historia e Dibres, Gazeta Rruga e Arberit, Gazeta Bulqiza,Doc. I shkencave: H Mandi Moisi Murra, Haziz Ndreu, Publicisti H. Rama, Gojdhana nga njerze te zones.....Fotografia derguar Nga mjeku Naim Shehu sternip i Mustafa Shehut...

**Historiku i shërbimit shëndetësor të Dibrës në optikën e mjekut të parë dibran**

# Dr. Ahmet Alliu, mjeku i parë i Dibrës

Nga **prof.as.dr.NAZMI KOÇI**

*Me mjekun e parë dibran, Dr. Ahmet Alliun, u takova para disa ditësh në mënyrë krejt të rastësishme. Kisha pyetur për të sa herë kishte rënë rasti, sidomos gati çdo ditë të bijën, Anjeza Alliu, kur punonja në Ministrinë e Shëndetësise dhe kisha mësuar se ishte mirë nga shëndeti, (përveç një inerventi kirurgjikal që e kishte kaluar me sukses) dhe bënte një jetë të qetë e normale. Realisht më kishte marre malli dhe doja ta takoja e të çmallesha me të, por rasti nuk më ishte krijuar, pasi Tirana është qytet edhe i vogël edhe i madh njëkohësisht.*

*Një ditë në mëngjes teksa po nxitoja në rrugën e Barrikadave për në punë, pashë të vinte përballë meje një zotëri i veshur shik dhe me një kapele republike të vënë në kokë në mënyrë që të lejonte të shihje vetëm pjesën e fytyrës poshtë syve. Ecte i qetë e i shkujdesur dhe ishte në qejfin e vet. Kur u shkëmbyem më ra  në sy një stil i veçante të ecuri që dikë më kujtonte. Pasi bëra disa hapa e tanimë po largoheshim nga njëri-tjetri, më ra ndërmend ecja  disi karakteristike e Doktorit dhe u ktheve që ta pyes. Por sapo u ndodhem përballë , ai qeshi, hoqi kapelen dhe më tha; Jam Dr. Ahmeti. U përqafuam si vëllezër dhe pa asnjë diskutim i lamë problemet e ditës dhe ju drejtuam një kafeneje aty afër.*

*Biseduam hollë e gjatë, por pas pyetjeve të zakonshme për shëndetin, familjen, hallet e jetës në këtë periudhë tranzicioni etj., biseda jonë shkoi përpara. Mjekët kanë një avantazh të madh që unë e kam paraqitur thjeshtë, janë simite të një furre, pasi janë formuar në të njëjtën shkollë. Kjo i bën ata që të kenë njohje për shkollën, për pedagogët, profesionin pasi kanë studiuar njëkohësisht ose pak vite më parë apo pak më vonë në të njëjtin vend. Dhe për çfarë mund të bisedojnë dy dibranë, mjekë, përveç se për mjekësinë e për Dibrën, natyrshëm për mjekësinë dibrane.*

*Bisedën e udhëhiqte Dr. Ahmeti dhe unë më tepër po bëja dëgjuesin,  edhe pse dhe unë kam studiuar shpejt dhe kam përvojen time në Dibër dhe në Tiranë. Tek po e dëgjoja me respekt Doktorin e parë të Dibrës, vura re se ai po më thoshte ca gjëra interesante edhe për mua që jam diplomuar para 49 vjetësh. E kam thënë edhe diku tjetër se duhet t'i bëjmë më të mëdhenj të flasin, t'i pyesim e t'i dëgjojmë, pasi secili prej tyre është një bibliotekë më vete dhe këtë fond nuk na e servir askush tjetër përveç vetë autorit. Duke qenë se po dëgjoja të dhëna mjaft interesante vazhdova ta pyes e ta ripyes dhe më lindi ideja që mendimet e tij  t'i hedh në letër. Ndoshta dhe lexuesi do të gjejë gjëra interesante pasi bëhet fjalë për shërbimin tonë nga koha kur Dibra nuk kishte mjekë e mbahej me "miell uha" dhe deri në ditët tona. Se nuk ka qenë kështu. Për të arritur aty ku jemi sot është dashur mundi e djersa e shumë kolegëve, një pjesë e të cilëve janë larguar nga Dibra, ndërsa disa të tjerë mjerisht janë ndarë nga jeta, është dashur kontributi i gjithë personelit shëndetësor për t'i dhënë këtij shërbimi atë emër të bukur e të thjeshtë - Mjekësia dibrane. Megjithatë le të ja lëmë fjalën mjekut të parë të Dibrës, Dr. Ahmet Alliut.*



*Dr. Ahmet Alliu, Tiranë 2016*

*Pyetje: Dr. Ahmeti, kur dhe ku keni lindur?*

- Kam lindur me 25 mars të vitit 1933 në fshatin Strikçan të Zerqanit dhe jam i biri i Ramadan Alliut e kam dy motra dhe një vëlla, mësuesin e popullit Selim Alliu, i cili ishte mësues edhe për mua. Kam dy vajza: Ildën dhe Anjezën dhe bashkëshorte Anastasi Alliun një mësuese e njohur në Peshkopi.

*- Na thoni ndonjë detaj për fëmijërinë dhe shkollimin tuaj fillestar.*

- Fëmijëria ime ka kaluar përmes viteve të luftës së dytë botërore ku edhe vendi ynë ishte i përfshirë.

Klasën e parë fillore e kam bërë në shkollën fillore të Zerqanit në vitin 1944. Duke qenë se vinim nga fshatrat për rreth edhe drekën e hanim në shkollë. Shkolla fillore e Zerqanit asokohe kishte 4 mësues që kishin mbaruar normalen e Elbasanit. Mësuesi im i klasës së parë ishte nga Kosova dhe quhej Elhami Nimani, vëllai i të cilit erdhi më vonë nëpunës në Ambasadën Jugosllave në Tiranë. Punohej me përkushtim të madh si nga ana e mësuesve, por edhe ne nxënësve. Gjate viteve 1944, 45, 46 mbarove arsimin e plotë  fillor.

*- Po më tej si vazhdoi shkollimi juaj?*

- Më vonë kam vazhduar shkollën unike (kështu e quanim atëherë arsimin 7 vjeçar, më vonë 8 vjeçar) në Peshkopi ku rrinim në konvikt. Kisha shokë nga krahina ime Selami Muglicën, Esat Cakën, Adem Sollakun dhe Riza Liken (për kuriozitet të lexuesit këta janë të katër nga Okshtuni). Kështu gjatë viteve 1946, 47 dhe 48 e kreva me sukses shkollën unike në Peshkopi

*- Si vijuat më tej me arsimin e mesëm?*

Në atë kohë ishte hapur shkolla Pedagogjike në Peshkopi dhe trendi ishte të studiojë aty për mësuesi. Po thuaj të gjithë ata që mbaruan uniken kaluan në shkollën Pedagogjike. Veç atyre që thashë më lart ishin edhe të tjerë si Mois Cami, Zenel Sula, Lutfi Hanku, të cilët studiuan për mësuesi.

Unë refuzova të shkoj në Pedagogjike dhe shkova në katund. Për fatin tim të mirë, atë vit u hap në Tiranë Teknikumi mjekësor me konvikt dhe pa hezituar unë shkova dhe u regjistrova atje. Gjatë viteve 1948-1952 kam kryer Tenikumin mjekësor dhe u titullova ndihmës Mjek.

*- Dr. Ahmeti, meqenë se rreth nja 10 vjet pas jush atë shkollë e kam kryer edhe unë, na thuaj ndonjë detaj, si ishte atëherë ajo shkollë, që në kohën time u quajt Politeknikum, pasi përgatiste edhe farmaciste, ndihmës dentiste, laborante dhe mami?*

- Në vitin e parë kishte më shumë lëndë të përgjithshme. Bënim pak fizike dhe matematike, por aq sa mendohej se i vlen profesionit tonë. Studionim latinisht dhe sidomos Rusisht. Nga lëndët mjekësore fillohej me Anatomin normale të njeriut. Në vitet e mëvonshme dominonin lëndët mjekësore dhe studimi i sëmundjeve të brendshme, infektive, të lëkurës që bëheshin në teori por edhe me praktike. Kështu ne dolëm të përgatitur dhe një pjesë që nuk vazhduan me tej, kanë shërbyer gjatë si N/mjeke në fshatrat e rrethet e tyre dhe kanë zgjidhur hallet e njerëzve duke qenë pranë tyre, por dhe të aftë profesionalisht.

*- Po në Fakultetin e Mjekësisë si u regjistruat?*

- Edhe këtu më ndihmoi fati. Më 22 shtator të viti 1952 u hap në Tirane Instituti Mjekësor që unë e konsideroj një date historike për Mjekësinë shqiptare. Nga ata që kishin përfunduar Teknikumin Mjekësor, rreth 32 veta kaluam direkt në Institutin Mjekësor ku ishim gjithsej 54 studente, prej të cilëve rreth 40 ishin konviktore. Hapja e Fakultetit në atë kohë bëri bujë të madhe dhe ne ishim vërtetë të kënaqur se do te bëheshim mjeke dhe do të ishim mjekët e parë të vendit. Kështu nuk kursyem asgjë, të gjitha forcat për realizimin e këtij objektivi që e kishim ëndërruar shumë e tanimë po bëhej realitet.

*- Dr. Ahmeti, Ju keni studiuar në kohën kur pedagoget ishin nga Rusia dhe programet ishin rusë, pra shkolla ishte e tillë. A mund të na thoni ndonjë detaj, si funksiononte se veç të tjerave problem ka qenë edhe gjuha, shumica e pedagogëve nuk dinin shqip?*

- Po ka patur shumë veçori shkolla në kohën tonë. Kjo së pari se pedagogët ose ishin shqiptare të shkolluar në perëndim në shkollat më në zë të kohës, ose ishin pedagoge të shkollës ruse, të moshuar e me eksperiencë të madhe klinike e pedagogjike. Midis pedagogëve shqiptarë, që në shkollë të mesme por dhe më vonë, na jepte obstetrike-gjinekologji Dr. Jovan Basha që kishte mbaruar shkëlqyeshëm në Vjenë, shok e mik i Lasgush Poradecit. Lëndën e Mikrobiologjisë e Bakteriologjisë e jepte Mjeku erudit shkodran Luigj Benusi që kishte punuar në Romë dhe në Institutin Luigj Paster në Francë dhe vetë ai kishte krijuar atje një vaksinë me emrin e tij. Të tjerë pedagogë kanë qenë patologu Nikolla Shurbani, pediatri  Selaudin Bekteshi, Infeksionisti Nikolla Dushniku, i cili ishte edhe kryetar i komisionit shtetëror të diplomimit të mjekëve të parë shqiptar. Ndërsa Kirurgjinë e jepte i famshmi Frederik Shiroka dhe Frederik Paparisto edhe ky një mjek i shkëlqyer. Ne që kishim bërë Teknikumin mjekësor ishim më të përgatitur pasi kishim marrë më parë njohuri në fushën e mjekësisë dhe arrinim rezultate më të mira kur krahasoheshim me ata që vinin nga gjimnazet.

*- Po pedagoget ruse si ishin si mësimdhënës, a ju kuptonin ata juve apo thjeshtë bënin punën e tyre?*

Pedagoget ruse ishin të një kalibri të lartë dhe vinin pas eksperiencave shumëvjeçare në fushën e mjekësisë në vendet e tyre. Drejtori i pare i Institutit Mjekësor ka qenë Medar Shtylla. Por Zv. Drejtor i Institutit Mjekësor në vitet 1952-1957 ka qenë profesori rus Anikin, i cili jepte edhe Histologji. Nikulçenko, profesor në moshën 70 vjeçare jepte Anatomi normale, Profesori i Institutit të Neurologjisë në Moskë, Zaharov, erdhi të më dhe jepte Neurologji. Po kështu Semjanova jepte Anatomi patologjike dhe Mjekësi Ligjore, Shçepkin ishte profesor i Fizio-patologjise e mjaft të tjerë.

Mësimi fillonte në 8 të mëngjesit me leksione e vazhdonte me praktika e zaçote deri në orën 17 çdo ditë, veç të djelës. Çdo pedagog rus ishte i shoqëruar edhe nga një pedagog shqiptar që kishte studiuar në Rusi dhe që bënte edhe përkthyesin. Përkthyes ishin Profesorët Ferdinand Paparisto, Petrit Gaçe, Pëllumb Bitri etj., që më vone do të ishin autoritetet më të shquara të Mjekësisë shqiptare. Ne ishim të interesuar që të mësonim rusisht dhe të përgjigjeshim në gjuhën ruse në provime pasi pedagogët ruse ishin shumë të arsyeshëm e tolerantë me ne sidomos kur flisnim në gjuhën e tyre. Kjo na nxiti shumë që të përparonim më shpejt në gjuhën ruse. Sigurisht kjo ishte një bonus për në, pasi asokohe literature ruse në vendin tonë ishte dominuese, ndërsa mjekësia e tyre e zhvilluar edhe në shkallë botërore. Unë kisha një avantazh se isha gjithmonë me numër rendor 1,  pasi emri fillonte me A dhe, përsëri i pari se mbiemri me fillonte me A. Kjo bënte qe  të isha gjithmonë i pari që do të pyetesha në provime, bile dhe në provimin e shtetit isha i pari, kështu unë u bëra mjek nja 30 minuta para shokëve. Në këtë kuptim jam jo vetëm mjeku i parë i Di-

→

cyan magenta yellon black



*Dr. Ahmet Alliu, vizita e parë në Peshkopi, shtator 1957*

*Lexuesi do të gjejë gjëra interesante pasi bëhet fjalë për shërbimin tonë nga koha kur Dibra nuk kishte mjekë e mbahej me "miell uha" dhe deri në ditët tona. Se nuk ka qenë kështu. Për të arritur aty ku jemi sot është dashur mundi e djersa e shumë kolegëve, një pjesë e të cilëve janë larguar nga Dibra, ndërsa disa të tjerë mjerisht janë ndarë nga jeta, është dashur kontributi i gjithë personelit shëndetësor për t'i dhënë këtij shërbimi atë emër të bukur e të thjeshtë - Mjekësia dibrane.*

brës, por dhe i pari në Shqipëri i diplomuar në vendin tonë. Kjo kishte një të keqe se duke qene i pari, komisioni i freskët dhe merrej me mua më shumë se me të tjerët, por pastaj çlirohesha dhe e gjithë dita ishte e lirë për mua, ndërsa shokët rrinin në radhë para derës së provimit. Por e shijoja fitoren para të gjithëve. Vitet ecën shpejt dhe më në fund në u diplomuam Mjekë dhe ishim 52 mjekët e parë të shkollës shqiptare në vitin 1957.

*- Po më tej si ecën punët me mjekët e parë shqiptarë?*

U shpërndamë të gjithë nëpër rrethe dhe unë erdha me gëzimin e një të riu në Peshkopi. Shoku im i klasës, Zenel Kazhani nga Mati, shkoi në rrethin e tij dhe u emërua në Burrel. Peshkopinë e njihja dhe erdha me gëzim se atje kisha bërë edhe shkollën unike siç ju thashë më lart. Por tani vija si mjek, bile i pari mjek dibran dhe kjo ishte përgjegjësi e madhe për mua. Me këtë entuziazëm që më shoqëronte nuk bëra asnjë ditë pushim, por shkova në Peshkopi dhe direkt në spital. Aty më priti me shumë ngrohtësi. Dr. Hysni Rusi, i cili kishte kohë që donte të largohej nga Dibra, kështu që dhe ai e priti me gëzim ardhjen time në Peshkopi. Ai më njohu me spitalin që asokohe ishte te ndërtesa njëkatëshe në formë U-je dhe i ndarë në pavione. Reparti Infektiv dhe Dispanceria ishin të ndarë nga spitali. Kapaciteti i shtretërve varej sipas profilit te pavionit. Kështu Reparti i Patologjisë kishte rreth 40 shtretër, Pediatria 35, dhe Kirurgjia 35 shtretër. Infektivi kishte 20 shtretër dhe ishte i ndarë nga pjesa tjetër. I dëgjova me vëmendje shpjegimet e kolegut, por u befasova kur më tha se ti do të punosh në Pediatri, në repartin infektiv, Mjekësi ligjore dhe Anatomi Patologjike. Ndërhyra dhe i them se unë nuk jam i specializuar dhe Pediatria është delikate e kërkon njohuri prej specialisti. Por Doktori nuk më la të flas më tej, por më tha: Në se ke vullnet dhe dëshirë për misionin që ke marrë për t'u bërë mjek, do ta shohësh edhe vetë pa kaluar shumë kohë rezultatin. Askush nga ne nuk ka dalë nga shkolla specialist për të gjitha, por unë e them me kompetence se jam Patolog, Radiolog, Pediatër, bile dhe Administrator specialist. Ne na bën puna specialistë. Tani e ndjej veten të përgatitur dhe jam i gatshëm të punoj kudo në sektorin e shëndetësisë qoftë edhe si Pedagog në Fakultetin e Mjekësisë. Dhe ashtu ndodhi ai u bë një nga pedagogët e shquar në Fakultet, ndërsa mësimi i tij ishte udhërrëfyes për mua. Përveç se një njeri i mirë e fisnik, Dr. Rusi ishte human, studiues i zellshëm i mjekësisë dhe simpatizant i letërsisë dhe i muzikës.

Në Peshkopi do të vinte edhe Dr. Koço Poro, por ai po vazhdonte një kurs për ekzaminimin Radiologjik të stomakut, kështu unë mbeta për një periudhë dy mujore mjeku i vetëm i spitalit të Peshkopisë. Ishte përgjegjësi e madhe pasi përveç se mjek i ri duhet të mbuloja të gjithë repartet përveç Kirurgjisë të cilën e mbulonte Lona Toptani.

*- Na thuaj ndonjë gjë për këtë specialiste pasi nuk dimë sa duhet për te.*

- Lona Toptani nuk e kishte mbaruar Fakultetin. Kishte arritur deri në vitin e pestë dhe e kishte ndërprerë nga lufta. Por ajo kishte punuar gjatë gjithë jetës në Kirurgji me Kirurgun tonë më të famshëm, Dr. Frederik Shirokën dhe kishte mësuar shumë mirë, prandaj ishte e aftë profesionalisht. Krahas Kirurgjisë ajo mbulonte me kompetencë edhe Maternitetin dhe ishte plotësisht e suksesshme. Ishte njeri i mirë, e urtë e me shumë kulturë. Mbrëmjeve kur ishim të lirë, unë dhe disa intelektualë të tjerë, mblidheshim në dhomën e saj dhe luanim me letra e dëgjonim muzikë, natyrisht vendin e parë në bisedat tona e zinte Mjekësia. Në Maternitetin e Peshkopisë kanë punuar edhe Margarita Menzelxhiu (ishte gruaja e Jashar Menzelxhiut) si dhe Nora Palushi , Bardha Hasani, Drita Nura etj. të cilat patën emër të mirë në Peshkopi.

*- Dhe si vazhdoi puna juaj në spitalin e Peshkopisë në ato vite?*

- U përballa me një sëmundshmëri të pa imagjinueshme në rrethin e Dibrës, ku më alarmante ishin sëmundjet infektive që kërcënonin jetën e njerëzve , shpesh e ndërprisnin para kohe atë. Mjaft sëmundje vinin nga burime të ndryshme infeksioni, por kishte edhe probleme të kulturës së jetesës. Na u desh të ecnim shumë, shtëpi më shtëpi dhe të punonim sa me mjekime e ilaçe aq edhe me propagandë shëndetësore. Në një epidemi fruthi në vitin 1957 më është dashur të vizitoj brenda një ditë fëmijët e sëmurë dhe të bëj qindra vizita në një kohë të shkurtër në zonën e Gollobordës. Në zonat malore kam hasur e mjekuar tifo ekzentematike, tifo abdominale, meningjite meningo koksike e purulente dhe Difteri, pasi krupet difterike shkaktonin vdekje. Më vonë u mësova të bëj punksion lumbar të cilin vetëm e kisha parë në shkollë, mësova nga halli dhe kjo u bë rutinë në punën time. Më vonë u hap shërbimi i Neurologjise dhe kjo ishte punë e tyre, por ky ekzaminim bëhej me raste.

Në rrethin e Dibres Tuberkulozi ishte rrezik serioz dhe prekte edhe mosha të reja deri edhe fëmijë, pasi të sëmurët e moshuar hanin e flinin bashkë me ta. Ai ishte i përhapur në gjithë rrethin, por sidomos në zonën e Reçit, Dardhës etj. Në spitalin e Peshkopisë gjeta një Ndihmës Mjek që quhej Skender Hoxha, mjaft i aftë dhe shumë i rregullt në punë. I apasionuar në punë Skënderi kishte bërë i pari kartelizimin e Sëmundjes tuberkulare. Ai u martua me një vajzë nga Trepçet në Peshkopi, por kishte dëshirë të madhe të bëhej mjek. Iku nga Dibra dhe u bë Mjek e u specializua në Kirurgji, ka punuar në Lushnje dhe kohët e fundit ka ardhur në Tiranë.

*- Dr. Ahmeti, po para se të vinit ju në Peshkopi dhe para se të bëhej ky spitali një katësh (që atëherë quhej "spitali i ri" ) për të cilin na folët, si ishte shërbimi shëndetësor në Peshkopi?*

- Mbaj mend se që kur unë isha në shkollë unike na takonte të shkonim për t'u vizituar në spitalin e Peshkopisë. Në vitet e pas çlirimit, më 1944-1945, në Peshkopi kishte shërbim shëndetësor lëvizës, vinin herë pas here ekipe mjekësore nga Tirana, kishte dhe një spital të vogël i cili ishte vendosur në një shtëpi private, në shtëpinë e Imer Maliqit. Në atë spital sipas të dhënave që kam mundur të mbledh ka pas punuar një mjek Italian që quhej Savochio De Michele. Më vonë, gjatë vitit 1944 ky ishte Mjek në Zerqan dhe unë e njihja pasi ishte aty kur unë fillova klasën e parë në Zerqan.

*- A dini gjë për fatin e këtij mjeku që u muar me shëndetin e dibranëve para jush, kur ju ishit fëmijë?*

- Po, për çudi, ky mjek erdhi në Peshkopi në vitin 1982, pasi i kishte lënë mbresa kultura dhe mikpritja e dibranëve dhe ishte i shoqëruar nga Thanas Nano që asokohe ishte Drejtor i radio-televizionit. Thanas Nano dhe i biri (Fatos Nano) e kishin mik familjar Dr. DE Michelen dhe e shoqëruan ngado ku ai deshi nëpër Shqipëri. Unë e takova Doktorin dhe bisedova italisht me të, pasi nuk isha i panjohur me gjuhën e tij. Prej tij mësova se jetonte në Romë dhe kishte atje një fermë me mollë. Ai shprehu dëshirën që të shkonte në Zerqan dhe ne e dërguam. U kënaq e çmall me Zerqanin. Populli i Zerqanit , kuptohet ata më të moshuarit që e mbanin mend, u mblodhën në qendër dhe e takuan, e pritën me përzemërsi të madhe. Doktori iku i përmalluar e me emocione të medha nga Zerqani dhe nga Dibra.

*(Vijon numrin e ardhshëm)*

LIBRA










Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi. Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):

Rruga e Arbërit nr. 143

Shënime për Jashar Bungurin, dibranin që u qëndroi betejave të jetës së tij me pushkë, penë, dije, gërshërën e krasitësit dhe briskun e shartuesit...

profil

# Jashar Bunguri, gjeneral i bujqësisë shqiptare

## Një pyetje për Bashkinë e Dibrës: A është "qytetar nderi" Jashar Bunguri?

*Nga* **ABDURAHIM ASHIKU**
**FITIM BUNGURI**



E kam të fiksuar portretin e tij në zyrën e kryeagronomit të rrethit të Dibrës në solemnitetin e specialistit dhe të njeriut.

Isha asokohe agronom i mesëm në lokalitetin e Qendrës. Zyrat i kishim në nëndhesen e Komitetit Ekzekutiv të rrethit. Një kat më lartë, në krah të majtë kur ngjisje shkallët, ishin zyrat e seksionit të bujqësisë; zyra e shefit asokohe Idriz Lala, zyra e ekonomistëve, ajo e krye zooteknikut dhe kryeveterinerit e në qosh, majtas zyra e kryeagronomit.

Ajo që më kishte bërë përshtypje ishte bukurshkrimi i tij dhe paraqitja e evidencave, përmbledhje që i çonim ne agronomët e lokaliteteve dhe raportet që përgatiste. Nuk kam njohur njeri në jetën time që të ketë një kaligrafi kaq të bukur e rregull në drejtshkrimin e gjuhës shqipe e në evidenca.

Bukurshkrimin e tij e gjeta në një fotografi ku shkruante: Gostivar Qershor 1939...

Më vonë, kur mbarova studimet e larta, pak larg me njeri tjetrin në detyra, do ta takoja e admiroja sa shembulli i tij më vlonte e më frymëzonte...

Ky ishte Jashar Bunguri, agronomi, gjenerali i bujqësisë shqiptare e në veçanti asaj dibrane...

Më vonë kur lexova në një maket për historinë e luftës për Çlirimin e vendit nga pushtimi nazi-fashist Jashar Bunguri më doli "me pushkë në dorë" maleve të Dibrës, kësaj e asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar...

E ndjeja se diçka duhet të fusja në arkivin e shkrimeve të mia për njerëz që i dhanë Dibrës dhe Shqipërisë pa u mburrur dhe ikën duke marrë me vete heshtjen.

Më ndihmoi i biri, Fitim Bunguri...

Kur i dhashë fund e quajta GJENERAL...

Kur t'i dilni në fund rrëfimit do të bashkoheni me mua...

Ai, Jashar Bunguri, ku nuk shkoi dhe ku nuk fitoj betejës së jetës së tij: me pushkë, me penë, me dije, me gërshërën e krasitësit dhe briskun e shartuesit.

Tash e kam të gjerë portretin e një njeriu që do të desha ta shoh me emër e mbiemër në një rrugë të vendeve ku punoi, në një bust atje ku lindi dhe iku...

### KUSH ISHTE JASHAR BUNGURI?

Jashar Bunguri u lind më 24 korrik 1916, në Grevë, një fshat pranë Peshkopisë, në një familje fshatare të mesme, me një ekonomi të dorës së tretë. I ati, Zeqiri, nga fisi Bunguri, i vetmi fis ky në Shqipëri dhe vetëm në Grevë, pjesëtarët e të cilit, edhe pse midis tyre tashmë mund të jenë 7-8 brezash kushërinj, vazhdojnë të trajtohen si të afërt.

E ëma e tij Nailja, bashkëshortja e Zeqirit, ishte nga shehlerët e fshatit Vranjt, në një familje të varfër e me pak tokë, por me cilësi të larta morale e etike, motra e Shahin Shehut.

Nailja humbi jetën shumë shpejt e kështu, Jashari mbeti jetim që në moshë minore. Në këto kondita, Zeqiri u martua dhe mori një grua të dytë, Lumnijen, nga Dovolani, e martuar më parë në Dibër të Madhe dhe e mbetur atje e ve me një djalë jetim të cilin ajo e mori me vete dhe e rriti nën kujdesin ekonomik të Zeqirit deri kur ai arriti moshën 16 vjeç dhe u largua për të ndjekur jetën e tij të lirë.

Në vitin 1925-1926, u regjistrua në shkollën fillore të fshatit, ku jepte mësim një mësues nga Kosova. Aty ai tregoi mjaft zell e dëshirë për të mësuar, kështu që, mbështetur në këshillat nga mësuesi i tij, si dhe me ndihmën e influencën e nipërve të Zeqirit, që ishin nga shehlerët e Peshkopisë, në 1928 u regjistrua në shkollën fillore në Kastriot, me bursë të shtetit i sistemuar në internatin e asaj shkolle. Kjo shkollë, megjithëse fillore, kishte një nivel përgatitës shumë të lakmueshëm përçka, shumë nxënës që mbaruan atë, me vonë u futën në punë në shtet dhe treguan se kishin një përgatitje mjaft të mirë.

Në këtë shkollë, Jashari u detyrua që mësimet t'i fillonte që nga klasa e parë. Falë përgatitjes së tij të mëparshme, zellit dhe përkushtimit, arriti që brenda tre viteve t'i merrte të pesë klasat. Në vitin e parë mbaroi klasën e parë e të dytë si dhe tremestrin e parë të klasës së tretë, në të dytin mbaroi klasën e tretë dhe të katërt, në vitin e tretë mbaroi klasën e pestë duke mbaruar kështu komplet shkollën fillore në vitin 1930, në moshën 14 vjeç.

Po atë vit, me mbarimin e verës, për arsye të ecurisë së mirë në mësime dhe rezultateve të mira që kishte arritur, iu akordua e drejta e studimeve më tej, me bursë shteti, në shkollën amerikane teknike Harry Fultz në Tiranë.

Në vitin 1933, për arsye të një grindjeje së bashku me një shok tjetër me një nga profesorët, u përjashtuan një vit nga shkolla. Me disa ndërmjetësime u arrit të vazhdonte mësimin në Shkollën Bujqësore Shqiptaro Amerikane të Kavajës, duke i u njohur vitet e kryera në Tiranë. Në vitin 1935, korrik, mori dëftesën që e shpallte atë teknik të mesëm bujqësor. Këtë shkollë ai e kreu me rezultate shumë të mira. U shpall nxënësi më i mirë i shkollës, dhe emri i tij, për disa vite më vonë, mbeti i pa ndryshuar e i pa konkurruar nga ndonjë tjetër siç do të më deklaronte në vitin 2010, kur unë punoja në Fushe Krujë, një bashkë shok shkolle i tij, emrin e të cilit tani nuk e kujtoj, që gjithashtu kishte mbaruar atë shkollë tre vite me vonë. Për rezultatet e mira në mësime (Jashari zotëronte anglishten, versionin amerikan, në mënyrë ekselente sa, të gjithë anglisht folësit amerikanë me të cilët pati rastin të komunikonte nuk e besonin se e kishte mësuar atë jashtë ndonjë vendi ku anglishtja ishte gjuhë zyrtare dhe e folur).Nga shkolla u përgatitën letrat për të vazhduar studimet e larta në Libi në"Robert Colledge", shkollë kjo që kishte lidhje me dy shkollat amerikane në Shqipëri, me bursë shteti, por për arsye që nuk u sqaruan kurrë kjo gjë nuk u realizua.

### PUNËTOR KRAHU NË FIDANISHTEN XHAFZOTAJ...

Pavarësisht mbarimit të shkollës, duke mos ju siguruar punë nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, fillimisht punoi si punëtor krahu me një grup të punëve botore dhe nga tetori 1936, përsëri punëtor, në fidanishten antifilokserike në Xhafzotaj. Për mungesë fondesh edhe nga kjo punë u ndërpre, e pas shumë përpjekjesh, më vonë u bë kryepunëtor i rrugëve pranë zyrës së punëve botore në Durrës, ku punoi deri ne vitin 1937.

### AGJENT BUJQËSOR NË GURI I ZI NË SHKODËR

Pas pak kohe u largua nga kjo punë dhe ndoqi kursin njëmujor në Xhafzotaj, për agjent bujqësor, të cilin e përmbushi me rezultate shumë të mira dhe që me mbarimin e tij u emërua agjent bujqësor në Shkodër, në lokalitetin Guri i Zi. Atje ka vazhduar e ka kryer një punë shumë të mirë e duke lënë kujtime shumë të mira. Një nga bashkë shokët e tij të asaj kohe të quajtur Shuk Radoja e kam njohur personalisht dhe ende i kam në vesh kujtimet e mira dhe fjalët e ngrohta për tim atë.

### PJESËMARRËS NË DEMONSTRATËN ANTIFASHISTE...

Në maj të 1938, përsëri për mungesë fondesh u lajmërua për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës por ndërkohë, ai u njoftua për tu paraqitur të kryente shërbimin ushtarak aktiv, shërbim të cilin e kreu pranë Gardës Mbretërore me detyrë llogaritar toge, me grade tetar, ku qëndroi në shërbim deri më 7 prill 1939, shërbim ky që u ndërpre për arsye të okupimit fashist të vendit.

Në prag të pushtimit, me datat 5-6 prill në Tirane u organizuan demonstrata, në përgjigje të rrezikut të para ndjerë. Edhe pse ushtarak ai mori pjesë nëkëto demonstrata.

### EMIGRANT NË JUGOSLLAVI...

I pikëlluar thellë nga fatkeqësia që pllakosi Shqipërinë me pushtimin fashist, së bashku edhe me disa të tjerë, me 11 prill, emigruan jashtë Shqipërie, në Jugosllavi.

Qeveria Jugosllave e kohës e Kral Petrit, të gjithë emigrantët i mblodhi në një kamp përqendrimi në Gostivar. Pavarësisht faktit e të qenit emigrant, masa e tyre nuk ishte e njëjtë sa i takon bindjeve. Jashari, bashkë me disa shokë të tjerë me bindje përparimtare, edhe përkundrejt qëndrimeve krejt të kundërta të një pjese tjetër emigrantësh, arritën të formojnë një grup që kishte në përbërje mjaft studentë, punëtorë, zanatçinj etj, në krye të të cilëve dalloheshin disa udhëheqës si Mustafa Gjinishi etj, dhe ku në përbërje mund të përmenden edhe anëtarë të tjerë si Hamit Shijaku, Xhevdet Doda etj.

Grupi do të vazhdonte gjatë e do të kishte ecur përpara, por qëndrimi në Gostivar nuk zgjati shumë. Qeveria shqiptare e asaj kohe nën pushtimin fashist, kohë pas kohe, me nota proteste, kërkonte largimin sa me larg të të gjithë grupimit të emigrantëve, që edhe për arsye të pranisë mes tyre të ish oficerëve dhe zyrtarëve të ndryshëm të Zogut, e konsideronte këtë grupim si një kërcënim potencial për rendin në Shqipëri.

Grupi pat luhatjet e veta sidomos për arsye të depërtimit në të të elementëve të tillë si Sadri Dini e Stavri Bojaxhiu të cilët më vonë vërtetuan se nuk qenë elementë të shëndoshë.

Për arsye edhe të protestave të autoriteteve shqiptare, grupi i emigrantëve me vonë u nda në grupe më të vogla, të cilat u depërtuan në thellësi të vendit deri ne kufi me Rumaninë e Hungarinë, ku qëndruan deri ne pushtimin e Jugosllavisë nga forcat gjermane në vitin 1941, pas të cilit, ata u përqendruan në një kamp përqendrimi në Jugosllavi të vjetër. Në këtë kohë, të ngarkuarit shtetërorë, që merreshin me ndjekjen e emigrantëve në këtë kamp, iu deklaruan atyre se tashmë qeveria jugosllave ka rënë, ata janë pa asnjë mbështetje dhe në këto kondita do të duhej t'i dilnin vetë zot vetvetes dhe fateve.

### RRUGA E VËSHTIRË E KTHIMIT NË ATDHE...

Rruga e kthimit u bë në kushtet e mungesës së dokumenteve, udhëtim që falë aftësive të Jasharit që ndërkohë kishte mësuar gjuhen serbo-kroate shkëlqyeshëm, në të folur dhe në folklor, arritën të marrin dokumente fallco duke u deklaruar si tregtarë kosovarë.

Një udhëtim mes peripecive e lëvizjeve tepër të vështira, tepër të rrezikshme për jetën, nga Negotini i Serbisë së Vjetër, në Kosovë, Prizren e mandej në Shqipëri, në Kukës.

Rënia e qeverisë jugosllave, kishte bërë që të ngrinin krye kundërshtitë e vjetra nacionaliste ku serbet vrisnin çdo kalimtar që mbante në kokë një qeleshe të bardhë, shqiptarët nga ana e tyre vrisnin çdo kalimtar që mbante në kokë kasketë duke e konsideruar atë serb dhe të dyja palët vrisnin çdo person që nuk mbante asgjë në kokë. Grupi ka lëvizur, me masa sigurie, duke u transportuar nga një bazë në tjetrën në distanca të shkurtra dhe jo ditën. Shumë nga ata njerëz, që ai i trajtonte më vonë miq, kam pasur rastin t'i takoj edhe vetë personalisht edhe ani pse nuk po ju a përmend këtu emrin, mbeten ndër personat më të nderuar e më të respektuar.

Pas rikthimit në Shqipëri punoi disa kohë në një shoqëri italiane ndërtimore në rrugën Burrel-Peshkopi, si magazinier, për të kaluar më vonë agjent bujqësor, në zyrën e bujqësisë Peshkopi.

### ME ARMË NË DORË PËR ÇLIRIMIN E ATDHEUT NGA PUSHTUESIT

Në vitin1942, edhe në Dibër ishin shfaqur elementë të nacional çlirimtares si Nazmi Rushiti, mjeku veteriner Stefan Luarasi, doktor Toma Harito etj. Jashari që gjatë emigracionit, kishte shfaqur afëri dhe aktivitete me elementë progresistë si Mustafa Gjinishi dhe ishte pjekur tek ai plotësisht mendimi për qëndrimin e tij politik, ndaj ai që në fillim ra në kontakt me të sipër përmendurit. Në këtë kohë pat rastin të binte në kontakt edhe me Haxhi Lleshin, në fshatin Grevë.

Në vitin 1943, për arsye sigurie dhe presioni të vazhdueshëm, ndërpreu marrëdhëniet e punës si agjent bujqësor, ai u vu në lidhje me një grup të veçantë i cili bashkëpunonte ngushtësisht, fillimisht me çetën dhe më vonë me batallonin partizan që komandohej nga Haxhi Lleshi.

Mbas kapitullimit të ushtrisë italiane, për arsye edhe të gjuhës angleze, qëndroi disa kohë përkthyes pranë një misioni ushtarak anglez, nga i cili u shkëput në nëntor të vitit 1943.



Me ardhjen në Peshkopi të Brigadës së Parë, të Katërt dhe të Pestë, mori pjesë në të gjitha betejat për çlirimin e Peshkopisë dhe me 18 gusht të 1944, me themelimin e Brigadës së 18–të Sulmuese, u inkuadrua në radhët e saj, fillimisht si partizan e më vonë komandant kompanie që e vazhdoi deri në çlirimin e vendit. Pas kësaj Brigada vazhdoi luftimet jashtë kufijve të Shqipërisë si Kërçovë, Prizren etj.

Në dhjetor 1944 kaloi në Brigadën e Dytë të mbrojtjes së popullit me detyrë komandant kompanie në Shkodër.

### DETYRA TË REJA NËPËR ATDHE ...

Në shkurt 1945, për të plotësuar nevojat për kuadro në administratën civile, të gjithë kuadrot me formim teknik profesional, u liruan nga detyrat ushtarake. Edhe babai im, doli oficer në lirim me grade n/toger dhe u caktua ndihmës agronom në Peshkopi. Ndërkohë pas 5-6 muajsh falë edhe rekomandimeve u pranua edhe anëtari PKSH.

Në vjeshtë të 1945 u emërua përgjegjës i Seksionit të Bujqësisë dhe Ekonomisë të rrethit për të kaluar nga 1 tetori ndihmës agronom i bujqësisë i qarkut Dibër ku qëndroi nga 1 tetori 1946 deri 31 janar 1947 kur u transferua në Ministrinë e Bujqësisë dhe të pyjeve fillimisht inspektor i degës së kontrollit, e më vonë shef i Seksionit të Planifikimit. Më 16 shkurt 1949 u emërua Drejtor i Teknikumit Bujqësor në Kamzë ku qëndroi deri në fund të prillit të po atij viti. Duke qenë në Ministri të Bujqësisë nga 1.10 deri 1.11 1947 mori pjesë në një kurs special për instruktor në ngritjen dhe organizimin e kooperativave bujqësore, kurs të cilin e kreu me rezultate të shkëlqyera. Më 1 maj 1949 u transferua pranë Komitetit Qendror me detyrë Instruktor pranë Drejtorisë së Bujqësisë ku punoi deri më 31 korrik 1951.

### NJOLLA NGA NJOLLAT E KOHËS...

Jashar Bunguri, partizani, agronomi, komunisti nuk i shpëtoi njollave të kohës...

Punimet e plenumit të 11-të të Tiranës dhe dënimi i grupit të deputetëve midis të cilëve edhe ai i Faik Shehut i cili ishte nip i familjes sonë (djali i hallës i babait), nuk kaloi pa reperkusione dhe pasoja për babain dhe familjen tonë. Për arsye se ai nuk bashkëpunoi me sigurimin e shtetit që të bënte dëshmi të rreme në dëm të Faik Shehut, fillimisht u dënua si mos bashkëpunues, por me vonë u hoq edhe nga të qenit anëtar partie.

Dy persona, madje shokë të tij kanë qenë ata të cilët insistuan shumë ta detyronin të depononte në gjyq, që të dy me funksione të larta në parti e që kanë punuar edhe në Dibër (emrat e të cilëve nuk po i bëj publike) qenë ata që përcaktuan edhe vijën ndëshkuese dhe goditëse mbi babanë tim. Që të dy, i kam njohur shumë mirë e më vonë do të dënoheshin nga partia, do të përjashtoheshin, e njeri prej tyre edhe u pushkatua. Tjetrin, pata rastin ta takoj me fillimet e demokracisë. I ardhur në Dibër me detyrë elektorale edhe pse në pension, paturpësisht iu drejtua bashkë shokut të tij edhe ai dikur Sekretar i dytë në Dibër, "ja shoku... këtu kemi djalin e shokut Jasharit, një shok i mirë partie, i cili do të na ndihmojë ne". E pashë me neveri, dhe i thashë, "Zoti..., unë disponoj të gjitha kujtimet me shkrim të babait tim, përshtypjet që ai kishte për njerëzit dhe emri juaj nuk më del në anën e miqve dhe shokëve e dashamirësve të tij." Iku i menderosur.

### RRUGA E GJATË E QËNDRESËS DHE E PËRKUSHTIMIT PROFESIONAL

Heqja nga partia ishte baras me një pushkatim për atë kohë. Ajo qe pararendësja e një serie lëvizjesh të cilat në thelb ishin dënime. Fillimisht, me 1 gusht 1951, deri 15 janar 1952 si kuadër në dispozicion në Ministrinë e Bujqësisë pa ndonjë detyrë të përcaktuar ku u muar me punë të ndryshme. Por Jashari, për disa, nuk duhej të qëndronte në Ministri të Bujqësisë. Ai u transferua në janar të 1952 kryeagronom në Sektorin e Kullës të NB "8 Nëntori" Sukth, një sektor ky i ri ku përftohej tokë e re përmes shpyllëzimeve ku qëndroi deri në shkurt 1953. Drejtor i NB nëatë kohe ka qenë Kalo Plaku, i cili, pasi e ka thërritur në zyrë, edhe pse nuk njiheshin midis tyre, i ka thënë atij fjalë për fjalë: "Ndigjo Jashar Bunguri, këtu do të ta shtyp kokën si të miut". Kalua, nuk e njihte tim atë dhe s'kishte arsye të shprehej kështu përveçse të reflektonte çka shprehej në letrat që ndiqnin atë.

Se çfarë ndodhi më vonë me familjen e Plakajve, familje me goxha peshë e goxha merita të veçanta, i dimë mirë të gjithë. Dikush nga ata u arratis, dikush u pushkatua, shumë u internuan, u persekutuan disa edhe u helmuan, një histori kjo mjaft e dhimbshme. Për ironi të fatit nuk qe babai im të cilit t'ia"shtypnin kokën si të miut."

Pavarësisht, ti themi "armiqve të tij", të cilët punonin fuqishëm për ta ulur gjithnjë e më poshtë, im atë kishte edhe shokë e miq midis të cilëve Haki Toska, Pirro Dodbiba e tjerë, të cilët, të bindur për pafajësinë e tim eti dhe goditjet e padrejta ndaj tij,shfrytëzonin çdo mundësi që u jepej për ta emëruar nën donjë punë të mirë në pozicion drejtues.

Më 1 dhjetor të vitit 1951 ai emërohet Drejtor NB Ullishtore të Vlorës por që ende pa e marrë detyrën me 8.12.1951 shkarkohet nga kjo detyrë dhe emërohet N/Drejtor, Agronom pranë SMT Kavajë.

Duket se për ata të cilët ndiqnin me interes jetën e tim eti Kulla nuk përbente një pozicion aq ndëshkues. Në shkurt 1953 ai (kuptohet edhe familja jonë) u transferua fillimisht Përgjegjës Sektori, por që më vonë u zbrit në detyrën e Agronomit të sektorit, në Plug, sektor ky i ri, pranë kënetës ku edhe hapej tokë e re, në NB 29 Nëntori Lushnjë. Kur ne shkuam atje gjetëm shumë njerëz, të cilëve u thonim demokratë, (nuk e di as vete për ç'aresye), tëcilët ishin të huaj ende të mbetur në Shqipëri. Midis tyre kishte maqedonas, italianë, grekë etj. shumë prej të cilëve ende i kujtoj mirë, por që do të lëvizeshin nga aty sepse në vend të tyre do të vinin, të internuarit, të dënuarit politikë, ajka e tyre si markagjonajt, mirakajt, agollet, kaloshet etj. Ishte e qartë. Lëvizja ishte e studiuar dhe e paramenduar. Jashari, shpejt do të futet në bashkëpunim me ta, me ndonjërin apo disa prej tyre, do tu bënte favorizime dhe kështu do të kompletohej dosja ndaj tij për ta marrë në përgjegjësi penale dhe për ta kaluar nga i lirë në të dënuar. Im atë, me një përkujdesje brilante, in extremis, u ruajt nga çdo mundësi korruptimi dhe provokimi. Unë atëherë kam qenë në klasë të katërt e fillova të pestën, dhe isha aq i pjekur sa të kuptoja gjithçka ndodhte rreth nesh.

### ARKITEKT I BUJQËSISË SË RE DIBRANE...

Krahas kujdesit dhe maturisë së vazhduar, im atë, nisur edhe nga fakti se të dy pleqtë e tij, në moshë goxha të shtyrë kishin mbetur vetëm e pa mbështetje, (por jo vetëm për këtë), edhe për t'ju larguar rrezikshmërisë potenciale që paraqiste qëndrimi i tij atje, u kthye në Dibër ku u emërua N/Drejtor dhe Agronom i SMT, detyrë të cilën e mbajti deri kur në vend të tij u emërua një njeri tjetër agronom me arsim të lartë. Pranë SMT ai punoi deri 31 dhjetor 1956.

Me 1 janar 1957, me vendim të Byrosë të KP të Rrethit u emërua agronom i II-të i rrethit e që më vonë, për 14 muaj u emërua e punoi Drejtor i Ndërmarrjes Lokale Bujqësore Peshkopi. Këtu ai bëri shumë punë në bashkëpunim me shokë të tij të vjetër si Xhavid Hysa, Met Hajrullai, Sadik Papuli, Sabri Kaba, Xhevat Xhidra (nga Kërçishti) e ndonjë tjetër që nuk më kujtohet tani, duke ngritur kështu fidanishten e parë, përzgjedhjen e kultivarëve më të mira të ershive, kumbullave e hardhive vendase të Dibrës, si dhe përgatitjen e frutikultorëve dhe specialistëve krasitës të Dibrës të cilët u bënë më vonë emblematikë në punën e tyre dhe krenaria e Dibrës në këtë fushë duke e shndërruar atë në një shkollë të vërtetë të pemëtarisë moderne.

Me 1 maj 1960, me largimin e ish k/agronomit te rrethit, Adil Maksuti, ai u emërua k/agronom, detyrë të cilën e mbajti deri me 30 shtator 1960, kohë në të cilën u emërua Kryetar i Kooperativës Bujqësore Melan e ku qëndroi deri në shkurt të 1961 kur u rikthye në detyrën e k/agronomit të rrethit.

Jeta e vështirë që në fillimet e saja, që në mbetjen jetim, peripecitë e ndryshme, sidomos ato që lidhen me periudhën pas përjashtimit nga partia sidomos, nuk do të kalonin pa pasoja përshëndetin e tij. U shfaqën shenjat e para të pakësonit, nga vitet '60-të e cila u konfirmua me vonë nga vizita në Tiranë në klinikën e neurologjisë nga Dr. Prof. Bajram Preza. Ky do të ishte pushkatimi i dytë për tim atë. I përgatitur, me një kulturë të gjerë, shumë dije prej të cilave i siguroi si studiues autodidakt, ai ishte i ndërgjegjshëm për pasojat e rënda të asaj sëmundjeje, por që kurrë nuk i u nënshtrua, kurrë nuk paraqiti ndonjë rënie a demoralizim, përkundrazi deri në fund ai qëndroi luftarak.

Pas një pune katërvjeçare në drejtim të Degës së Farërave e cila i u ofrua si një punë më e qetë, në 1966, me rekomandim po të Dr. Prezes, Komisioni Mjeko-Ligjor i Dibrës e kaloi atë në pension invaliditeti të shkalles së dytë ku për 20 vjet deri në vdekjen e tij, falë mjekimeve, kujdesit të vazhduar e të pandërprerë të mamasë sime, bashkëshortes se tij Dilfiruzit, një grua sa punëtore aq e fisme, e palodhur, që për mua do të mbetet simboli i bashkëshortes ideale, ai mundi t'i rezistojë asaj sëmundjeje. Për fatin e saj të zi dhe për ironi të fatit, 20 vite më vonë si për t'i rikujtuar dramën e tmerrshme që kaloi me tim atë, ajo po ashtu përfundoi me parkinson, a thua se ky ishte shpërblimi për sakrificën e saj.

Do të desha po ashtu, duke përfituar nga rasti, se një kontributore mjaft e rëndësishme në mbështetjen ndaj tim eti fillimisht, por më vonë edhe ndaj mamasë sime, ka qenë edhe bashkëshortja ime Mukadesi, bijë e Piperkëve, një grua kryeulët, e urtë e pajisur me të gjitha cilësitë më të mira të cilës nuk do të mund t'ia shpërblej dot kurrë. Ajo i trajtoi prindërit e mi dhe iu shërbeu atyre sikur të ishin prindërit e vet, bile më shumë se vetë prindërve të vet.

Pavarësisht faktit që im atë përfundoi në pension me parkinson, mbështetur edhe mbi rekomandimin e Dr.Prezës, u kërkua dhënia e lejes për ndërtimin e një shtëpie private, me oborr d.m.th. me bahçe ku të mund të ushtrohej në punë fizike dhe tërmeti i 67-ës e gjeti shtëpinë tonë karabina. Falë edhe saj, im atë vazhdoi të zhvillonte punën me pemëtariçka ishte pasioni i tij duke ndërtuarnjë bahçe modeste por edhe model të cilën që të gjithë ata që e shikonin e vlerësonin pa masë, sa që nuk kanë qenë të rralla rastet kur njerëz të ndryshëm, që nuk na njihnin, duke kërkuar të takonin Haxhi Lleshin, i cili vinte shpesh në pushime në shtëpinë e pritjes, gabimisht drejtoheshin tek shtëpia jonë duke menduar se ajo ishte shtëpia e pritjes.

Jashari, pavarësisht sëmundjes, raportet me shokët e miqtë e tij të punës i mbajti të gjalla deri në fund. Parkinsoni i kufizoi lëvizjen fizike por logjika e tij dhe memoria mbetën të paprekura e të admirueshme deri në fund. Gjithë jetën e kishte zhvilluar anën e tij të intelektit. Ai ishte një studiues i pa ndërprerë dhe një mësues e përvetësues i gjuhëve të huaja. Ai fliste ekselent anglishten, ekselent serbo-kroatishten, fliste mirë italishten, dhe me hapjen e kurseve të para u fut dhe mësoi goxha rusishten.

### I DASHURUAR ME SKENËN DHE KËNGËN...

Por babai, kishte edhe një dimension tjetër. Ndonëse shumë i zënë me punë, ai e dashuronte artin skenik. Ai mori pjese në ekzekutimin e pjesës teatrale "Lulja e Kujtimit", në rolin e Kristos si dhe rolin e Bejto Flakës tek komedia" Kthimi" të Jonuz Dinit. Për të dy ato role ka mare çmime lavdëruese. Im atë gjithashtu ishte një këngëtar shumë i mirë, kishte njëzë burrëror e të plotë, vesh muzikor të shkëlqyer, ndonëse nuk e ushtroi zërin e tij. Ai, që në shkollën amerikane, mësoi dhe iu binte mandolinës dhe violinës vegla që kanë qenë nështëpinë tonë deri në 1966. Ka qenë ndër të parët që ka realizuar fotografi. Kishte një aparat ZeissIkon i cili punonte me pllaka xhami.

Për merita lufte, për kontributin e madh në mbështetje të lëvizjes, pasi im atë por edhe ati i tij Zeqiri, ndonëse i madh në moshë, merrnin pjesë aktive në luftë dhe shtëpia jone në Grevë shërbente si bazë lufte. Për këtë arsye, si mase represive, ajo shtëpi u dogj, madje dy herë. Ishte e vetmja shtëpi në Grevë e cila u dogj, e që u rindërtua mbas luftës, por e cila për ironi të fatit dhe për turp të atyre që e bënë nuk u shpall kurrë bazë lufte dhe nuk i u vendos pllaka përkujtimore.

Pavarësisht kësaj babai vetë mori medaljen e trimërisë e të kujtimit si dhe medalje të tjera dhe mori pensionin shtesë si veteran lufte deri në fund. Jo pse është babai im por kam qenë dhe jam tepër krenar për një prind si ai, model që më ka udhëhequr gjithë kohës e gjithë jetës sime.

Shënim: Një pyetje për Bashkinë e Dibrës: A është "qytetar nderi" Jashar Bunguri?

**Në 8- vjetorin e mungesës**
**së një figure të respektuar të futbollit dibran**

sport / kujtesë

# **Fadil Shulku,** portieri modern i kohës

*Nga* **Defrim METHASANI**

8 vjet më parë, ndërsa luhej finalja e madhe e kampionatit botërorë mes Gjermanisë dhe Spanjës, zhurma e tifozëve në qytetin e Peshkopisë, sikur u zbeh dhe ajo mbrëmje vere në qytetin e blirëve pllakosi në zi. Njëri prej njerëzve të shquar të familjes Shulku dhe këtij qyteti, ndërroi jetë. Fadil Shulku nuk ishte vetëm një dhimbje familjare, por edhe qytetare. Humbja e tij, ishte edhe për familjen e madhe të sportit dibranë dhe klubin e futbollit Korabi. Por cili është Fadil Shulku, portieri i njohur I skuadrës së Korabit, që bëri emrin e tij dhe së bashku me Bashkim Lalën, krijuan duetin e bukur të portës dibrane.

Fadil Shulku ka lindur ne Peshkopi me 2.9.1948. Ka mbaruar shkollën 8-vjeçare "Demir Gashi", ndërsa në vitin 1967 mbaron gjimnazin në këtë qytet. Historia sportive e tij nis që në bankat e shkollës, kur në veprimtaritë shkollore ai spikaste shumë. Fadili ishte një djalë pasionant i shkathët dhe mjaft aktivist në të gjitha sportet, por duket se kuadrati i portës i shkonte më shumë përshtat. Cilësi të tilla, nuk i shpëtuan syrit të trajnerit pasionant Luan Kumbarçe. Ishte viti 1965 dhe Fadili pasi shfaqet mirë në ekipin e pionierëve, aktivizohet tek të rinjtë e Korabit. Ai rritej shpejt dhe bashkë me të dhënat trupore, duket se rritej edhe personaliteti si lojtarë. Në vitin 1967 trajneri i mirënjohur Bexhet Shehu, guxoi dhe ofroi pranë skuadrës së të rriturve një djalë të ri, por të talentuar të portës, siç ishte Fadil Shulku. Ky afrim i tij tek ekipi i parë i Korabit, do ti shërbente si trampolinë, në vitet që kreu shërbimin ushtarak në Elbasan, ku Fadili do të bëhej pjesë e skuadrës së njohur të Labinotit, krahas emrave legjendë, si Mihal Gjika, Rifat Ibërshimi, Nevruz Duçka, etj. Pas rikthimit në Peshkopi,





**Deri në vitin 1978, ai luajti për ngjyrat e Korabit, duke spikatur me pritjet e tij, saqë ishte bërë figurë shumë e dashur nga spektatorët dibranë. Ndryshe konsiderohet si akrobat dhe pozicional, ku me pritjet e shkëlqyera, dhuronte spektakël në fushë. Në karrierën e tij të gjithë mbajnë mend portierit që priste penalltitë, madje numri 14 është fiksuar në kujtesën e sportdashësve dibranë...**

rikthehet sërish në fushën stërvitore. Tashmë gara për një vend në kuadratin e portës, ishte bërë me e fortë dhe më e bukur. Bashkim Lala dhe Fadil Shulku, ishin binjakë të portës, që konkurronin për një vend në formacionin e Korabit. Trajnerët hasnin vërtet vështirësi, për të përcaktuar më të mirin dhe shpesh herë bëhej me mirëkuptim të tyre. Në fillim të viteve 70-të, Fadil Shulku kërkohet nga Besëlidhja e Lezhës, por ai nuk e pranoi këtë ofertë, duke mbetur besnik i Korabit dhe shokëve të tij. Në vitin 1971 ky portier i talentuar, kërkohet nga ekipi Shpresa, por pa I dhënë asnjë arsye, autoritet në rreth nuk e lejuan të shkonte.

Gjithsesi kjo nuk e zbehu dëshirën e tij, për të vazhduar me të njëjtin pasion udhëtimin në rrugën e bukur të futbollit. Reflekset, pritjet e guximshme dhe plazhonet, krijuan personalitetin e duhur të një portieri modern të kohës. Deri në vitin 1978, ai luajti për ngjyrat e Korabit, duke spikatur me pritjet e tij, saqë ishte bërë figurë shumë e dashur nga spektatorët dibranë. Ndryshe konsiderohet si akrobat dhe pozicional, ku me pritjet e shkëlqyera, dhuronte spektakël në fushë. Në karrierën e tij të gjithë mbajnë mend portierit që priste penalltitë, madje numri 14 është fiksuar në kujtesën e sportdashësve dibranë, si një rast i rrallë që ky portier kish koleksionuar në një histori sportive. Në ndeshjen e fundit kundër 10 Korrikut të Gramshit, për fat të keq ai u dëmtua në gju dhe iu desh të ndërpriste karrierën futbollistike, por asnjëherë dashurinë e tij për futbollin dhe Korabin. Në stadiumin Korabi, asnjëherë nuk do të mungonte edhe si spektator Fadil Shulku, që më pas, do të ishte po kaq shumë I dhënë pas volejbollit të vajzave. Së pari sepse shoku i tij i ngushtë Bashkim Lala mori në dorë fatet e këtij sporti dhe arriti maja, por së dyti sepse edhe vajza e tij Miranda Shulku Damzi, do të bëhej volejbolliste dhe do të luante për ngjyrat e kësaj skuadra të dashur, Korabi. Fadili deri në ditën e ndarjes së tij nga jeta, mbeti një veprimtar i mirë dhe njeri po i tillë, që asnjëherë nuk u nda nga sporti dhe veçmas futbolli. Ai la pas gjurmë kujtese dhe respektin si njeri, duke pasuruar më shumë opinionin dhe vlerësimin për familjen Shulku dhe protagonistët e saj në sportin dibran dhe atë shqiptar. Të gjithë e mbajmë mend edhe nipin e tij, Ilir Shulku, që aktualisht është sekretar i FSHF, por që ka qenë njëri nga futbollistët më të mirë të Partizanit dhe ekipit tonë kombëtar.



**DR SELAMI NAZIFI: Kush nuk e mban mend Fadil Shulkun, djaloshi intuitiv dhe gaztor. Pritjet e tij i kam edhe sot ne kujtese. Ne vitet 66-68 pata fatin te jem pjesë e Korabit. Natyrisht nuk isha në lartësinë e tyre, por isha në skuadër dhe shihja nga afër duelin tepër miqësore mes Fadilit dhe Bashkim Lalës. Ata ishin rival, por miq të dy bashkë. Në lojë shpesh herë vendoste fatet e ndeshjes, ashtu siç kishte ndonjë moment kur mund të bëhej nevrik dhe mund të pësonte ndonjë gol. Gjithsesi respekti për këtë figurë të futbollit është i padiskutueshëm.**

**ISMAIL SHULKU: Ishte dhe mbetet vëllai më i mirë për ne. Unë shpesh herë e marr si shembull kur flas me miq dhe njerëz të afërt. Ishte shumë kavalier dhe i gjendshëm jo vetëm për gjakun tonë, por për të gjithë ata që e njihnin. U bënë 8 vjet pa të dhe vërtet akoma ndjej dhimbje si atë ditë që na iku. Mbaj mend kur shkonim me babën të shihnim ndeshjet në stadiumin Korabi. Edhe pse i vjetër dhe me një shkop në dorë, ai ndiqte vëllain dhe kur dëmtohej ndonjëherë baba bëhej keq. Fadili është gëzuar më shumë nga ne të gjithë kur djali im Iliri u bë futbollist. Sa herë e shihte në tv më merrte në tel dhe më uronte. Ishim shumë të lidhur bashkë dhe vërtet e ndjej shumë mungesën e tij. Përfundimisht pa hezitim e them që ishte më i miri.**

**BEXHET SHEHU, ish trajner i Korabit: Fadil Shulku ishte një portier i gjatë dhe me një trup të bukur. Në kohën e tij, konkurrenca me Bashkim Lalën ishte super e vështirë që unë të bëja zgjedhje. Gjithsesi, të dy i kisha për zemër. Fadili bënte pritje të vështira dhe dhuronte spektakël në fushë.**

**EDMOND HASANI, gazetar: Fadili ishte shembull i portierit në epokën moderne të futbollit, që pati ndikim dhe në Shqipëri! Ishte një nga portierët më prezentabël dhe autoritarë në fushë në Shqipëri!**

talente në futboll

**Alia dhe Halili, dy dibranët e kombëtares U-19**

Nga **DEFRIM METHASANI**

# DRINI HALILI: Objektivi është Kombëtarja!

*Drini Halili, është dibrani 18 vjeçar që luajti për ekipin tonë përfaqësues U-19 kundër Kazakistanit, në dy sidat miqësore që ekipi ynë luajti në stadiumin "Roza Haxhiu" të qytetit të Lushnjës. Ai jeton në Graz të Austrisë dhe aktivizohet me skuadrën e dytë të qytetit GAK dhe është kandidat kryesorë për të veshur fanellën e ekipit të parë me të rriturit. Edhe babai i tij Ilir Halili, ka qenë futbollist me ekipin e Korabit të Peshkopisë, ndërsa sot familja e tij jeton në Durrës. Drini Halili ka luajtur 6 ndeshje me ekipin përfaqësues U-19 dhe ka shënuar dy gola, por po kaq ndeshje ka luajtur edhe me ekipin përfaqësues U -17. Pas ndeshjes së dytë të luajtur në Lushnjë me Kazakistanin i morëm një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit", që ai e dha me shumë kënaqësi.*



*Si e nise futbollin Drini?*

E kam nisur në moshën 7 vjeçare në Durrës. Duke pasur dhe babin tim Ilirin një ish futbollist, gjithmonë ky sport më ngacmonte brenda shpirtit dhe ëndrrës sime për tu bërë edhe unë si ai, pra futbollist. Fillimet janë me ekipin e trajnerit Mikel Furxhi dhe aty jam hedhur hapat e parë, madje në jo pak, por pesë vite. Trajneri dhe shokët, me jepnin vlerësime pas stërvitjes ose ndeshjeve të shumta që bënim, por babai im nuk kënaqej kollaj, sepse kërkonte shumë nga unë. Golat që shënoja në ndeshje e lumturonin atë dhe aty nisi të bindej është ai, që rruga ime mund të ishte edhe jashtë Shqipërisë.

Dhe kjo rrugë prej aty nisi?

Jo, kalova te skuadra U 15 e Teutës dhe aty punova me një tjetër emër të njohur të trajnimit durrsak, Lutfi Sejdini. Kishim një ekip të bukur që rivalizonte në kampionate dhe aty edhe unë personalisht pata një rritje të cilësive fizike, teknike dhe taktike. Xhaxhallarët e mi që jetojnë atje, më krijuan mundësinë që të provohesha në Graz, qytetin ku Uzriu, Arjani dhe Arturi jetonin prej vitesh. Veçmas Arjani është marrë shumë me mua. Ndaj vendosa dhe shkova atje, duke ndryshuar kësisoj kursin e rrugëtimit tim për futbollin. Atje bëra provat dhe u pëlqeva nga specialistët e ekipeve të moshave në Graz. Fillimet e mia i takojnë klubit Leibnitz, por kohëzgjatja dhe bashkëpunimi aty ishin vetëm tre muaj, sepse menjëherë kalova te ekipi "GAK 1992".

*Cilat janë disa nga arritjet e tua ne Graz?*

Ndjehem mjaft mirë atje edhe pse në fillim e kam pasur të vështirë për tu ambientuar, sepse kuptohet vendi, skuadra, qyteti, njerëzit, shokët, të gjithë ishin të huaj...Por u përshtata dhe ia dola. Deri tani kemi dalë nënkampion me ekipin U-17. Në moshën 16 vjeç kam arritur të jem pjesë e ekipit të dytë të të rriturve, që për momentin ndodhemi në vend të parë. Së shpejti do të kaloj tek ekipi i parë dhe ndoshta sapo të arrij në Austri. Por krahas arritjes brenda klubit, qëllimi im ka qenë gjithmonë Shqipëria dhe ekipet tona përfaqësuese. Fillimisht jam aktivizuar me ekipin përfaqësues U-17 dhe kam luajtur në gjashtë ndeshje, ndërsa më pas kalova te moshat U-19.

*Si erdhi kjo ftesë e trajnerit Bogdani dhe si është bërë përzgjedhja juaj?*

Ka qenë një turne që stafi i skuadrës U-19 me trajnerin Bogdani realizuan në Zvicër. Aty mblodhën shumë talente shqiptarë që jetonin jashtë Shqipërisë. Unë pata fatin të isha i pranishëm dhe s'duket cilësitë e mia i bënë për vete stafin dhe trajnerin, që të bëhesha pjesë tashmë e një moshe më të rritur. Turneu që u bë vitin që shkoi, më ndihmoi të nxirrja në pah vlerat e mia dhe aty shënova edhe dy gola kundër Maltës. Ftesa tjetër ishte kjo e fundit, që luajtëm përballë Kazakistanit. Ndeshjen e parë mendoj se ia dolëm jo vetëm në rezultat, por edhe në lojë. Ndërsa ndeshja e dytë ishte më shumë një test për lojtarët se qëllim pqër të fituar.

*Si u njohe me Marko Alinë dhe a e dije që është dibran?*

Që ditën e parë qëllova te dhoma e tij dhe ai tha që jam nga Fushë Alia e Dibrës. U gëzova që ishim dy dhe krijuam vërtet shoqëri. Edhe Marko është një talent dhe të luash tek Lacio në Itali nuk është kollaj. Me Markon flasim shpesh jo vetëm për futbollin, por edhe për Dibrën. Në fakt as unë dhe as ai s'kemi lindur atje, por prindërit tanë dhe natyrisht është vendi që duam dhe respektojmë.

*Meqë ra fjala për Dibrën, sa nostalgji keni për të dhe a shkoni ndonjëherë atje?*

Kam lindur në Durrës, por e them me krenari që jam dibran. Dibrën e kam shumë për zemër. Babai dhe xhaxhallarët më flasim gjithmonë për vlerat dhe bukuritë e saj. Kur isha në Durrës shkonim shpesh me prindërit. Kemi akoma shumë njerëz të gjakut tonë atje. Lagja që jetonte familja ime në Dobrovë me ngjallte shume emocione. Familja jonë ishte shumë sportive. Kam dëgjuar për gjyshin tim Avni Halili që ka qenë mundës i mirë, po ashtu edhe babi im futbollist, ndërsa unë jam vazhdimësia e zinxhirit sportiv të kësaj familje.

*Ëndrra tjetër cila është...?*

Qëllimi i radhës është kualifikueset të ekipit U19, Dua të jap maksimumin tim në ndeshjet kualifikuese dhe uroj që skuadra jonë të arrij këtë objektiv. Më tej kuptohet që objektivi dhe qëllimi është kombëtarja e madhe. Nëse arrij ta vesh atë bluzë, do të isha njeriu më i lumtur. Gjithmonë mendoj për Shqipërinë edhe pse jetoj jashtë saj...

Të uroj suksese dhe shpresoj që intervistën tjetër ta bëjmë kur të kthehesh për ndeshjet kualifikuese.

# MARKO ALIA: Mes Italisë dhe Shqipërisë, zgjodha vendin tim!



*Marko Alia është talenti 18-vjeçar që veshi fanellën e skuadrës sonë kombëtare U-19, duke ruajtur portën kuq e zi. Fitorja e kësaj skuadre përballë Kazakistanit dhe pritja e tij spektakolare në një rast përballë tij, kanë mbetur në kujtesën e të gjithëve, duke evidentuar djaloshin dibran që luan për skuadrën e Lacios në Itali. Edhe pse Italia e ftoi për të qenë pjesë e skuadrës përfaqësuese të moshave, Marko zgjodhi fanellën kuq e zi dhe atdheun e tij për ta përfaqësuar. Prindërit e tij, Gazmiri dhe Zemria, emigruan pas vitit 1997 në Itali, ndërsa në vitin 2000, bëhen me djalë dhe pikërisht atë vit lindi ky futbollist i spikatur që dashurinë për Dibrën dhe Shqipërinë kurrë s'do ta mohonte.*

**Talenti dibran dhe shqiptar i Lacios Marko Alia, rrëfen emocionet e tij në kombëtare, ftesën, zgjedhjen që bëri, fitoren me Kazakistanin dhe qëllimet e së ardhmes.**

*Marko si e prite ftesën e trajnerit Erjon Bogdani?*

E prita me shumë emocion. Kohë më parë kisha ofertën e trajnerit italian për të qenë pjesë e përfaqësues së tyre të moshave, por bëra zgjedhjen e zemrës, erdha me Shqipërinë, vendin ku kanë lindur prindërit e mi, vendin që sado ka probleme, më duket më i miri se askush tjetër. Ftesën e prita shumë mirë. Në fakt Bogdani më kishte testuar tek një turne miqësor që u bë një vit më parë. Edhe aty ia dolëm dhe fituam. Fati e desh që të dallohesha dhe t'ju hyja në zemër edhe stafit dhe trajnerëve.

*Përballë Kazakistanit fituat ndeshjen e parë ku ti ishe në formacion. Prite edhe një rast. Si ju përgëzuan pas ndeshjes?*

Në fakt unë gjatë gjithë ndeshjes vetëm një rast pata për t'u evidentuar, kur sulmuesin kundërshtar e kisha vetëm pak metra larg portës, por e prita topin pas gjuajtjes së tij dhe e devijova atë mundësi, duke mos pësuar gol. Detyra e një portieri është të mos pësojë gol dhe natyrisht në atë ndeshje nuk pësuam. Shokët dhe trajnerët, por edhe sportdashësit më pritën mjaft mirë. Pas ndeshjes kishin ardhur edhe shume tifozë të më takonin. Aty pashë edhe kushërinj ose sportdashës dibranë që kishin marrë rrugën prej andej. Emocion i bukur patjetër.

*Lacio është skuadra juaj, por edhe e disa emrave të tjerë talentesh shqiptarë, si Berisha, Strakosha, etj. A po bëhet një shkollë shqiptarësh ky klub që drejtohet nga Igli Tare?*

Është më se e drejtë kjo që ju thoni. Lacio për fatin e mirë ka drejtues të saj një shqiptar të suksesshëm në Itali si Igli Tare, që padyshim ka pasur rolin e tij në promovimin e talenteve shqiptarë. Por duhet përmendur fakti që atje vetëm me punën tënde mund t'ia dalësh, aspak nga ndikimi i të tjerëve. Emrat që ju përmendët më lart, janë pararoja ime, janë vlera dhe kualitete që jo rastësisht erdhën deri këtu, por përmes një pune të pavdërueshme. Edhe unë përpiqem t'ju ngjaj atyre. Punoj me orë të tëra. Stërvitem edhe pasi të tjerët e kanë lënë fushën e stërvitjes.

*Si e vlerëson këtë grup që prezantuat Shqipërinë në dy miqësoret me Kazakistanin?*

Mendoj se trajneri kishte qëllim konsolidimin e grupit për kualifikueset që mbahen këtë vit dhe jo për të fituar ose marrë pikë në këto dy ndeshje. Njërën e fituam dhe njërën e humbëm me të njëjtin rezultat 1-0. Por mendoj se Bogdani nuk hodhi në fushë një formacion për ta fituar me çdo kush takimin, por për të parë se kush do ti shërbej më mirë në të ardhmen. Unë them që ka kualitete dhe ka frymë grupi. Në një ekip nëse funksionojnë të dyja, atëherë suksesi do të vijë. Këtë e shpresoj edhe për ne, që të kualifikohemi në ndeshjet paraeleminatore të evropianit.

*Cila është ëndrra e radhës?*

Kuptohet që është Kombëtarja e madhe. Por akoma jam i ri. Uroj që gjërat të vijnë në kohën e vet. Duhet shumë punë dhe kurajo, grinte dhe optimizëm. Mbi të gjitha duhet vullnet dhe besim që gjërat arrihen kur ke pikësynime të qarta.

Rruga e Arbërit nr. 143

kujtesë

**Rukie Roshi nga Begjuneci, fshat i vogël majë një kodre afër qytetit të Peshkopisë, ishte gonxhe, do rritej e do bëhej lule...**

# Shqiponja dibrane

*Nga* **Sevo TARIFA**

Kur nis të shkruaj për dëshmorë, ashtu si dhe shokë të tjerë, nuk e kam lehtë. Më mbulojnë emocione. Më bie stilolapsi nga dora. E përfytyroj dëshmorin që hidhet në sulm si luan dhe bie me lavdi në fushën e nderit. Dhe sytë më mbeten te ai, te shpirti luftarak i tij. Njëherazi krenohem. Kjo ndjenjë njerëzore më ndryshon gjendjen shpirtërore. Dhe gjej guxim. Rimarr lapsin dhe vazhdoj të shkruaj...

**DËSHMORJA ME DY MBIEMRA!**

Në libra dhe shtypin e përditshëm kam botuar mbi dyqind portrete dëshmorësh, që kanë dhënë jetën në lulen e rinisë, për idealin e lirisë. Por nuk më është dhënë rasti të shkruaj ndonjë portret si ky, për një luftëtare dëshmore me dy mbiemra! Nuk është fjala se u martua një vajzë, u bë nuse dhe mbajti mbiemrin e familjes së saj, mori dhe mbiemrin e dhëndrit dhe u bë me dy mbiemra. Jo, puna qëndron ndryshe. Është një vajzë partizane dibrane, dëshmore, prindërit e së cilës u ndanë nga jeta dhe ajo mbeti katër vjeçe jetime, pa nënë, pa babë, pa vëlla, pa motër, e cila u rrit me sakrifica dhe, adoleshente, rrëmbeu armën, fluturoi si një shqiponjë, luftoi me trimëri dhe ra heroikisht në emër të nënës së madhe Shqipëri!

Kjo është Rukie Roshi nga Begjuneci, fshat i vogël majë një kodre afër qytetit të Peshkopisë. Çdo bëhej paskëtaj kjo vogëlushe? Ishte gonxhe, si do rritej e do bëhej lule? E vogël, vinte rreth nëpër shtëpi si një kanarinë. Kërkonte nënën dhe babin, të këpuste shpirtin. Dilte aty afër shtëpisë në një lëndinë, luante me shoqe dhe kthehej në shtëpi si dallëndyshja në folenë e saj. Kujt nuk i vinte keq për këtë jetime nga bashkëfshatarët? Njerëzit bisedonin, shprehnin keqardhjen, u pikonte në zemër. Dhe nuk qëndruan sehirxhi. Hodhën dorën e tyre të ngrohtë të afërmit e saj. Kujdeseshin si për vajzën e tyre. ajo rritej, vente-vinte, luante, qeshte, belbëzonte. Nisi shkollën fillore. Më të rriturit e shikonin në bebe të syrit. Vajzë e zgjuar. Dinamike. Merrte nota aq të mira, gëzonte.

U bë 13 vjeçe. Zbukurohej. Do kalonte adoleshencën. E ndiente nevojën e prindërve, sidomos të nënës. Ndërkaq u ndodh një familje mirëbërëse në qytetin e Peshkopisë, me kryefamiljar avokatin e nderuar me shpirt humanitar, Emin Barçi, që kishte dy çupa, Dritën e Sadien dhe duke marrë Rukien u bënë tri, tri si motra, shoqe, sikur të ishin trinjake të një shtëpie. Fëmijët miqësohen shpejt.

Ditët e Rukies kalonin me njerëz. Shoqëri e këndshme. Tri vajza ishin si "tri motërza", kudo bashkë në shkollë, në familje dhe jashtë saj. Me kukulla në duar. Aktivizohen në punë të lehta shtëpiake. I shihje me fshesë në dorë duke pastruar. Me qese artikujsh industrialë e bujqësorë që kthehen nga pazari. Ndihmonin familjen "Barçi". Rukia nuk dallohej se ishte nga një familje tjetër.



Trajtohej si vajzë nga e njëjta familje. Ishin si tri flutura. Punëtore si bleta.

Në ato vite Rukia më shumë njihej me mbiemrin "Barçi" se sa me mbiemrin "Roshi". Dhe i mbetën të dy mbiemrat. Portreti i saj në "Yje të pashuar" figuron "Ruki Barçi", ndërsa lapidari dhe një rrugë në fshat lindjen Begjunec kanë emrin "Rukie Roshi"! Me dy mbiemra, por është po ajo, e njëjta vajzë, pa prindër, por "prindërit" e gjendën dhe ajo u rrit në prehrin e ngrohtë të atyre dhe të të afërmve dashamirës fisnikë. Vazhdoi jetën e përbashkët si në shtëpinë e vet, me njerëz të dashur e bujarë.

**DRITË NË FUND TË TUNELIT**

Vite lufte. Jetë e pasigurtë. Në fshat prapambetje. Moshë e veçantë, me kërkesa specifike. Nga një mjedis i mbyllur fshati, Rukia jetonte tani në qytet. Hapet në shoqëri. Mëson, ndryshon jetën, sjelljen, mirëqenien. Sheh më shumë përparim, hapësirë. Nuk shikon vajza që janë të mbyllura brenda katër mureve të shtëpisë. Është larg asaj varfërie të fshatit. Në sytë e saj rrezatohet qytetari. Dëgjon zhvillime të gjendjes të kohës së luftës, shton njohuritë e saj.

Të tria vajzat tërhiqen në organizatën e rinisë antifashiste, në veprimtari aktive. Lexojnë libra me autorë Sami e Naim Frashëri, Haki Stërmilli, Andon Zako Çajupi etj. Dëgjojnë episode e tregime nga lufta partizane. Frymëzohen nga veprime luftarake të shoqeve me armë në dorë: Hibe Palikuqi, Zinete Kerliu, Vera Najdeni, Nexhmie Xhuglini, Qefsere Greva, Esma, Qefsere, Myzejen, Sadoshe Baholli, Ora Kazazi, Vera Nura etj.

**Shikojeni në këtë fotografi, në të cilën mund të dallohen qartë dy pamje: ana e jashtme, përmes së cilës kuptohet dhe bota e brendshme, gjendja shpirtërore e vajzës. E veshur thjeshtë. Ka mbajtur gërshetat e vajzërisë. Në fytyrë e vërejtur, shpreh mërzitje. Po edhe urrejtje. Mërzitje se është fatkeqe, jetime. Urrejtje për pushtuesit dhe veglat e tij.**

Sytë e Rukies tani u çelën më shumë. Horizonti i saj po zgjerohej. Ajo mësonte gjëra të reja, që nuk i dinte. Po rritej ndjenja e atdhedashurisë. Në zemrën e saj kishte mbirë një "Manushaqe", Manushaqja e Naimit, Shqipëria, "E bukura e dheut", "pikuar nga lart, nga reja", që "ndrit si margaritar", "e bardhë si shkuma e detit".

Rritej, mësonte, kuptonte se malet dhe liria janë të lidhur ngushtë. "Liria është thelbi i zemrës dhe i mendjes. Aty ku s'ka liri, edhe shpirti thahet si pema pa ujë". Po e shikonte Shqipërinë të rrethuar me male, që e bëjnë edhe më shumë bukuroshe. Të fortë si çeliku. Të pathyeshme si diamanti. Të patundur si vetë malet që ngrihen lart mbi tokë. Male me kreshta. Me shpate. Me përrenj. Me gryka. Me lugina. Me kurrize. Me brinja. Me qafa. Me faqe. Me shkëmbinj... Shihte dritë në fund të tunelit. Shpirti i saj i ri ndizej si barut i thatë. Zemra e saj rrihte nga gëzimi. Buzëqeshja e saj ishte si lule. I qeshnin dhe ata sy të zinj, të ndritur.

Në ato male dëgjohen pushkë. Janë pushkë që këndojnë në duar të trimave partizanë. Ata janë në roje të Shqipërisë. Atdheu rënkon nën thundrën fashiste. Shoqe ka, midis tyre dhe më të rritura. Dhe këto bisedojnë me të, e futin dhe në "politikë". Rukia dëgjon, i shikon shoqet në sy, sot di më shumë se dje, të nesërmen di më shumë se sot. Mëson gjithnjë më mirë e më shumë pse vuajnë njerëzit e varfër. Dhe arrin në përfundim se jeta është luftë. Se fashizmi po na shtyp. Çfarë do ai në Shqipëri? Duhet luftuar për liri, kundër pushtuesve dhe sahanlëpirësve të tyre.

Shikojeni në këtë fotografi, në të cilën mund të dallohen qartë dy pamje: ana e jashtme, përmes së cilës kuptohet dhe bota e brendshme, gjendja shpirtërore e vajzës. E veshur thjeshtë. Ka mbajtur gërshetat e vajzërisë. Në fytyrë e vërejtur, shpreh mërzitje. Po edhe urrejtje. Mërzitje se është fatkeqe, jetime. Urrejtje për pushtuesit dhe veglat e tij.

**"MOS MË KËRKONI. JAM NË MAL"!**

Qyteti i Peshkopisë po zbrazej. Luftonin partizanët për çlirimin e tij nga pushtuesit gjermanë dhe tradhtarët. Njerëzit iknin nga qyteti në fshatra, atje ku të ishte më e sigurt jeta e tyre. Rukia po vinte në moshë gati 17 vjeçare. Nuk dihej ku ishte. Pyetej: ç'u bë Rukia? Ku shkoi? U mësua se mbërriti në fshatin e saj. Andej në mal, te partizanët! U hap fjala e Rukies: "Mos më kërkoni, jam malit, do luftoj për lirinë e populli"!

Ishte fillimi i tetorit 1944. Rukia hyri në radhët e Brigadës IV Sulmuese, në batalionin e 4-t, me komandant Mitat Goskova, i cili tregon se "Rukija është një vajzë sypatrembur, partizane e vendosur, e disiplinuar, që lufton me trimëri, pa pyetur se do të japë dhe jetën e saj, pret me padurim ta shohë Atdheun të çliruar. Ka dashuri e respekt për luftëtarët e lirisë. Është me shpirt sulmues. E shkuar me vëllezër partizanë. I ndritin sytë që ishte me armë në sup dh ee shkrepte pa mbyllur sytë"...

Shqipëria po shkonte drejt çlirimit të plotë. Lajmet pasonin njëri-tjetrin. Zemra e Rukies hidhte vallë. Brigada e IV mori detyrën t'i afrohet Tiranës, të luftonte për çlirimin e saj. Ishte mesi i tetorit dhe gjysma e parë e nëntorit. Çaste vendimtare për t'i dhënë goditjen e pushtimit nazist. Beteja e kësaj brigade po zhvillohej në kodrat e Kasharit. Luftë e ashpër. Partizanët donin ta çlironin sa më parë kryeqytetin. Në ballë të sulmit ishte dhe Rukie Roshi, e cila me shkathtësi hidhej nga pozicioni në pozicion, duke luftuar kundër gjermanëve. Dhe në luftë e sipër një plumb i gjermanit e godit në gjoks. Ra trimëresha 17 vjeçare. Puthi tokën dhe në frymëmarrjen e fundit arriti të thoshte: "Përpara shokë, mos u ndalni. Rroftë Shqipëria! Rroftë Partia Komuniste!".

Ishte 20 tetori 1944. Trupi i saj u rrethua nga partizanët. Nderim me grusht, heshtje, një minutë zi! Betimi partizan: do t'ia marrim hakën! Rukia nuk arriti ta shohë çlirimin e Tiranës. Por u shua me besimin se Tirana dhe gjithë Shqipëria shpejt do çlirohej. Ditët iknin, Tirana u çlirua më 17 dhe e gjithë Shqipëria më 29 nëntor 1944.

***

Portreti i kësaj dëshmoreje është botuar në librin "Yje të Pashuar" dhe në librin "Dëshmorë 90-vjeçarë", por meqë nuk ishin të plotë, veterani Selim Pira, dibran dhe kolonel në pension, me punë kërkimore që bëri bashkë me shokët e Komitetit të Veteranëve të Peshkopisë, u mundësua që ky portret të jetë më i gjerë dhe i merituar për këtë shqiponjë mali dibrane.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

meditim

# Njerëz që hynë dhe mbeten në kujtesën e dibranëve

*Nga* **Abdurahim ASHIKU**

Sa herë më merr malli për Dibrën, për njerëz e për vende që kanë hyrë për të mbetur përgjithmonë në shpirtin tim, shfletoj arkivin tim fotografik, skanuar nga filma bardh e zi që më kanë mbetur tash më se gjysmë shekulli.

Ndjej kënaqësi, ndjej mall e dashuri.

Kësaj here u ndala në një fotografi fiksuar diku në male... Një njeri me mushkën përdore ngarkuar me arka një mbi një në të dy anët e samarit. I qetë, përqendruar në punë...

Më kujtoi Dhaskal Todrin në filmin "Udha e shkronjave"... Me siguri një ditë e ka përcjellë atyre maleve... Vendin ku e kisha fiksuar e dija. Emrin jo.... E përcolla në facebook me diciturën: "Njeriu që ngarkonte dhe transportonte kulturë edhe në fshatrat më të largët malorë. Ku është fiksuar dhe kush është?"

Vërshuan komentet, pëlqimet... Po i përcjell ashtusiç ushkruan prej tyre, duke e zgjeruar shikimin tim, duke përmendë emra që brezi që i njohu në udhëtimet e tyre për të shpërndarë dije e kulturë në një trevë të harruar nga bota i nderon dhe i respekton duke përmendë me respekt emrat e tyre...

* * *

Meleq Beqiri: Këtë nuk e njoh Duro. Por kujtoj me shumë respekt kinooperatorin e zonës tonë (Zerqan) Ahmet Qylhani.

Dini Totraku: Po nuk e njoh po mbaj mend kinooperatorin e zonës së Selishtës Rrahman Miha.

Lili Mero: Nuk e njoh por kujtoj me respekt Burhan Shehun te kinemaja jonë në Peshkopi.

Avni Shehu: Në zonën e Kastriotit dhe fshatrat përreth, zonën e Sllovës deri në Z.Dardhë, kinooperatorin Azur Mandri...

Fari Methasani: Duro respekte vërtet-për memorien që na sjell për njerëzpunëtorë dhe tëndershëm.

Abdurahim Ashiku: U kënaqa. Më sollët të gjithë njerëzit që shpërndanin kulturë. Vazhdoni. Marr shkas për të bërë një shkrim në nderim të tyre.

Dilaver Nela: Është vëlla i Beqir Shehut nga fshati Vasije po udhëton rrugës nga Vlesha për Kala.

Mile Arben: Më vjen në mendje filmi Udha e shkronjave..

Ilijaz Kica: Është Muharrem Shehu që jepte filma

Met Zebi: Ky person është Muharrem Shehu nga Vasia në kufi me Bushtricën dhe sot jeton n Kavajë.

Hazir Mehmeti - Kosovar, mësues i gjuhës shqipe-Vjenë: Një foto e mrekullueshme! Në mua solli një kohë malli, kohë vuajtjesh, kohë skamje për bukë e kulturë. Kjo flet sa një roman! Respekt për ju miku im Abdurahim Ashiku dhe rrethin tuaj!

Ilir Jakupi: Kujtoj me respekt Borisin dheXhevahirin

Nexhbedin Meda: Xhevahir Saraçi, Kino operatori zonës sonë.

Ilir Jakupi: Edhe ato kinooperator dheshoferë të zot e të respektuar

Uzri Gjeci: Ne kemi pasur Setki Gjonin.




**Ndjej kënaqësi, ndjej mall e dashuri. Kësaj here u ndala në një fotografi fiksuar diku në male... Një njeri me mushkën përdore ngarkuar me arka një mbi një në të dy anët e samarit. I qetë, përqendruar në punë...**

Drini Gjeci: Setki Xhani!!

Beqir Shehu: u përshëndes i nderuar Abdurahim.Personi që ju kërkoni ta njihni është Muharrem Ajet Shehu nga Vasiet e Kalasë së Dodës,vëllai i Beqir Ajet Shehut,kinooperator që me mushkën e tij, një herë në javë shfaqte filmin në çdo lagje e fshat të Kalasë së Dodës.Jeton në kushte normale me gjithëfëmijët e tij në Sektorin Rina Durrës. Ju përshëndet e falënderon për këtë kujtim të bukur që i dhuruat.

Abdurahim Ashiku: Faleminderit Beqir. Përcilli të falat e mija dhe njëkohësisht shkarkoje fotografinë, stampoje dhe dërgoja si dhuratë nga ana ime. Mbase nisur nga ai do të bëj një shkrim për ata që shpërndanin kulturë në të gjithë Dibrën. Më duhen edhe emra të tjerë sepse e ndjej se ka shumë

Iljas Mani: Keni harruar pa përmend-Pëllumb Elezin nga Gradeci përzonën e Maqellarës.

Namik Laçi: Po Elmaz Laçin, e Skënder Menën, njeri nga Grykë Noka e tjetri nga Lura.

Naim Lleshi: Në Muhurr kemi pasur Setki Xhanin. Në Zall Leshe ka qenë kinooperator Sul Hoxha.

Haki Pernezha: Duro! Kujtoj Xhavit Sufen nga Reçi dhe Uzur Mandrin që vinte me makinën e kinemasë.

***

Ishin shumë, nga njeri skaj i Dibrës në tjetrin. Të përkushtuar në punë, të mirëpritur nga njerëzit e të gjitha moshave, veçanërisht nga fëmijët.

Prisja një emër, i përveçëm për mua, organizator i kësaj forme të përcjelljes së kulturës në çdo skaj të rrethit.

Prisja Shahun e Kinemasë, siç e quanin, SHAH KAMBERIN, një njeri të përkushtuar për kulturën, një njeri që në krye të mjeshtërve dibranë të ndërtimeve ngriti nga themelet dhjetëra shkolla fillore e tetëvjeçare që nga Llanga në Draj Reç...

Elektrifikimi i plotë i vendit do të sillte në male jo thjeshtë dritë elektrike në shtëpitë e varfëra por edhe dije e kulturë, radio e më vonë televizorë, filma e "brigada kulturore", teatër e estradë, festivale folklorike që nisnin nga fshati për tu ngjitur në shkallë zone e rrethi, shkolla të mesme në çdo zonë të Dibrës deri në Arrmollë të Lurës, Reç, Klenjë, Kala të Dodës...

Këta i bënë njerëz të përkushtuar që përveç rrogës nuk futën gjë tjetër në xhep...

*Athinë, 25 mars 2018*

## Homazh

# ISLAMIL HIDA, njeri i edukuar, fjalëpak e punëshumë

*Nga* Destan RAMA



Sa herë që bisedoje me Ismailin nuk mund të rrinte pa përmendur shprehjen se "Vajkali për mua është vendi më i dashur". Bashkëbiseduesi i jepte të drejtë me arsyetimin se me të vërtetë s'ka gjë me të dashur se vendlindja.

Vajkali, ky emër i bukur që vjen nga legjenda "Vaj i Kalit" apo sipas Nolit, "Valë Kali", është vendi ku u lind në vitin 1938 Ismail Hida. Në fshat kreu arsimin fillor, kurse atë 7-vjeçar edhe të mesëm i kreu në Qytetin e Bulqizës. Ai u lind në një familje të varfër, por me tradita atdhetare. Fëmijërinë e kaloj në kushte të vështira, si edhe shumë fëmijë të tjerë të asaj kohe. Në këto kushte në një moshë fare të re, 14-vjeç, detyrohet të fillojë punë për herë të parë në centralin elektrik të minierës, në fillim si punonjës, edhe pastaj si teknik. Këtu i kaloj vitet e rinisë së hershme. Më pas punoi si elektricist në minierën e kromit Bulqizë. Në vitin 1970 Ismaili punoi në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë, si përgjegjës turni. Duke parë tek ai aftësitë e rralla organizative, drejtuese, dhe shkencore, sidomos në fushën e elektricitetit, organet kompetente të kohës, vendosën që bashke me një grup shokësh i dërguan për specializim për 1 vit në Kinë. Atje ai u dallua në përvetësimin e njohurive, gjë që e reflektonte në diskutimet e tij në grup, si dhe në rezultatet përfundimtare. Atje ai u shqua edhe si një shok i mirë, i sjellshëm, i edukuar, fjalëpak e punëshumë, gojëembël e mendimtar i mprehtë në zgjidhjen e situatave. Pas 1 viti Ismaili kthehet në Bulqizë dhe vazhdon punën në Fabrikën e Pasurimit të Kromit, si përgjegjës i saj. Por tashmë punon me autoritetin e specialistit dhe të përgjegjësisë së lartë në kryerjen e detyrës. Këtë detyrë e kreu për 10 vite rresht. Pas këtyre viteve ai rikthehet sërisht elektricist në minierën e kromit Bulqizë, në pusin numër 1, deri sa doli në pension.

Ismaili jo vetëm si kuadër, shok e veprimtarë i shquar, por ai u dallua edhe si një familjarë, bashkëshort e baba shembullor. Lidhja e tij me Limen, bijë kjo e një dere të nderuar e familjes Hoxha, në Vajkal, rriten edhe edukuan 2 vajza, si dy lule që dalin nga një degë; Xhemilen dhe Mbarimen. Të dyja gjetën fatin dhe krijuan familjet e tyre për ti pasur zili. Por ja që zoti s'deshi të shkojë kjo mbarësi. Ai e gjymtoi, ja preu njërin krah, ia mori me pa të drejtë Mbarimen, vajzën me të vogël, në moshën 35 vjeçare, duke lënë prapa dy jetime. Këtu filloi për Ismailin gjëma e madhe, këtu ju shkallua zemra e tij e mirë dhe bujare. Që nga ajo ditë ai nuk njohu më gëzim në jetën e tij. U duk sikur këto vitet e fundit, pasi ju rritën nipërit edhe mbesat, e mori pak veten, por kjo mbeti vetëm një shkëndijë e humbur në hapësirë. Një sëmundje e rëndë që ju shfaq krejt papritur e bëri të dorëzohej përpara ligjit të natyrës. Nuk reshtën përpjekjet e Xhemilës, të Petritit, por bashkë me ta edhe të Ardianit dhe Hysenit, për ta shëruar por qe e pamundur. Atë ditë të 11 Marsit pushoi së rrahuri zemra e tij e copëtuar.

Ismaili ndonëse banonte për disa vite në Tiranë, ku edhe atje ai krijoj një shoqëri të shkëlqyer, malli për vendlindjen Vajkalin e dashur e ngacmonte vazhdimisht, ndaj edhe donte që trupin e tij ta treste dheu i Vajkalit, aty pranë bashkëshortes edhe Mbarimës, vajzës së tij të dashur.

Lamtumirë Ismail i Dashur! Ti ike, por ne na le mallin, na le kujtimet e mendimet e vyera, që nuk do të i harrojmë kurrrë. U prefsh në Paqe! Tu bëftë shpirti dritë, se dritë ishe. Ngushëllime Familjes.




## www.rrugaearberit.com

**Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.**

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

## Shija dibranew në kuzhinën bashkëkohore

GATUAJMË ME ADILIN

# Llagaja me presh

**PËRBERËSIT PËR 6 PERSONA:**

Për llagajën nevojiten: 5 vezë; 50 ml qumësht; 400 gr miell gruri; vaj 50 ml; kripë.

Për mbushjen: 600 gr presh; 200 gr gjizë; 2 vezë; kripë.

Për bashamelen: 50 gr gjalp; 50 gr miell; 500 ml qumësht; kripë.

Vështirësia: normale.

**Kohëzgjatja:** 45 minuta.

Përgatitja e mbushjes: Fillimisht lajmë preshin në një tenxhere dhe e presim shumë hollë. Skuqim preshin në një tenxhere me pak vaj, shtojmë pak ujë derisa të ketë zier plotësisht. Pasi ka zier e vendosim në një enë ku e lemë të ftohet, më pas shtojmë gjizën, vezën dhe pak kripë duke i trazuar deri sa të kemi një masë homogjene.



**PËRGATITJA E LLAGAJAVE:** Marrim një enë ku hedhim vezët dhe i përziejmë, shtojmë miellin ngadalë duke vazhduar përzierjen. Më pas shtojmë qumështin, vajin dhe kripën duke i përzier mirë të gjithë përbërësit. Në një tigan të ngrohur me pak gjalp hedhim me një garuzhde përbërësin që sapo përgatitëm, në mënyrë të tillë që të përhapet në të gjithë tiganin, e lemë pak sekonda dhe e kthejmë. Në momentin që është pjekur e heqim. Vazhdojmë kështu derisa të përfundojmë gjithë përgatesën duke e bërë peta.

**TANI PËRGATISIM BASHAMELËN:** Shkrijmë gjalpin në një tenxhere, shtojmë miellin dhe i trazojmë mirë derisa përgatesa të marrë ngjyrën e arrës. Shtojmë qumështin e vakët duke e përzier vazhdimisht derisa të përftojmë një salcë të trashë. Shtojmë kripë sipas dëshirës dhe bahamela është gati.

Hapim petët e përgatitura në tavolinën e punës dhe shtojmë përbërjen me presh dhe gjizë, duke e hapur në të gjithë sipërfaqen e petës. Palosim petën në dysh dhe i vendosim në një tavë. Sipër petëve të palosura e të vendosura në tavë (tepsi) hedhim bashamelën me ndihmën e një garuzhdeje duke i mbuluar plotësisht petët e palosura. Vendosim tavën në furrë 1800 për 15 minuta. Nxirret dhe serviret në pjata.

Ndiqini gatimet e **Adil Pernezhës** në **instagram.com/ipiattidiadil/**

Çmime shumë të mira për tirazhe 20-100 kopje

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 068 65 08 441

cyan magenta yellon black